Financuar nga
Bashkimi Evropian

Paqja dhe siguria
në Kosovë

Analizë gjinore

2025

Zbatuar nga: Kosovo Women's Network
Serving, Protecting and Promoting the Rights of Women and Girls

Ky publikim u financua nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Rrjetit të Grave të Kosovës dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Falënderimet

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) falënderon Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë (ZBE) për besimin e treguar dhe për bashkëpunimin e frytshëm gjatë gjithë procesit. Ekipi falënderon të gjithë individët, organizatat dhe institucionet që ndanë kohën e tyre të çmuar për të marrë pjesë në hulumtim, kontribuar në punëtoritë e verifikimit të gjetjeve dhe dhënë komente mbi draft-raportin, duke ndihmuar në përmirësimin e tij. Kjo analizë është përgatitur nga Nicole Farnsworth, Valmira Rashiti, Ebba Hellman, Majlinda Behrami, Eleta Shala, Donjeta Morina, Mimoza Svirca dhe Latra Demaçi për RrGK-në. Të gjithë anëtarët e ekipit u angazhuan në intervista, në të cilat morën pjesë edhe Luigj Uka, Dhurata Alilaj dhe Anda Krasniqi. Drejtoresha Ekzekutive e RrGK-së, Igballe Rogova, ofroi udhëzime strategjike dhe mbështetje gjatë gjithë procesit. Sara Nicole Baxley kontribuoi me ekspertizë mbi aspektet etike të hulumtimit. Nicole Farnsworth dhe Latra Demaçi redaktuan dhe korrigjuan raportin. RrGK është shumë mirënjohëse ndaj të gjithë vullnetarëve që kontribuan në transkriptimin dhe kodimin e të dhënave, përfshirë Anda Krasniqi, Viona Recica, Dominique Ogreanu, Blerona Sojeva, Liridona Shkodra, Puhiza Shemsedini, Lisa Wolfhugel dhe Liza Qafleshi.

Përmbajtja

Shkurtesat

ABGj	Agjencia për Barazi Gjinore
ADA	Agjencia Austriake për Zhvillim
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
AVL	Armë të vogla dhe të lehta
BE	Bashkimi Evropian
BIRN	Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese
CASA	Qendra për Veprime Afirmative Sociale
CBM	Ndërtimi i Komunitetit në Mitrovicë (*Community Building Mitrovica*)
CEDAW	Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave
CEL	Qendra për Barazi dhe Liri të Komunitetit LGBT në Kosovë (*Centre for Equality and Liberty*)
CLIP	Plani i zbatimit në nivel vendi (*Country Level Implementation Plan*)
CPD	Qendra për paqe dhe tolerancë (*Centre for Peace and Tolerance*)
CSDP	Politika e përbashkët e sigurisë dhe mbrojtjes (*Common Security and Defence Policy*)
D4D	Demokracia për Zhvillim
ECMI	Qendra Evropiane për Çështje të Pakicave në Kosovë (*European Centre for Minority Issues*)
EEAS	Shërbimi Evropian për Veprim të Jashtëm (*European External Action Service*)
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
FDHK	Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë
FKShC	Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
GjEDNj	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GjNPIJ	Gjykata Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë
GPS	Gratë, paqja dhe siguria
GRB	Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor
IDK	Instituti Demokratik Kombëtar
IIK	Intervistat me informatorë kyç
IPA	Instrumenti për asistencë para anëtarësimit (*Instrument for Pre-Accession*)
KE	Komisioni Evropian
KFOR	Forca e NATO-s në Kosovë
KPM	Komisioni i Pavarur i Mediave
KSKB	Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara
LBGj	Ligji për barazi gjinore
LGBTQI+	Personat lezbike, gej, biseksualë, trans*, queer, aseksualë, interseks dhe persona me identitete të tjera
LS	Lista Serbe
MAShT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MB	Mbretëria e Bashkuar
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MSA	Marrëveshja e Stabilizim - Asocimit
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut
NSI	Iniciativa e Re Sociale (*New Social Initiative*)
OBZHE	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OKB	Kombet e Bashkuara
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OShC	Organizatë e shoqërisë civile
OShCG	Organizatë e shoqërisë civile për të drejtat e grave
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
PKBGj	Programi i Kosovës për barazi gjinore
PKIE	Programi kombëtar për integrim evropian
PKV	Plani Kombëtar i Veprimit
PSBE	Përfaqësues Special i BE-së
PTSD	Çrregullimi i stresit post-traumatik
PVGj	Plani i Veprimit Gjinor
QKRMT	Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës
QKSGj	Qendra Kosovare për Studime Gjinore

QKSS	Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë
RKSKB	Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara
RPK	Reporterët pa Kufij
RPS	Rinia, paqja dhe siguria
RrGK	Rrjeti i Grave të Kosovës
RrPR	Rrjeti i Profesionistëve të Rinj
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
SP	Sekretar i Përgjithshëm
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
UN Women	Entitet i Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UNKT	Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
VV	Vetëvendosje
WISE	Skema për profesionistët e rinj në Ballkanin Perëndimor (*Western Balkans Young Professionals Internship Scheme for Empowerment*)
YIHR	Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut
ZBE	Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë
ZBGj	Zyrtar/e për barazi gjinore
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZRBR	Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor

1. Përmbledhje ekzekutive

Agjenda për gratë, paqen dhe sigurinë (GPS) njeh rolin thelbësor që kanë gratë në parandalimin e konflikteve, ndërtimin e paqes dhe rimëkëmbjen pas luftës. Kjo agjendë synon pjesëmarrjen domethënëse të grave në të gjitha aspektet e paqes dhe sigurisë, mbrojtjen e të drejtave të tyre gjatë dhe pas konfliktit, si dhe integrimin e perspektivës gjinore në çdo përpjekje për ndërtimin e paqes. ZBE-ja ka marrë përsipër përmbushjen e Agjendës GPS, përfshirë edhe në Kosovë. ZBE-ja në Kosovë ka kërkuar këtë "Analizë Gjinore mbi paqen dhe sigurinë në Kosovë", të realizuar nga RrGK-ja, me qëllim që të ofrojë njohuri të bazuara në fakte që ndihmojnë në orientimin e iniciativave të jashtme të BE-së në përputhje me zotimet e saj në kuadër të GPS-së. Analiza shqyrton sa e përgjegjshme ndaj çështjeve gjinore është korniza ligjore dhe e politikave e Kosovës në lidhje me parandalimin e konflikteve, shkaqet dhe pasojat e tyre, palët kryesore të përfshira, ndërtimin e paqes, si dhe iniciativat e BE-së dhe të tjera për ndërtimin e paqes. Gjithashtu, analiza trajton hapat që BE-ja mund të ndërmarrë për të promovuar paqe dhe siguri gjithëpërfshirëse, të përgjegjshme ndaj çështjeve gjinore dhe të qëndrueshme. Hulumtimi përfshiu përdorimin e metodave të përziera, përfshirë intervista, grupe fokusi dhe analizë të përmbajtjes.

Korniza ligjore dhe politike e Kosovës për sigurinë, duke përfshirë parandalimin dhe adresimin e konfliktit, nuk është mjaftueshëm e përgjegjshme ndaj çështjeve gjinore. Kosova kishte një Plan Veprimi për GPS për periudhën 2013–2015, i cili u zbatua në masë të madhe. Pas përfundimit të tij, Programi i Kosovës për Barazi Gjinore (PKBGj) 2020–2024 përfshiu disa aspekte të GPS-së. Deri në gusht 2025, Kosova nuk kishte një Plan Kombëtar të Veprimit (PKV) për GPS-në, por Qeveria kishte planifikuar përfshirjen e Agjendës GPS në PKBGj-në e ardhshme.

Edhe pse dhuna masive ka marrë fund, njerëzit në Kosovë - veçanërisht gratë nga grupe/profile të ndryshme - vazhdojnë të ndihen të pasigurt dhe përballen me pasoja të thella të konfliktit: pasiguri të vazhdueshme, përfshirje të ulët, qasje të kufizuar në shërbime, trauma të pazgjidhura, probleme shëndetësore, djegie profesionale të aktivistëve dhe madje edhe humbje jete. Pjesëmarrësit/et në hulumtim theksuan në intervista dhe grupe fokusi se pa drejtësi dhe llogaridhënie, konflikti vazhdon dhe dekurajon angazhimin në proceset e paqes. Ata/ato identifikuan disa shkaktarë të mundshëm të konfliktit, përfshirë: mjedise politike të dominuara nga burrat; përpjekjet e udhëheqësve politikë për të ruajtur pushtetin; narrativat patriarkale etnonacionaliste që përhapen nga udhëheqësit politikë dhe media; sistemet arsimore të ndara dhe arsimin që forcon normat gjinore të militarizuara; komunikimin e dobët midis grupeve etnike; mungesën e drejtësisë tranzicionale; pasigurisë ekonomike; narrativat përjashtuese të promovuara nga mediat; qasjen e kufizuar në të drejtat dhe shërbimet themelore; si dhe normat patriarkale gjinore të qëndrueshme, të lidhura me papunësinë dhe margjinalizimin për qëllime politike të grave, personave me aftësi të kufizuara, pakicave etnike, si dhe personave lezbike, gej, biseksualë, transgjinorë, queer, interseksualë dhe me identitete të tjera (LGBTQI+). Hulumtimi tregon se burrat, veçanërisht udhëheqësit politikë në Kosovë dhe Serbi, janë akterët kryesorë që kontribuojnë në konflikt. Megjithëse shpesh u mungon fuqia ligjore, politike dhe ekonomike për t'u angazhuar, dhe megjithëse zakonisht përjashtohen nga proceset formale të paqes dhe vendimmarrjes, gratë përmenden vazhdimisht si të gatshme për t'u angazhuar në ndërtimin e paqes, ndërsa organizatat e shoqërisë civile (OShC), veçanërisht organizatat për të drejtat e grave (OShCG), konsiderohen kontribuues kryesorë në paqe. Gjithashtu, ekziston potenciali që të rinjtë, veçanërisht djemtë, të jenë agjentë të paqes ose të konfliktit, në varësi të mënyrës se si angazhohen dhe nga kush. Megjithatë, homogjenizimi i grave si "paqësore" dhe burrave si "të dhunshëm" rrezikon të injorojë rolet e ndryshme të individëve dhe mund të forcojë, në vend që të sfidojë, normat dhe marrëdhëniet gjinore që nxisin konfliktin.

Projektet e ndërtimit të paqes, kur zbatohen veçmas, zakonisht kanë përfshirë analiza të thelluara të konfliktit, por u ka munguar ndjeshmëria gjinore ndaj konfliktit, duke marrë parasysh të kaluarën e Kosovës. Nga perspektiva ndërthurëse gjinore, ndjeshmëria ndaj konfliktit kërkon konsultime më gjithëpërfshirëse gjatë planifikimit të veprimeve, përmirësim të analizës ndërthurëse gjinore për të udhëhequr logjikën e ndërhyrjeve, analiza të rreziqeve të konfliktit me ndjeshmëri gjinore dhe masa për zbutjen e tyre, si dhe qasje afatgjata të fokusuara në nevoja (p.sh. ekonomi, energji ose mjedis, në vend të "paqes", për ndërtimin e besimit). Po ashtu, kërkohet adresimi i barrierave strukturore që kufizojnë përfshirjen më të gjerë të grave në programe, politika dhe dialogë politikë (p.sh. hapësira të paarritshme, mungesë shërbimesh për kujdesin, apo përjashtim ekonomik dhe politik).

Kjo analizë ofron disa rekomandime për hartimin e ligjeve, politikave dhe programeve më të përgjegjshme ndaj çështjeve gjinore dhe konfliktit.

2. Hyrje

Qëllimi i përgjithshëm i kësaj analize është të kontribuojë në përmbushjen e zotimeve të BE-së ndaj Agjendës për gratë, paqen dhe sigurinë (GPS) në iniciativat e saj të jashtme, në përputhje me përfundimet e Këshillit të viteve 2018 dhe 2022 mbi GPS-në, si dhe me Qasjen strategjike dhe Planin e Veprimit të BE-së për GPS (2019–2024).[1] Qëllimi specifik është të udhëzojë hartimin dhe zhvillimin e politikave të BE-së në lidhje me Agjendën GPS në Kosovë dhe mbështetjen e saj financiare për të gjitha programet përkatëse, duke ofruar rekomandime të bazuara në fakte dhe një plan veprimi që do të shërbejë për hartimin e politikave dhe programeve të BE-së.

2.1. Methodologjia

Ky seksion përshkruan metodologjinë e përdorur. RrGK aplikoi një qasje të "hulumtimit të bazuar në të dhëna", një proces përsëritës, ku metodologjia, pyetjet e hulumtimit, metodat dhe burimet përshtateshin teksa vinin informacione të reja gjatë procesit të hulumtimit.[2] Një qasje e tillë kontribuon në një hulumtim pjesëmarrës dhe gjithëpërfshirës, duke rritur cilësinë dhe vlefshmërinë e rezultateve.

2.2. Pyetjet e hulumtimit

Pyetjet kryesore të hulumtimit ishin:

1. Sa gjithëpërfshirëse dhe e ndjeshme ndaj aspektit gjinor është korniza ligjore e Kosovës në lidhje me parandalimin dhe adresimin e konflikteve?
2. Cilat janë shkaqet dhe pasojat e konfliktit nga perspektiva ndërthurëse gjinore?
3. Cilat janë palët kryesore të interesuara - përfshirë akterët në konflikt, personat e prekur nga konflikti, ata me interesa në konflikt, si dhe akterët që kontribuojnë në paqe dhe rezistencë - duke marrë parasysh dallimet gjinore dhe të tjera ndërthurëse?
4. Sa gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme nga aspekti gjinor kanë qenë aktivitetet e kaluara dhe të tanishme të parandalimit, ndërtimit të paqes dhe stabilizimit?
5. Duke pasur parasysh të gjitha këto, cilat hapa politikë dhe programatikë mund të ndërmerren për të siguruar një qasje më efektive, gjithëpërfshirëse, të përgjegjshme nga aspekti gjinor, të ndjeshme ndaj konfliktit dhe të qëndrueshme për avancimin e paqes dhe sigurisë?

Ndërthurja

Bashkimi Evropian është zotuar në Planin e Veprimit Gjinor të BE-së (PVGj) III për një qasje ndërthurëse, që përfshin analizimin dhe përpjekjen për të adresuar situatat dhe pabarazitë e mundshme të ndërlidhura, me të cilat mund të përballen gra (dhe burra) të ndryshëm për shkak të gjinisë së tyre dhe faktorëve të tjerë demografikë dhe socioekonomikë. Për thjeshtim, në këtë analizë termi "**të ndryshëm/me**" i referohet grave dhe vajzave (si edhe burrave dhe djemve, kur është e rëndësishme për analizën) "në gjithë diversitetin e tyre", siç përdoret në PVGj-në III të BE-së. Kjo përfshin gra, vajza, burra, djem dhe persona jo-binarë që jetojnë në zonat urbane dhe rurale, në veri ose jug të Kosovës, dhe që u përkasin moshave, etnive, aftësive të kufizuara, niveleve të arsimit, punësimit dhe statusit ekonomik të ndryshëm.

2.3. Metodat e hulumtimit

Në përputhje me Konkluzionet e Këshillit, "Udhëzimet për analizën e konfliktit" të KE-së dhe manualin e stafit të BE-së për veprim në situata konflikti, kjo analizë përfshiu metodat e mëposhtme:

1. **Konsultimet** me palë të interesuara nga BE-ja, Agjencia për Barazi Gjinore (ABGj) dhe me OShC të ndryshme, për të informuar metodologjinë e hulumtimit.

[1] Këshilli i Bashkimit Evropian, Women, Peace and Security - Council Conclusions (2018) [Gratë, paqja dhe siguria – Konkluzionet e Këshillit (2018)], 2018. EU Action Plan on Women, Peace and Security (WPS) 2019-2024 [Plani i veprimit i BE-së për gratë, paqën dhe sigurinë (GPS) 2019-2024], 2019. Council Conclusions on Women, Peace and Security [Përfundimet e Këshillit mbi gratë, paqen dhe sigurinë], 2022. Ky raport është një version i shkurtuar i analizës më të gjerë gjinore, e kërkuar nga ZBE-ja në Kosovë për të shërbyer si bazë për hartimin e politikave dhe programeve të saj.

[2] Brooke Ackerly dhe Jacqui True, *Doing feminist research in political and social science* (2nd ed.) [Hulumtimi feminist në shkencat politike dhe shoqërore (botim i 2-të)], Red Globe Press, 2020.

2. **Rishikimin e literaturës dhe analizën e kornizës ligjore të Kosovës:** RrGK shqyrtoi politikat e BE-së në lidhje me paqen dhe sigurinë; literaturën mbi gjininë, paqen dhe sigurinë; si dhe analizoi ndjeshmërinë gjinore të kornizës ligjore të Kosovës ndaj parandalimit dhe adresimit të konfliktit. RrGK përdori "Shkallën e Semaforit" të ndjeshmërisë gjinore (Figura 1) për të vlerësuar nivelin në të cilin ligjet dhe politikat që lidhen me paqen dhe sigurinë janë neutrale, të ndjeshme, të përgjegjshme, transformuese ose negative nga aspekti gjinor.

Figura 1. Shkalla e transformimit gjinor "semafori"



3. **Identifikimin dhe analizën e programeve** për ndërtimin e paqes, duke përdorur "Shkallën e semaforit".
4. **Identifikimin e palëve kryesore** në konflikt dhe në proceset e paqes. Ky proces u mbështet nga rishikimi i literaturës, konsultimet dhe intervistat.
5. **Kryerjen e intervistave me informatorë kyç** (IIK) me gjithsej 79 gra (61) dhe burra (18) të ndryshëm*, për të identifikuar nevojat, përvojat dhe interesat e tyre. Përzgjedhja e IIK-ëve u bë përmes mostrës me variacion, për të përfshirë sa më shumë pjesëmarrës të ndryshëm* në bazë të përgjigjeve të mundshme ndaj pyetjeve të hulumtimit dhe faktorëve ndërthurës (p.sh. etnia, mosha, aftësia e kufizuar, vendndodhja gjeografike). Intervistat u zhvilluan me zyrtarë qeveritarë, përfaqësues të OShC-ve (përfshirë OShCG-të e ndryshme), akademikë dhe akterë zhvillimi, të përzgjedhur sipas pozicionit të tyre. Gjatë intervistave, ky proces ndihmoi në identifikimin e pjesëmarrësve shtesë përmes metodës së "topit të dëborës". Intervistat kishin për qëllim të adresonin pyetjet e hulumtimit dhe u zhvilluan në kohë dhe vende (online ose fizikisht) ku pjesëmarrësit ndiheshin të sigurt dhe rehat. Pjesëmarrësit u informuan për qëllimin e hulumtimit, të drejtat e tyre dhe dhanë pëlqimin me gojë, në përputhje me standardet etike. Intervistat ndoqën një qasje gjithëpërfshirëse, të ndjeshme ndaj konfliktit dhe pjesëmarrëse, duke synuar të çmontonin marrëdhëniet e pushtetit midis "hulumtuesit/anketuesit" dhe "të anketuarit". Pjesëmarrësit u inkurajuan të ndanin pikëpamjet, analizat dhe rekomandimet e tyre. RrGK gjithashtu mori kontribute dhe të dhëna me shkrim nga 13 akterë të tjerë, përfshirë policinë, ambasadat dhe organizatat ndërkombëtare.
6. **Organizimin e pesë grupeve të fokusit** me: gra me aftësi të kufizuara (përfshirë gra boshnjake dhe kroate); gra rome, ashkali dhe egjiptiane; përfaqësuese të OShC-ve (kryesisht shqiptare); gra serbe në veri; dhe gra të reja serbe në veri. Gjithsej morën pjesë 31 gra.
7. **Analizën e të dhënave**, duke përfshirë pjesëmarrësit e hulumtimit në procesin e analizës dhe në identifikimin e rekomandimeve. Transkriptet u koduan në raport me pyetjet e hulumtimit nga të paktën dy anëtarë të ekipit të hulumtimit me profile të ndryshme, për të mundësuar triangulim mes hulumtuesve dhe për të rritur vlefshmërinë. Analiza gjinore me qasje ndërthurëse përfshiu ndarjen e gjetjeve sipas gjinisë dhe moshës, përkatësisë etnike, vendndodhjes gjeografike, aftësisë së kufizuar dhe faktorëve të tjerë, aty ku ishte e mundur. Të gjitha përqindjet janë rrumbullakosur për ta lehtësuar leximin.
8. **Organizimin e dy punëtorive për verikifimin e gjetjeve** me 24 palë të interesuara për të mbledhur komente mbi gjetjet, rekomandimet dhe Planin e Veprimit. Draft-analiza u shpërnda për shqyrtim dhe koment, dhe më pas draft-raporti u rishikua bazuar në komentet e marra.

2.4. Kufizimet dhe gabimi i mundshëm

Shqyrtimi i përpjekjeve të komunave në ndërtimin e paqes ishte jashtë fushës së këtij hulumtimi; megjithatë, ka gjasa të ekzistojnë iniciativa shtesë në nivel të qeverisjes vendore. Ekipi i hulumtimit konstatoi se pjesëmarrësit/et, në përgjithësi, ishin të hapur për të folur rreth përvojave, interesave dhe

nevojave të tyre. Vetëm pak persona refuzuan të marrin pjesë për arsye shëndetësore, për shkak të orareve të ngjeshura, udhëtimeve ose lodhjes nga intervistat. Pikëpamjet për temat që lidhen me fushat e tyre të ekspertizës u siguruan nga pjesëmarrës të tjerë. Zgjedhjet parlamentare të mbajtura në shkurt 2025 paraqitën sfida në sigurimin e intervistave me zyrtarët publikë, për shkak të mungesës së një qeverie funksionale dhe të personave të autorizuar për të folur në kapacitet zyrtar. Përpjekjet e vazhdueshme për formimin e qeverisë kufizuan gjithashtu disponueshmërinë e përfaqësuesve të partive politike për intervista. Duke qenë se rezultatet e zgjedhjeve mbetën të paqarta, pikëpamjet paszgjedhore mbi çështjet e sigurisë nuk mund të vlerësoheshin dhe mund të ndryshojnë me kohën.

2.5. Rreth këtij raporti

Pas një historiku të shkurtër, analiza ligjore dhe e politikave shqyrton nivelin e ndjeshmërisë gjinore të kornizës ligjore të Kosovës në lidhje me parandalimin dhe adresimin e konfliktit. Analiza e situatës paraqet një vlerësim të shkurtër gjinor të faktorëve kontekstualë që ndikojnë në paqen dhe sigurinë. Më pas, raporti shqyrton shkaqet dhe pasojat e konfliktit dhe dhunës nga perspektiva gjinore, ndërsa seksioni vijues identifikon palët kryesore në konflikt dhe paqe - duke përfshirë interesat e tyre dhe dallimet gjinore në mënyrën se si individët kontribuojnë në konflikt dhe ndërtimin e paqes. Seksioni pasues analizon ndjeshmërinë gjinore të përpjekjeve për ndërtimin e paqes, ndërsa në përmbyllje paraqiten rekomandimet kryesore që dalin nga gjetjet e analizës.

3. Historiku

Historia e Kosovës është e ndërlikuar dhe shpesh e debatueshme; megjithatë, ky seksion ofron një përmbledhje të shkurtër. Dikur pjesë e Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë, Kosova përjetoi tensione në rritje gjatë viteve 1990, pasi presidenti i atëhershëm i Serbisë dhe i Republikës Federale të Jugosllavisë, Sllobodan Millosheviq, revokoi autonominë e saj. Gratë luajtën një rol të nënvlerësuar në rezistencën jo të dhunshme të shqiptarëve të Kosovës, duke organizuar shkolla të fshehta, shërbime shëndetësore dhe ndihmë humanitare.[3]

Në periudhën 1998–1999, dhuna u përshkallëzua në luftë midis forcave serbe dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) ndërmori një ndërhyrje ushtarake me karakter humanitar.[4] Në total, rreth 850,000 shqiptarë të Kosovës u zhvendosën me forcë.[5] Menjëherë pas luftës, serbët dhe romët e Kosovës u përballën me dhunë dhe zhvendosje.[6] Në përgjithësi, rreth 13,535 persona u vranë ose u zhdukën, nga të cilët 10,812 ishin shqiptarë të Kosovës, 2,197 ishin serbë të Kosovës dhe 526 ishin romë, boshnjakë, malazezë dhe të etnive të tjera.[7] Nga 6,065 persona të zhdukur, 1,607 raste mbetën të pazgjidhura në vitin 2024.[8] Ndërsa burrat përbënin shumicën e personave të vrarë dhe të zhdukur, gratë dhe fëmijët u prekën në mënyrë disproporcionale nga zhvendosja dhe dhuna seksuale.[9]

---

[3] Clark Howard, *Civil Resistance in Kosovo* [Rezistenca civile në Kosovë], 2000; Kosovo Gender Studies Centre, *History is Herstory, too*, 2008.

[4] Sh. Osmani, "KFOR mission in Kosovo and its future" [Misioni i KFOR-it në Kosovë dhe e ardhmja e tij], *Mediterranean Journal of Social Sciences*, 2014, f. 350-351.

[5] UNHCR, "Kosovo Crisis Update" [Përditësimi i krizës në Kosovë].

[6] Human Rights Watch, "Abuses against Serbs and Roma in the New Kosovo" [Keqtrajtimet ndaj serbëve dhe romëve në Kosovën e re], 1999.

[7] Fondi për të Drejtën Humanitare, "31,600 documents undoubtedly confirm death or disappearance of 13,535 individuals during war in Kosovo" [31,600 dokumente konfirmojnë pa dyshim vdekjen ose zhdukjen e 13,535 individëve gjatë luftës në Kosovë], 2015.

[8] Shërbimi Evropian për Veprim të Jashtëm, "EU-facilitated Dialogue: Successful conclusion of the negotiations for the 2023 Declaration on Missing Persons' implementation" [Dialog i udhëhequr nga BE-ja: Përfundimi i suksesshëm i negociatave për zbatimin e Deklaratës 2023 për personat e zhdukur], 2024.

[9] Human Rights Watch, "UNDER ORDERS: War Crimes in Kosovo" [Nën urdhërr: Krimet e luftës në Kosovë], 2001, f. 3-8.

Pas vitit 1999, Kosova u administrua nga një mision civil ndërkombëtar,[10] – Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK).[11] Në mars të vitit 2004, si pasojë e një sërë ngjarjesh me prapavijë etnike, 23 persona humbën jetën (një maqedonas, nëntë serbë dhe trembëdhjetë shqiptarë), qindra shtëpi dhe kisha të serbëve, romëve dhe ashkalinjëve u shkatërruan, dhe më shumë se 4,000 persona u zhvendosën. Këto ngjarje ngjarje nxorën në pah paaftësinë e forcave ndërkombëtare - Forcës së NATO-s për Kosovën (KFOR) dhe UNMIK – për të mbrojtur pakicat.[12] Në vitin 2008, Kosova shpalli pavarësinë e saj dhe që atëherë ka vazhduar procesin e ndërtimit të shtetit, në kuadër të aspiratave për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Serbia vazhdon të mos e njohë pavarësinë e Kosovës

4. Korniza ligjore dhe e politikave

Ky seksion i përgjigjet pyetjeve të hulumtimit: Sa gjithëpërfshirëse dhe e përgjegjshme ndaj aspektit gjinor është korniza ligjore dhe ajo politike e Kosovës në lidhje me parandalimin dhe adresimin e konfliktit; si mund të përmirësohet kjo kornizë për të qenë më gjithëpërfshirëse dhe më e përgjegjshme nga aspekti gjinor; dhe si mund të përdoren mësimet e nxjerra nga zbatimi i Planit të Veprimit të Kosovës për Zbatimin e Rezolutës 1325 "Gratë, paqja dhe siguria", si dhe nga aspektet e PKBGj-së për GPS-në, për të informuar zhvillimin e ardhshëm të kornizës ligjore dhe planifikimit të programeve. Së pari, ky seksion shqyrton në çfarë mase ligjet dhe politikat e Kosovës janë në përputhje me zotimet ndërkombëtare dhe rajonale në kuadër të Agjendës së GPS-së. Më pas, në këtë seksion diskutohet niveli i ndjeshmërisë gjinore në ligjet dhe politikat që lidhen me këtë agjendë, si dhe mundësitë për përmirësime të mëtejshme.

4.1. Korniza ligjore dhe e politikave ndërkombëtare

Ky seksion përshkruan shkurtimisht kornizën ndërkombëtare ligjore dhe të politikave që lidhet me Agjendën për GPS-në, si dhe vlerëson se në çfarë mase ligjet dhe politikat e Kosovës janë në përputhje me zotimet ndërkombëtare.

4.1.1. Konventa e OKB-së për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave

Konventa e Kombeve të Bashkuara (OKB) për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave (CEDAW) e vitit 1979 përcakton se diskriminimi ndaj grave përbën shkelje të të drejtave të tyre të barabarta dhe të dinjitetit njerëzor.[13] Edhe pse CEDAW nuk përmban dispozita të drejtpërdrejta që lidhen me Agjendën GPS, ajo përfshin detyrime të përgjithshme ligjërisht të detyrueshme për shtetet palë në drejtim të mosdiskriminimit dhe barazisë gjinore.[14] Rekomandimet e saj të përgjithshme njohin situatat në të cilat gratë përballen me diskriminim dhe u kërkojnë shteteve të ndërmarrin masa konkrete për të arritur barazinë gjinore. CEDAW thekson se "mirëqenia e botës dhe kauza e paqes kërkojnë pjesëmarrjen maksimale të grave, në kushte të barabarta me burrat, në të gjitha fushat e jetës". Kushtetuta e Kosovës e njeh dhe e përfshin në mënyrë të qartë CEDAW-në në nenin 22, duke e bërë atë të zbatueshme drejtpërdrejt dhe me "përparësi ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike".[15]

---

[10] Gazeta Zyrtare e UNMIK-ut, Security Council Resolution 1244 [Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit], 1999.
[11] Gazeta Zyrtare e UNMIK-ut, Regulation No. 1999/1 [Rregullorja nr. 1999/1], 1999.
[12] Human Rights Watch, "Failure to Protect: Anti-Minority Violence in Kosovo, March 2004" [Dështim në mbrojtje: Dhuna ndaj minoriteteve në Kosovë, mars 2004], 2004; Fondi për të Drejtën Humanitare, "The March violence in Kosovo – a reminder of the facts" [Dhuna e marsit në Kosovë – një përkujtimi e fakteve], 2021.
[13] Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, CEDAW, 1979.
[14] Rashida Manjoo, "Women, Peace and Security – Negotiating in Women's Best Interests" [Gratë, paqja dhe siguria – Negociatat në interes të grave], 2016, f. 268.
[15] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008, neni 22.

4.1.2. Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për gratë, paqen dhe sigurinë

Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (RKSKB) mbi GPS-në (2000) përfshin katër shtylla kryesore: parandalimin, mbrojtjen, pjesëmarrjen dhe lehtësimin e rimëkëmbjen.[16] Ajo shpreh shqetësimin se shumica e personave të prekur nga konfliktet e armatosura janë gra dhe vajza, dhe thekson rëndësinë e njohjes së rolit të tyre në parandalimin, zgjidhjen dhe konsolidimin e paqes. Rezoluta thekson se gratë duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë plotësisht në të gjitha proceset e vendimmarrjes, nga niveli lokal deri në atë ndërkombëtar, dhe nënvizon domosdoshmërinë që operacionet dhe negociatat e paqes të përfshijnë perspektivën gjinore. RKSKB 1325 u kërkon të gjitha shteteve t'i japin fund pandëshkueshmërisë dhe të ndjekin penalisht personat përgjegjës për gjenocid, krime kundër njerëzimit dhe krime lufte – veçanërisht ato të natyrës seksuale kundër grave dhe vajzave –duke kërkuar që krime të tilla të mos amnistohen. Ajo ka shërbyer si bazë për një sërë rezolutash "simotra" të GPS-së,[17] të cilat fokusohen në pjesëmarrjen në proceset e paqes, parandalimin e dhunës seksuale dhe sigurimin e drejtësisë për viktimat.

Në raportin e vitit 2024 mbi GPS-në (RKSKB 1325, 2122 dhe 2493), Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së (SP) vëren se shpesh misionet paqeruajtëse dhe ato politike kanë kohë të kufizuar për të planifikuar dhe zbatuar projekte që mbështesin barazinë gjinore dhe Agjendën GPS, duke i lënë gratë në situata të rrezikshme dhe të cenueshme.[18]. SP thekson rëndësinë e analizës gjinore në proceset e tranzicionit në zonat e prekura nga konflikti – një kërkesë që përmendet në shumë rezoluta të OKB-së, por që shpesh nuk zbatohet plotësisht. Analiza gjinore për të udhëhequr fondet e rimëkëmbjes pas konfliktit vlerësohet si thelbësore. Qeveritë, institucionet financiare ndërkombëtare dhe sektori privat inkurajohen të kuptojnë më mirë rolin e punës së kujdesit dhe ta përfshijnë atë në strategjitë e rimëkëmbjes ekonomike të vendeve të prekura nga konflikti. Përveç kësaj, SP thekson se analiza gjinore është thelbësore edhe në kontekstin e krizës klimatike, duke ndihmuar në identifikimin e ndikimeve ekonomike dhe joekonomike, përfshirë dhunën me bazë gjinore dhe punën e papaguar.

Edhe pse me PKBGj-në 2020–2024 u bë zotimi për zbatimin e Agjendës për GPS-në, korniza ligjore aktuale e Kosovës nuk përmban zotime të qarta ndaj RKSKB 1325 apo rezolutave të saj "simotra". Aktualisht, Kosova nuk ka një plan veprimi për zbatimin e RKSKB 1325 dhe ende nuk ka politika të veçanta për zhvillim dhe ndihmë humanitare.[19] Ligji për barazinë gjinore (LBGj) parashah që analiza gjinore dhe integrimi i perspektivës gjinore të përdoren për të udhëhequr të gjitha ligjet dhe programet.[20]

4.1.3. Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm

Kosova ka treguar angazhimin e saj për zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) të OKB-së për vitin 2030, duke miratuar njëzëri një rezolutë mbi OZHQ-të në vitin 2018.[21] OZHQ-të përbëhen nga 17 objektiva globale të miratuara nga OKB-ja për të promovuar qëndrueshmërinë sociale, ekonomike dhe mjedisore dhe BE-ja i ka integruar këto objektiva në politikat e saj.[22] Zotimet e Kosovës ndaj OZHQ-ve janë reflektuar në dokumente që lidhen me integrimin në BE, si Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) dhe Agjenda Evropiane e Reformave. Objektivi 5.5 i OZHQ-së bën thirrje për pjesëmarrje të plotë dhe efektive të grave dhe mundësi të barabarta për lidership në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në jetën politike, ekonomike dhe publike, një çështje relevante për institucionet e sigurisë, negociatat dhe proceset e dialogut. OZHQ 5

[16] Këshilli i Sigurimit i OKB-së, UNSCR 1325, 2000.
[17] Këshilli i Sigurimit i OKB-së, UNSCR 1820, 2008; UNSCR 1888, 2009; UNSCR 1889, 2009; UNSCR 1960, 2010; UNSCR 2106, 2013; UNSCR 2122, 2013.
[18] KSKB, "Women and peace and security - Report of the Secretary-General" [Gratë, paqja dhe siguria – Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm], 2024.
[19] Komisioni Evropian, "Raporti për Kosovën 2024", 2024, f. 20.
[20] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2015, neni 5.
[21] Ekipi i OKB-së në Kosovë "Kosovo Parliament Unanimously Adopts SDG Resolution" [Kuvendi i Kosovës miraton njëzëri Rezolutën për OZHQ-të], 2018.
[22] Komisioni Evropian, "Sustainable development in the European Union: Monitoring report on progress towards the SDGs in an EU context – 2022 edition"[Zhvillimi i qëndrueshëm në Bashkimin Evropian: Raporti i monitorimit mbi progresin drejt OZHQ në kontekstin e BE-së – Botimi 2022], Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian, 2022.

gjithashtu nxit qeveritë të zbatojnë buxhetimin e përgjegjshëm gjinor (BPGj), duke kërkuar analizë gjinore për të informuar planifikimin e programeve, mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe *ex-post* vlerësimet e ndikimit gjinor. Këto zotime duhet të ndikojnë në planifikimin e programeve qeveritare në fushën e paqes dhe sigurisë.

Edhe pse LBGj i Kosovës e përmend BPGj-në, ai nuk është institucionalizuar në ligjet për financat publike, prokurimin dhe financat e pushtetit lokal. Kjo kufizon zbatimin e tij, përfshirë ndarjet adekuate të buxhetit për Agjendën GPS dhe përpjekjet më të gjera për barazi gjinore.

Përveç informacionit të kufizuar mbi aktivitetet e Ekipit të OKB-së në Kosovë (UNKT), nuk ka raporte qeveritare mbi zbatimin e OZHQ-ve në dispozion për publikun. Thuhet se është krijuar një grup parlamentar për të monitoruar progresin e OZHQ-ve, por nuk ka informacion publik mbi ekzistencën ose aktivitetet e tij. Të dhënat e paraqitura në këtë analizë sugjerojnë për një përparim të ngadaltë drejt arritjes së OZHQ 5 për Barazinë Gjinore, veçanërisht në lidhje me pjesëmarrjen politike të grave. Monitorimi nga shoqëria civile i treguesit OZHQ 5.c.1 mbi BPGj-në tregon një zbatim të kufizuar,[23] i cili mund të ndikojë në ndarjet e dobëta të buxhetit për paqen dhe sigurinë.

4.1.4. Zotimet e BE-së ndaj Agjendës GPS

Në vitin 2012, BE-ja miratoi Politikën e Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes (CSDP) mbi zbatimin e RKSKB 1325, me qëllim përmirësimin e balancës gjinore në misionet dhe operacionet e CSDP-së, si Misioni i BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX). Korniza Strategjike pasuese për Misionet Civile të CSDP -së për periudhën 2018–2023 synonte të forconte CSDP-në civile të BE-së përmes 10 udhëzimeve strategjike,[24] duke sjellë një përparim të kufizuar në rritjen e përfaqësimit të grave në misionet ndërkombëtare, nga 22% në vitin 2018 në 24% në vitin 2023.[25] CSDP-ja e vitit 2023 përfshin zbatimin e RKSKB 1325 si një udhëzues dhe angazhim strategjik, duke siguruar "pjesëmarrje të plotë, të barabartë dhe kuptimplote të grave në të gjitha funksionet, përfshirë pozicionet udhëheqëse",[26] dhe përcakton objektivin për përfaqësimin e grave në minimum 40%.

Qasja strategjike e BE-së ndaj GPS-së u ndërtua mbi dhe zëvendësoi Qasjen e Përgjithshme të vitit 2008 për zbatimin e RKSKB 1325 dhe 1820.[27] Ajo nuk ka një afat të përcaktuar kohor dhe shërben si një kornizë politike afatgjatë për integrimin e Agjendës GPS në të gjitha veprimet dhe politikat e jashtme të BE-së. Qasja Strategjike zotohet për veprime që synojnë arritjen e paqes dhe sigurisë së qëndrueshme duke fuqizuar, mbrojtur dhe mbështetur gratë dhe vajzat. Qasja Strategjike njeh barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave si parakusht për trajtimin e konfliktit dhe synon të sigurojë pjesëmarrje domethënëse të grave në të gjitha aspektet e paqes dhe sigurisë. Ajo identifikon veprime në fushat kryesore të parandalimit, mbrojtjes, ndihmës dhe rimëkëmbjes, së bashku me integrimin e perspektivës gjinore dhe pjesëmarrjen aktive. Qasja Strategjike e BE-së përcakton masa mbështetëse për zbatimin e Agjendës GPS, të mbuluara nga treguesit e Planit të Veprimit, të cilat mund të ndihmojnë në vlerësimin e zbatimit. Këto përfshijnë: mbështetje politike për zbatimin; financim dhe burime; ndërtim kapacitetesh dhe trajnime; shkëmbim informacioni dhe praktikash të mira; udhëheqje dhe përgjegjshmëri; mbështetje përmes këshilltarëve dhe personave përgjegjës për çështje gjinore; mekanizma të fortë monitorimi, vlerësimi dhe raportimis; dhe PKV si mjete kyçe për zbatimin e Agjendës GPS. Agjenda GPS e BE-së ka

---

[23] Rrjeti i Grave të Kosovës, "Monitorimi i zbatimit të treguesit 5.c.1 të OZHQ në Kosovë", 2022.

[24] Këshilli i Bashkimit Evropian, "Conclusions of the Council and of the Representatives of the Governments of the Member States, meeting within the Council, on the establishment of a Civilian CSDP Compact"[Konkluzionet e Këshillit dhe përfaqësuesve të qeverive të shteteve anëtare, mbledhur brenda Këshillit, mbi themelimin e Kornizës Civile CSDP], 2018.

[25] Timo Smit, "New Compact, Renewed Impetus: Enhancing The EU's Ability to Act Through its Civilian CSDP" [Kornizë e re, impuls i ri: Forcimi i aftësisë së BE-së për të vepruar përmes CSDP-së së saj civile], SIPRI, 2023.

[26] Këshilli i Bashkimit Evropian, European Union Common Security and Defence Policy Civilian CSDP Compact: Towards more effective civilian missions [Kornizë strategjike civile Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes së BE-së (CSDP): Drejt misioneve civile më efektive], 2023, f. 12.

[27] Këshilli i Bashkimit Evropian, Qasja Strategjike e BE-së ndaj GPS-së në Gratë, paqen dhe sigurian – Konkluzionet e Këshillit, 2018.

qenë kryesisht e përqendruar te përfaqësimi i grave,[28] është përqendruar kryesisht në përfaqësimin e grave, duke anashkaluar aspekte të tjera të Agjendës GPS.[29].

Për të zbatuar këtë kornizë strategjike, BE-ja miratoi Planin e Veprimit për GPS për vitet 2021–2024, i cili tashmë ka skaduar. Ky plan ofroi një kornizë gjithëpërfshirëse për BE-në dhe Shtetet Anëtare për të çuar përpara zbatimin e Agjendës së GPS-së në të gjitha misionet dhe politikat e tyre. Në Kosovë, EULEX-i, si misioni më i madh civil, mbështet institucionet e zbatimit të ligjit, duke siguruar përputhshmëri me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe praktikat më të mira të BE-së.[30] Këto përgjegjësi kërkojnë që institucionet të adaptojnë dhe zbatojnë Planin e Veprimit për GPS-në në punën e tyre, duke mbështetur dhe monitoruar Qeverinë e Kosovës në këtë proces. Plani gjithashtu inkurajoi palët e treta të ndërmarrin veprime që kontribuojnë në përmbushjen e gjashtë objektivave të tij,[31] duke përfshirë rritjen e pjesëmarrjes së grave në proceset e paqes dhe sigurisë, promovimin e drejtësisë për të mbijetuarit e dhunës me bazë gjinore të lidhur me konfliktin, integrimin e çështjeve gjinore në strategjitë kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe sigurimin që përpjekjet e ndihmës dhe rimëkëmbjes të adresojnë nevojat specifike të grave.

Plani i Veprimit për GPS-në ka disa fokuse kryesore: së pari, rritjen e pjesëmarrjes dhe lidershipit të grave në paqe dhe siguri, duke vendosur objektiva për përmirësimin e balancës gjinore në misionet dhe operacionet e CSDP-së, dhe përfshirjen e grave në proceset e paqes përmes ndërtimit të kapaciteteve dhe mentorimit. Së dyti, ai thekson nevojën për integrimin sistematik gjinor në të gjitha politikat dhe iniciativat e BE-së, duke përfshirë zhvillimin e mjeteve dhe metodave për analizën dhe integrimin gjinor në të gjitha kornizat e politikave, përfshirë misionet dhe operacionet e CSDP-së. Analiza e rregullt gjinore duhet të kryhet për planifikimin dhe shqyrtimin e misioneve dhe operacioneve. Plani gjithashtu parashikon trajnime gjinore për të gjithë stafin, përfshirë trajnimin para angazhimit në mision, dhe përfshin përgjegjësitë e GPS-së në përshkrimet e punës dhe vlerësimet e performancës për pozicionet udhëheqëse. Ai kërkon politika për parandalimin dhe ndëshkimin e shfrytëzimit seksual, abuzimit dhe ngacmimit seksual. Gjithashtu, merr përsipër zbatimin e politikave të llogaridhënies për të ndihmuar në dhënien fund të pandëshkueshmërisë dhe sjelljen e autorëve para drejtësisë. Plani thekson mbështetjen për viktimat dhe të mbijetuarit e dhunës seksuale dhe të dhunës me bazë gjinore të lidhur me konfliktin, si dhe integrimin e perspektives gjinore në strategjitë kundër ekstremizmit të dhunshëm. Së fundmi, fokusohet në përpjekjet e ndihmës dhe rimëkëmbjes, duke siguruar që ato adresojnë nevojat e grave dhe vajzave të prekura nga konflikti, duke marrë parasysh kërkesat specifike të grave në proceset e çarmatimit, demobilizimit dhe riintegrimit. Ekzistojnë tregues për të vlerësuar zbatimin e planit.[32].

Që nga qershori i vitit 2025, BE-ja nuk ka miratuar ndonjë Plan Veprimi të ri të pavarur për të pasuar Planin e Veprimit GPS 2019–2024. Megjithatë, Agjenda GPS është integruar në PVGj III të BE-së, e lansuar në vitin 2020 dhe e parashikuar të zgjasë deri në vitin 2027.[33] PVGj III përfshin prioritetet e GPS-së, duke përfshirë pjesëmarrjen, mbrojtjen, parandalimin, ndihmën dhe rimëkëmbjen, dhe synon që 85% e të gjitha veprimeve të reja të kontribuojnë në barazinë gjinore deri në vitin 2025.

Në vitin 2024, Këshilli i BE-së riafirmoi zotmin e tij ndaj Agjendës GPS, duke theksuar nevojën për pjesëmarrje të plotë, të barabartë dhe kuptimplote të grave në të gjitha aspektet e paqes dhe sigurisë.[34] Këshilli theksoi rëndësinë e integrimit të perspektives gjinore në misionet dhe operacionet e

---

[28] Shërbimi Evropian për Veprim të Jashtëm, Strategy and Action Plan to Enhance Women's Participation in Civilian CSDP Missions 2021-2024 [Strategjia dhe plani i veprimit për forcimin e pjesëmarrjes së grave në misionet civile CSDP 2021-2024], 2021.

[29] Anna Molnár dhe Veronika Hornyák Gracza, "Women, Peace and Security in EU Interventions: Analysing EULEX and Operation Irini"[Gratë, paqja dhe siguria në ndërhyrjet e BE-së: Analizimi i EULEX-it dhe Operacionit Irini], *Journal of Intervention and Statebuilding*, 2024.

[30] EULEX, "MIsioni", n.d.

[31] Këshilli i Bashkimit Evropian, EU Action Plan on Women, Peace and Security (WPS) 2019-2024 [Plani i veprimit i BE-së për gratë, paqen dhe sigurinë (GPS) 2019-2024],2019.

[32] Këshilli i Bashkimit Evropian, EU Strategic Approach to Women, Peace and Security (WPS) [Qasja strategjike e BE-së për gratë, paqen dhe sigurinë (GPS)].2018.

[33] Parlamenti Evropian, EU Action Plan on Gender Equality (GAP III) Legislative Train Schedule [Plani i veprimit i BE-së për barazinë gjinore (PVGj III) - Plani legjislativ], (n.d.).

[34] Këshilli i Bashkimit Evropian, Council conclusions on women, peace and security [Konkluzionet e Këshillit mbi gratë, paqen dhe sigurinë], 2022.

CSDP-së të BE-së, duke siguruar që barazia gjinore të integrohet në të gjitha politikat e BE-së. Ai bëri thirrje për rritje të përpjekjeve për parandalimin dhe për t'u përgjigjur ndaj dhunës seksuale dhe dhunës me bazë gjinore, duke theksuar domosdoshmërinë e qasjeve që vendosin në qendër viktimat dhe të mbijetuarit/at. Për më tepër, Këshilli njohu nevojën për lidership të përgjegjshëm nga aspekti gjinor dhe forcimin e ekspertizës gjinore brenda strukturave të BE-së. Strategjia dhe plani i veprimit për të rritur pjesëmarrjen e grave në misionet civile të CSDP-së 2021–2024 u fokusuan në rritjen e ndjeshme të numrit të grave në personel në të gjitha nivelet.

Kosova nuk është ende shtet anëtar i BE-së dhe, për pasojë, nuk është e detyruar të zbatojë Planin e Veprimit GPS. Megjithatë, duke pasur parasysh aspiratat e saj për anëtarësim në BE, përputhja me zotimet e BE-së për GPS, duke përfshirë konkluzionet përkatëse të Këshillit dhe çdo plan veprimi të ardhshëm të BE-së, mund të jetë e dobishme për vendin.

4.1.5. PVGj III i BE-së dhe CLIP për Kosovën

Duke u bazuar në dy planet e mëparshme, PVGj III i BE-së është një dokument pune i stafit të Komisionit Evropian (KE) për barazinë gjinore në marrëdhëniet e jashtme të BE-së dhe përfshin fokusin në Agjendën GPS. Delegacionet, përfshirë ZBE, janë zotuar të zbatojnë Planin e zbatimit në nivel vendi 2021–2025 (CLIP) për PVGj III. CLIP për Kosovën thekson se, edhe pse RKSKB 1325 nuk përmendet në mënyrë të qartë në ligjin e Kosovës, objektivat e saj janë integruar në PKBGj 2020–2024, me fokus në vendimmarrje, drejtësi, paqe, siguri dhe pjesëmarrje të barabartë në sektorin e sigurisë.[35] Plani thekson nën-përfaqësimin e grave, veçanërisht të grave nga pakicat etnike, në proceset e vendimmarrjes. Ai vëren gjithashtu se, pavarësisht zotimeve ndaj RKSKB 1325, prioritetet e grave kanë qenë të nën-përfaqësuara në Dialogun Beograd-Prishtinë. CLIP zotohet për avancimin e Agjendës GPS dhe thekson nevojën për të përfshirë OShCG-të dhe gratë në dialogët politikë dhe proceset e paqes. EULEX-i është zotuar të vazhdojë promovimin e pjesëmarrjes së grave në institucionet e sigurisë.[36] Megjithatë, deri tani nuk ka pasur monitorim mbi zbatimin e objektivave të CLIP-it në lidhje me Agjendën GPS. Qeveria e Republikës së Kosovës nuk ka detyrime ligjore për të zbatuar PVGj-në III të BE-së ose CLIP-in. Megjithatë, përafrimi i përpjekjeve të saj me objektivat e CLIP-it mund të jetë në përputhje me prioritetet kombëtare dhe të kontribuojë në avancimin e paqes dhe sigurisë. Për më tepër, bashkëpunimi me BE-në për zbatimin e CLIP-it mund të krijojë mundësi për burime shtesë dhe mbështetje për Agjendën GPS.

4.2. Korniza ligjore kombëtare

4.2.1. Kushtetuta

Kushtetuta e vitit 2017 garanton të drejtat dhe liritë e njeriut për të gjithë qytetarët, duke përfshirë mbrojtjen e grupeve etnike minoritare dhe pjesëmarrjen e tyre.[37] Siguron përfaqësim gjinor në institucionet shtetërore dhe garanton të drejtën për siguri për të gjithë.[38] Neni 22 përcakton se marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare janë të zbatueshme drejtpërdrejt dhe kanë përparësi mbi ligjet dhe politikat lokale. Kjo përfshin CEDAW, Konventën kornizë të Këshillit të Evropës për mbrojtjen e pakicave kombëtare, Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor dhe Konventën e Stambollit. CEDAW thekson se "mirëqenia e botës dhe kauza e paqes kërkojnë pjesëmarrjen maksimale të grave në kushte të barabarta me burrat në të gjitha fushat."[39]

Në lidhje me përgjegjësitë institucionale, Kushtetuta e ngarkon Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) me reagimin ndaj krizave, mbrojtjen civile dhe misionet e mbrojtjes; Policinë e Kosovës me sigurinë publike, zbatimin e ligjit dhe parandalimin e krimit; Këshillin e Sigurisë së Kosovës me këshillimin për çështjet e sigurisë kombëtare; dhe Ministrinë e Mbrojtjes me mbikëqyrjen e politikës së mbrojtjes dhe zhvillimin e FSK-së. Kushtetuta përputhet gjerësisht me parimet e BE-së mbi proceset e paqes përmes

[35] ZBE, Përfaqësuesi Special i BE-së në Kosovë, Shefi i Zyrë, Gender Action Plan III – 2021-2025 Country Level Implementation Plan for Kosovo [Plani i veprimit gjinor III – 2021-2025, plani i zbatimit në nivel vendi për Kosovën], 2021, f. 1.
[36] Po aty., f. 5.
[37] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2017, nenet 1.2, 57–62.
[38] Po aty., nenet 71 dhe 29.
[39] Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, CEDAW, 1979.

zotimeve të saj për të drejtat e njeriut dhe një shoqëri demokratike dhe gjithëpërfshirëse. Megjithatë, ajo nuk i referohet në mënyrë të qartë Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, RKSKB 1325 ose rezolutave të saj "simotra". Përmbushja e zotimeve të saj, veçanërisht në lidhje me përfaqësimin e barabartë gjinor, mbetet i pamjaftueshëm.

4.2.2. Ligji për barazinë gjinore dhe ligjet zgjedhore

LBGj i vitit 2015 siguron barazinë gjinore si një "vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë", duke ofruar mundësi të barabarta për pjesëmarrjen si të grave ashtu edhe të burrave në fushat politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe fusha të tjera të jetës shoqërore".[40] Ky ligj përcakton pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e barabartë si 50% për secilën gjini në organet qeverisëse dhe vendimmarrëse të të gjitha institucioneve legjislative, ekzekutive, gjyqësore dhe institucioneve të tjera publike. Institucionet duhet të ndëmarrin masa të përkohshme të posaçme për të përshpejtuar barazinë gjinore, të cilat mund të përfshijnë kuota, programe për të rritur pjesëmarrjen e gjinisë më pak të përfaqësuar në vendimmarrje, fuqizimin ekonomik, si dhe masa për të adresuar pabarazitë.[41].

Ligji për zgjedhjet e përgjithshme (2023) dhe Ligji për zgjedhjet lokale (2008) nuk janë në përputhje me LBGj-në,[42] pavarësisht avokimit për të rritur kuotën prej 30% në 50% për secilën gjini në listat e kandidatëve të partive politike.[43] Pra, pjesëmarrja prej 50% e secilës gjini e paraparë me LBGj nuk po zbatohet në Kuvend ose në Qeverinë e Kosovës. Në praktikë, partitë politike zakonisht respektojnë vetëm ligjet zgjedhore në këtë drejtim. Edhe pse Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se ligjet zgjedhore janë në përputhje me Kushtetutën,[44] kjo nuk e përjashton mundësinë e përdorimit të masave afirmative për të arritur barazinë gjinore në vendimmarrje, siç parashikohet në LBGj. Ndryshimi i ligjeve zgjedhore për të përcaktuar përfaqësim 50% si për gratë, ashtu edhe për burrat në listat e kandidatëve, do të mundësonte zbatimin më të plotë të LBGj-së dhe do të nxiste pjesëmarrjen e barabartë të grave në kuvendet kombëtare dhe komunale. Një qasje e tillë do të mund të rriste përfshirjen e grave në proceset e paqes, në mbikëqyrjen e institucioneve të sigurisë dhe në ndarjen e fondeve shtetërore për programet e paqes dhe sigurisë. Megjithatë, dispozitat për përfaqësim të barabartë mbeten ende të pazbatuara në sektorët e sigurisë dhe të drejtësisë, siç theksohet më tej në këtë analizë; për këtë arsye, masat afirmative janë të domosdoshme për të adresuar nën-përfaqësimin e grave në përputhje me LBGj-në. Ligji gjithashtu parashah BPGj-në, por kjo ende nuk është institucionalizuar përmes harmonizimit të LBGj-së me Ligjin për financat publike dhe ligje të tjera përkatëse. Një hap i tillë do të kontribuonte në zbatimin efektiv të BPGj-së në të gjithë sektorët, përfshirë sigurinë dhe drejtësinë.

4.2.3. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi (2015) u miratua për të siguruar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin mbi baza të ndryshme, përfshirë atë gjinore.[45] Ky ligj ndalon në mënyrë të qartë diskriminimin bazuar në gjini, etni, orientim seksual dhe identitet gjinor. Ai gjithashtu detyron të gjitha subjektet publike dhe private të garantojnë pjesëmarrje të barabartë të grave dhe burrave në të gjitha sferat e jetës, përfshirë sektorët politik, ekonomik, social, kulturor dhe civil. Edhe pse ligji adreson në mënyrë gjithëpërfshirëse pjesëmarrjen e barabartë dhe mosdiskriminimin, ai nuk e përmend në mënyrë të drejtpërdrejtë lidhjen ndërmjet grave, paqes dhe sigurisë. Megjithatë, duke promovuar barazinë gjinore dhe duke ndaluar diskriminimin, ai vendos themelet për të mbështetur përfshirjen e grave në të gjitha fushat e jetës, përfshirë edhe sektorët e paqes dhe sigurisë.

---

[40] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore, 2015.
[41] Po aty, neni 6.
[42] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, 2023; Ligji Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, 2008.
[43] Koha.net, "*RrGK: Barazia gjinore është obligim ligjor në zgjedhjet lokale*", 2021.
[44] Gjykata Kushtetuese e Kosovës, Rasti KO15/24 Vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 28 të Ligjit nr. 08/L-228 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, 2024.
[45] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, 2015.

4.2.4. Ligji për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave të dhunës seksuale të luftës, viktimave civile dhe familjeve të tyre

Ky ligj i vitit 2014 përcakton statusin dhe ofron mbështetje financiare përmes pensioneve dhe përfitimeve për individët dhe familjet që kontribuuan në çlirimin e vendit, duke përfshirë dëshmorët, invalidët e luftës, veteranët, anëtarët e UÇK-së, viktimat civile dhe familjarët e tyre të afërt.[46] Pas viteve të avokimit të palodhur nga OShCG-të dhe gratë në politikë,[47] Kuvendi e ndryshoi ligjin në vitin 2014 për të njohur të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës, duke u ofruar atyre përfitime të ngjashme me ato të veteranëve të tjerë, përfshirë edhe një pension mujor.[48] Ligji parashihte një afat pesëvjeçar për viktimat e dhunës seksuale të luftës që të paraqesin aplikimet për njohje dhe përfitime. Në vitin 2025, ky afat u zgjat për dy vjet, deri më 15 maj 2027. OShCG-të kanë avokuar për heqjen e plotë të këtij afati,[49] siç u ritheksua në fushatën "Trauma nuk ka afat".[50] Aktivistët gjithashtu kanë kërkuar zgjatjen e periudhës kohore për përcaktimin e viktimave të luftës përtej vitit 1999, me qëllim njohjen e dhunës seksuale të përjetuar edhe nga komunitetet rom, ashkali, egjiptian dhe serb. Aktualisht, vetëm personat që kanë përjetuar dhunë seksuale ndërmjet datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999 mund të aplikojnë për këtë status dhe për përfitimet përkatëse.[51] Sipas aktivistëve, kjo përbën një standard të dyfishtë, pasi Ligji për Personat e Zhdukur parashikon afat deri në vitin 2000.[52] Ata, së bashku me Amnesty International kanë argumentuar se të gjitha viktimat duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë, pavarësisht se kur kanë përjetuar dhunë.[53]

4.2.5. Ligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës

Ligji (2018) rregullon themelimin, rolin dhe funksionimin e FSK-së në lidhje me sigurinë, mbrojtjen dhe sovranitetin e Kosovës.[54] Ky ligj përfshin dispozita për rekrutimin, trajnimin dhe operacionet. Ligji nuk trajton sigurinë publike dhe nuk përmban dispozita për pjesëmarrje të barabartë të grave në FSK, kuota për promovimin e barazisë gjinore apo mekanizma për të siguruar përfshirjen e grave në ndërtimin e paqes dhe sigurinë. Ligji kërkon që Qeveria e Republikës së Kosovës të miratojë një Strategji të Mbrojtjes me rekomandime nga Ministri i Mbrojtjes.[55] Gjithashtu i jep Këshillit të Sigurisë, të kryesuar nga Kryeministri, kompetencën për të përgatitur Strategjinë e Sigurisë për Kosovën në bashkëpunim me Presidentin/en dhe Qeverinë.[56]

---

[46] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, 2011.

[47] Rrjeti i Grave të Kosovës, "Një ulëse në tryezë: Kontributi i grave në proceset e ndërtimit të paqes në Kosovë dhe pritjet e tyre nga këto procese", 2021, f. 63.

[48] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 04/l-172 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/l-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të ushtrisë çlirimtare të kosovës, viktimave të dhunës seksuale të luftës, viktimave civile dhe familjarëve, 2014.

[49] Radio Evropa e Lirë, "*Afati i verifikimit të statusit për viktimat e dhunës seksuale të luftës*", 2023.

[50] Veronë Zymberi, "*Lansohet fushata 'Trauma nuk ka afat' në mbështetje të të mbijetuarve të dhunës seksuale të luftës*", Kallxo.com, 2025.

[51] UN Women, "Reparations for conflict-related sexual violence"[Reparacione për dhunën seksuale të lidhur me konfliktin], 2018.

[52] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 04/L-023 Për Personat e Zhdukur, 2011.

[53] Intervistë e RrGK-së me një aktiviste nga OShCG, 2025. Shih edhe Amnesty International, "Plagë që të djegin shpirtin". kompensim për të mbijetuarit e përdhunimit gjate luftës, por drejtësi s'ka akoma", 2017.

[54] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës , 2018.

[55] Po aty, neni 18.

[56] Po aty, nenet 18, 19.

4.2.6. Ligji për arsimin

Ky ligj (2011) synon, ndër qëllime të tjera, të nxisë "mirëkuptim, paqe, tolerancë, barazi gjinore dhe miqësi me anëtarët e të gjitha komuniteteve" te nxënësit.[57] Ai i bën thirrje punonjësve të arsimit që "të ndërmarrin të gjitha hapat e arsyeshëm për të siguruar që nxënësit dhe stafi të mos lëndohen ose të mos ekspozohen ndaj ndonjë fjale ose veprimi fyes".[58] Ligji ndalon gjithashtu "aktivitetet jashtë Kornizës së Kurrikulës së Kosovës që shkojnë në dobi ose dëm të çdo partie politike, gjinie, race, prejardhjeje etnike, feje ose pozite shoqërore" dhe thekson se "nxënësve duhet t'u ofrohet një prezantim i ekuilibruar i pikëpamjeve kundërshtare". Në mënyrë të ngjashme, Ligji për Arsimin Parauniversitar bën thirrje për përgatitjen e nxënësve "për një jetë të përgjegjshme në frymën e mirëkuptimit, paqes, tolerancës, barazisë gjinore dhe miqësisë me anëtarët e të gjitha komuniteteve."[59] Të dyja ligjet trajtojnë me ndjeshmëri çështjet gjinore.

Megjithatë, monitorimi i kufizuar sugjeron se institucionet arsimore nuk po kontribuojnë në mënyrë të mjaftueshme në promovimin e paqes dhe tolerancës nga perspektiva gjinore.[60] Një shqyrtim i teksteve shkollore nga Institucioni i Avokatit të Popullit zbuloi se ato nuk përfaqësojnë në mënyrë adekuate komunitetet e ndryshme të Kosovës.[61] Hulumtimet tregojnë se mësimdhënësit shpesh ofrojnë një perspektivë të njëanshme të historisë, duke neglizhuar përvojat e etnive të ndryshme dhe duke përdorur terma përçmues.[62] Pedagogjia gjithashtu ka tendencë të forcojë stereotipet gjinore, në vend që t'i sfidojë ato.[63]

4.2.7. Ligji për përdorimin e gjuhës

Në përputhje me Kushtetutën, Ligji i vitit 2006 pohon statusin e barabartë të gjuhës shqipe dhe gjuhës serbe si gjuhë zyrtare dhe parashikon që gjuhët e tjera, të folura nga të paktën 3% e popullsisë në një komunë, të përdoren zyrtarisht,[64] duke përfshirë edhe ofrimin e arsimit në këto gjuhë. Ligji nuk përmban asnjë referencë ndaj çështjeve gjinore.

Institucionet publike në nivel qendror dhe komunal kanë pasur vështirësi në zbatimin e të drejtave gjuhësore. Këto përfshijnë përkthimin e pamjaftueshëm të dokumenteve zyrtare, mungesën e tabelave dygjuhëshe dhe ofrimin e kufizuar të shërbimeve publike në gjuhët e pakicave.[65] Ndërgjegjësimi i qytetarëve dhe i nëpunësve civilë mbi të drejtat gjuhësore është i pamjaftueshëm, gjë që bën që shkeljet shpesh të mos raportohen. Zyra e Komisionerit për Gjuhët, përgjegjëse për monitorimin dhe promovimin e të drejtave gjuhësore, ka hasur sfida për shkak të burimeve të kufizuara dhe autoritetit të pamjaftueshëm zbatues.[66] Qeveria komunale dhe qendrore ka qenë e paqëndrueshme në zbatimin e ligjit, duke rezultuar në qasje të pabarabartë në shërbimet publike, informacion, punësim, drejtësi dhe të drejta të tjera për pakicat.[67] Gjykatat shpesh nuk kanë siguruar përkthim dhe interpretim të përshtatshëm për të pandehurit dhe dëshmitarët nga komunitetet e pakicave.[68] Perceptimet nga intervistat sugjerojnë

---

[57] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, 2011, neni 1, paragrafi 2.5.
[58] Po aty, neni 4, paragrafi 1.
[59] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, 2011.
[60] UN Women, "Voices of YOUth: Gender equality and social cohesion in the Western Balkans" [Zërat e të rinjve: Barazia gjinore dhe kohezioni shoqëror në Ballkanin Perëndimor], 2024.
[61] Qeveria e Republikës së Kosovës, Institucioni i Avokatit të Popullit, Ex-officio Nr. 3 31/2022 – Për harmonizimin e dispozitave të Sistemit të Përgjithshëm të Arsimit Parauniversitar të Kosovës me të drejtat e fëmijëve në arsim, 2022, f. 34.
[62] Valmira Rashiti, "*Qysh kemi ardhe deri tek liria: Kujtesa e cënuar tek gjeneratat e reja*", Kallxo.com, 2023.
[63] Hulumtimi i RrGK-së, botim në pritje 2025.
[64] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, 2007.
[65] Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, "OSCE Mission calls on Kosovo institutions to implement law on languages"[Misioni i OSBE-së bën thirrje për institucionet e Kosovës që të zbatojnë ligjin mbi gjuhët], 2008.
[66] Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve, "Strengthening Institutional Compliance with the Kosovo Law on the Use of Languages" [Forcimi i përputhshmërisë institucionale me ligjin e kosovës për përdorimin e gjuhëve].
[67] Departamenti i Shtetit të Shteteve të Bashkuara, "2023 Country Reports on Human Rights Practices: Kosovo" Raportet për Praktikat e të Drejtave të Njeriut 2023: Kosova], Bureau of Democracy, Human Rights, and Labor, 2024.
[68] Po aty.

se mungesa e qasjes në përkthim dhe informacioni jo i plotë ose jo cilësor mund të kontribuojë në dezinformim dhe ndjenja marginalizimi midis folësve të gjuhëve të pakicave. Kjo, nga ana tjetër, mund të nxisë pasiguri dhe, potencialisht, tensione që lidhen me konfliktin.

4.3. Strategjitë dhe planet e veprimit

Ky seksion shqyrton në çfarë mase strategjitë dhe planet e veprimit të Kosovës për sigurinë janë gjithëpërfshirëse dhe përgjegjëse ndaj çështjeve gjinore.

4.3.1. Kosovo's Action Plan on 1325

PKV-të për GPS konsiderohen si një mjet për formalizimin e parimeve të GPS-së dhe për adresimin e çështjeve më të ngutshme.[69] Kosova miratoi Planin e saj të Parë Kombëtar për GPS-në në vitin 2014, duke përfshirë periudhën 2013–2015.[70] Procesi i përgatitjes së PKV-në filloi në vitin 2012, duke u mbështetur në PKBGj-në 2008–2013, i cili përcaktonte objektivat, politikat dhe akterët përgjegjës për zbatimin e barazisë gjinore. Procesi i hartimit u vlerësua përgjithësisht për qasjen "multi-sektorale dhe gjithëpërfshirëse", duke përfshirë përfaqësues nga institucionet shtetërore, sistemi gjyqësor dhe shoqëria civile.[71] PKV synonte të rrisë kapacitetet për zbatimin e RKSKB 1325; të forcojë pjesëmarrjen e grave në shërbimin jashtë vendit, ndërtimin e paqes dhe operacionet e ruajtjes së paqes; të rrisë rolet e grave në forcat e sigurisë; të ndërtojë kapacitete për promovimin dhe udhëheqjen e grave në sektor; dhe të zvogëlojë pengesat për pjesëmarrjen e tyre në strukturat e sigurisë. Plani përfshinte aktivitete për krijimin e një kornize ligjore për "trajtimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e të mbijetuarve civilë të dhunës seksuale, torturës ose formave të tjera të dhunës gjatë konfliktit/luftës". Ai parashikonte dokumentimin e rasteve, qasje në drejtësi, mbështetje psikologjike, rehabilitim shëndetësor dhe fuqizim ekonomik. PKV nuk e përcaktonte qartë se cilat institucione ishin përgjegjëse për alokimin e buxhetit.[72] Sipas ABGj-së, 79% e aktiviteteve të PKV-së u zbatuan dhe, në atë kohë, konsiderohej shembullore në rajon.[73] Megjithatë, PKV-së i mungonte një proces i detajuar monitorimi dhe vlerësimi, duke përfshirë edhe shoqërinë civile. Ky plan nuk përcaktonte qartë detyrat e monitorimit dhe raportimit, gjë që krijoi paqartësi në zbatim; kishte alokime buxhetore të pamjaftueshme, të cilat penguan përparimin; dhe përmbante analizë të kufizuar të palëve të interesuara, duke ndikuar në koordinimin ndërinstitucional dhe ndërmjet organizatave.[74] Duke marrë parasysh këto sfida, një anketë e vitit 2025 me gra të angazhuara në fushën e paqes dhe sigurisë në Kosovë tregoi mendime të përziera për PKP-në: 17% e konsideruan as të efektiv, as të joefektiv; 17% e panë si disi ose shumë efektiv; 5% si disi ose shumë joefektiv; dhe 7% nuk ishin të sigurt[75], duke sugjeruar pasiguri mbi ndikimin e tij. Raporti i dytë i monitorimit nga ABGj identifikoi boshllëqe në zbatimin e aktiviteteve dhe nevojën për përmirësim të koordinimit ndërinstitucional.[76] Gjithashtu, kishte vështirësi në mbledhjen e të dhënave të ndara për të vlerësuar ndikimin e PKV-së tek grupe të ndryshme, përfshirë gratë nga pakicat.

---

[69] Nicole George dhe Laura J Shepherd, "Women, peace and security: Exploring the implementation and integration of UNSCR 1325" [Gratë, paqja dhe siguria: Eksplorimi i zbatimit dhe integrimit të RKSKB 1325], *International Political Science Review*, 2016, 37(3), 297–306.

[70] Qeveria e Republikës së Kosovës, Plani i veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325, "Gratë, Paqja dhe Siguria", Kosovë 2013-2015, 2013.

[71] Lidhja Ndërkombëtare e Grave për Paqe dhe Liri, Planet kombëtare të veprimit sipas rajoneve, "Kosovo", n.d.

[72] Agjencia për Barazi Gjinore (ABGj), Zyra e Kryeministrit (ZKM), "Plani Kombëtar i Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së: Gratë, Paqja dhe Siguria", 2014.

[73] Rrjeti i Grave të Kosovës, "Një ulëse në tryezë: Kontributi i grave në proceset e ndërtimit të paqes në Kosovë dhe pritjet e tyre nga këto procese", 2021.

[74] Olivera Injac dhe Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, "Gender and security sector in Kosovo: Implementation of the UN Resolution 1325" [Gjinia dhe sektori i sigurisë në Kosovë: Zbatimi i Rezolutës 1325 të OKB-së], 2015.

[75] Georgetown Institute for Women, Peace, and Security, "The Women, Peace and Security Survey", Research Report, 2025.

[76] Qeveria e Republikës së Kosovës, ZKM, ABGj, "Raporti i dytë i monitorimit mbi progresin e zbatimit të Planit të Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 'Gratë, Paqja dhe Siguria' 2013–2015", 2016.

Pas skadimit të PKV-së në vitin 2015, nuk u hartua ndonjë PKV i ri për ta zëvendësuar. Kosova nuk kishte një PKV nga viti 2015 deri në 2020. PKBGj-ja për periudhën 2020–2024 përfshiu objektiva të GPS-së, siç do të diskutohet në seksionin pasues. Qeveria e Kosovës planifikon të përfshijë në mënyrë të ngjashme një shtyllë të dedikuar Agjendës GPS në PKBGj-në 2025–2035.[77] Hartimi i tij është vonuar, kështu që deri në gusht 2025, Kosova nuk kishte PKV.

4.3.2. Programi i Kosovës për barazi gjinore 2020-2024

PKBGj 2020–2024 integroi disa aspekte të Agjendës GPS në Shtyllën 3: "Promovimi i realizimit të të drejtave në vendimmarrje, paqe, siguri dhe drejtësi, dhe sigurimi i arritjes së barazisë gjinore".[78] Ky objektiv synohej të arrihej përmes integrimit të perspektivës gjinore në ligje dhe politika, forcimit të mekanizmave institucionalë për qasjen në drejtësi, garantimit të pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave sipas LBGj-së, krijimit të një mjedisi të sigurt dhe jo-diskriminues në sektorin e sigurisë, si dhe rritjes së pjesëmarrjes së grave në proceset e negocimit, paqes dhe pajtimit. Plani parashikonte gjithashtu krijimin e një Bordi Këshillues për GPS në institucionet e sigurisë.[79]

PKBGj dhe Plani i Veprimit u fokusuan kryesisht në pjesëmarrjen e grave, sektorin e sigurisë dhe rehabilitimin e të mbijetuarave të dhunës seksuale. Përpjekjet më të gjera për rehabilitim të popullsisë së përgjithshme dhe ndihmë humanitare nuk ishin të përcaktuara si objektiva të qart. PKBGj nuk përfshiu perspektivë feministe të paqes, e cila do të synonte de-militarizimin dhe angazhimin aktiv të grave në proceset e paqes. Plani i Veprimit mbështetej kryesisht në financim nga donatorët, përfshirë shoqërinë civile, në vend që të sigurohej financimi adekuat nga buxheti i Qeverisë së Kosovës.

Bordi Këshillues për GPS në institucionet e sigurisë nuk është krijuar.[80] Në lidhje me Shtyllën 3, aktivitetet e mëposhtme të PKBGj-së nuk u zbatuan: ndërmarrja e masave afirmative për të rritur numrin e grave në sektorin e sigurisë; hulumtime mbi pozitën e grave në Policinë e Kosovës; studimet mbi ndikimin e armëve të vogla në sigurinë e burrave dhe grave; dhe avokimi për përfshirjen e grave në procesin e negocimit, paqes dhe pajtimit.

4.3.3. Strategjia për sundimin e ligjit 2021-2026

Kjo strategji (2021) përbëhet nga katër shtylla: sistemi gjyqësor dhe prokurorial, drejtësia penale, qasja në drejtësi dhe shërbime jo-gjyqësore, dhe anti-korrupsioni.[81] Synimi është të sigurohet pjesëmarrje e barabartë e grave dhe burrave në sektorin e sundimit të ligjit në të gjitha nivelet, duke kontribuar në arritjen e barazisë gjinore, forcimin e mekanizmave institucionalë dhe rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve mbi qasjen në drejtësi.[82] Strategjia thekson se qasja në drejtësi mbetet sfiduese për grupet e cenueshme, përfshirë gratë, fëmijët, personat e moshuar, komunitetin LGBTQI+ dhe pakicat etnike.[83] Rëndësi e veçantë i jepet krijimit të një mjedisi të sigurt për sundimin e ligjit. Strategjia përcakton masa për forcimin e sistemit të drejtësisë penale, rritjen e efikasitetit të organeve të zbatimit të ligjit dhe përmirësimin e koordinimit ndërmjet institucioneve të sigurisë, me qëllim luftimin e krimit dhe garantimin e sigurisë publike. Pjesëmarrja e grave në proceset dhe institucionet e paqes dhe sigurisë vlerësohet si e rëndësishme, dhe propozohen iniciativa për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e tyre në këto fusha.

Megjithëse Strategjia nuk i referohet në mënyrë eksplicite RKSKB 1325, në kuadër të kësaj strategjie theksohet rëndësia e integrimit të perspektivave gjinore në sistemin e drejtësisë dhe sigurimin

---

[77] Qeveria e Republikës së Kosovës, ZKM, "Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2025–2035 (PKBGj) Metodologjia dhe Udhëzimet për Hartimin e PKBGJ", 2024.
[78] Qeveria e Republikës së Kosovës, ZKM, ABGj, "Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024", 2020, f. 64.
[79] Po aty., f. 66.
[80] Republika e Kosovës, Qeveria, Zyra e Kryeministrit, Agjencia për Barazi Gjinore, "Raporti për Vlerësimin Final të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024", 2024, f. 82..
[81] Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Drejtësisë, Strategjia për sundimin e ligjit 2021-2026, 2021, f. 9.
[82] Po aty., f. 8.
[83] Po aty., f. 22.

e qasjes së barabartë në drejtësi, pa marrë parasysh gjininë.[84] Konstatohen nivele të ulëta të përfaqësimit të grave në institucionet gjyqësore,[85] dhe ato të zbatimit të ligjit, por objektivat aktuale nuk e adresojnë këtë çështje. Kishte mundësi që Strategjia të kishte një qasje më transformuese gjinore, për shembull duke specifikuar objektiva për ndryshimin e roleve gjinore dhe përmirësimin e qasjes së grave në drejtësi.

4.3.4. Strategjia dhe plani i veprimit kombëtar për kontrollin e armëve të vogla, armëve të lehta dhe eksplozivëve 2024-2028

Strategjia kombëtare për kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta (AVL) (2024) përmban pesë objektiva strategjike: përputhjen e legjislacionit me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare; adoptimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse të bazuar në rrezik; forcimin e kapaciteteve institucionale; reduktimin e posedimit dhe përdorimit të paligjshëm përmes rritjes së ndërgjegjësimit dhe bashkëpunimit me shoqërinë civile; si dhe shkatërrimin sistematik të tepricave për të parandaluar përhapjen e tyre.[86] Megjithëse strategjia nuk i referohet drejtpërdrejt Agjendës GPS, ajo promovon pjesëmarrjen më të madhe të grave dhe të rinjve në përpjekjet për kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta; synon përmirësimin e reagimit institucional ndaj përdorimit të paautorizuar të armëve në rastet e dhunës në familje; dhe rritjen e ndërgjegjësimit përmes takimeve me OShC(G)-të.[87] Megjithëse afati për këto takime ishte viti 2024, Ministria e Punëve të Brendshme duket se nuk ka kontaktuar OShCG-të e ndryshme* për të marrë pjesë. RrGK nuk u kontaktua as gjatë hartimit të Strategjisë së mëparshme për kontrollin e AVL (2017–2021), edhe pse strategjia parashihte bashkëpunim të qartë me RrGK në fushatat e rritjes së ndërgjegjësimit.[88]

4.3.5. Dokumentet e anëtarësimit të Kosovës në BE

Në vitin 2015, Kosova nënshkroi Marrëveshjen për Stabilizim-Asociim (MSA) me Bashkimin Evropian.[89] MSA-ja thekson se dialogu politik midis Kosovës dhe BE-së duhet të zhvillohet duke rritur konvergjencën me masat e politikës së përbashkët për punë të jashtme dhe siguri të BE-së, promovuar bashkëpunim rajonal efektiv, gjithëpërfshirës dhe përfaqësues, zhvilluar marrëdhënie të fqinjësisë së mirë në Ballkanin Perëndimor dhe avancuar procesin e normalizimit të marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë. Megjithatë, MSA-ja nuk është në përputhje me RKSKB 1325, pasi nuk përmend nevojën për përfaqësimin e grave në proceset e paqes dhe dialogun politik.

Kosova është zotuar për të zbatuar reforma drejt anëtarësimit në BE në përputhje me MSA-në. Programi kombëtar për integrim evropian (PKIE) përfshin aspektin gjinor, duke përfshirë masa për përmirësimin e të drejtave të grave në qasjen në drejtësi dhe të drejtat themelore, veçanërisht në adresimin e dhunës me bazë gjinore.[90] Megjithatë, Kapitulli 31 mbi Politikën për punë të jashtme, siguri dhe mbrojtje nuk përmend gratë në lidhje me masat e sigurisë dhe dialogun politik. As *Agjenda e Reformave të Kosovës* nuk përfshin ndonjë masë specifike për gratë që lidhen me paqen dhe sigurinë.[91]

---

[84] Po aty., f. 7.
[85] Po aty., f. 15.
[86] Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, Strategjia dhe Plani i Veprimit Kombëtar për Kontrollin e Armëve të Vogla, Armëve të Lehta dhe Eksplozivëve 2024–2028, 2024.
[87] Po aty. Qëllimi specifik 2.7, 2.8, dhe 4.3, përkatësisht.
[88] Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, Strategjia dhe Plani i Veprimit Kombëtar për Kontrollin e Armëve të Vogla, Armëve të Lehta dhe Eksplozivëve 2017 – 2021, 2016.
[89] Këshilli i Bashkimit Evropian, Stabilisation and Association Agreement between the European Union and the European Atomic Energy Community, of the one part, and Kosovo*, of the other part [Marrëveshja për Stabilizim dhe Asocim midis Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, nga njëra anë, dhe Kosovës, nga ana tjetër], Bruksel, 2015.
[90] Qeveria e Republikës së Kosovës, ZKM, Programi Kombëtar për Integrime Evropiane 2024–2028, 2024.
[91] Qeveria e Kosovës, Mekanizmi për Reformë dhe Zhvillim për Ballkanin Perëndimor: Agjenda e Reformave e Kosovës, 2024.

4.3.6. Strategjia për drejtësi tranzicionale 2024-2034

Kjo Strategji është zhvilluar duke ndjekur një qasje gjithëpërfshirëse, të fokusuar te viktimat dhe me ndjeshmëri ndaj dinamikës gjinore.[92] Grupi punues i emëruar nga Ministria e Drejtësisë përfshinte përfaqësues nga të gjitha ministritë, Zyra e Kryeministrit (ZKM), viktima të luftës, OShC-të dhe ekspertë të drejtësisë tranzicionale. Vlen të përmendet se ABGj nuk ishte pjesë e këtij grupi. Konsultimet publike gjatë viteve 2022-2023 përfshinë 30 takime me 465 pjesëmarrës nga grupet e viktimave, institucionet përkatëse dhe akterë të tjerë të interesuar nga të gjitha etnitë,[93] ku gjysma e tyre ishin gra.[94] Pjesëmarrësit u pyetën për njohuritë e tyre mbi proceset e drejtësisë tranzicionale, por vetëm disa kishin njohuri.[95] OShC-të kontribuan me fonde për të siguruar një proces "të gjerë dhe gjithëpërfshirës". OShCG-të u konsultuan kryesisht në nivel qendror. OShCG-të nga komunat e tjera nuk morën pjesë për shkak të mungesës së ftesave ose fondeve për të udhëtuar në Prishtinë.[96] Të gjithë pjesëmarrësit mund të jepnin komente përmes platformës online të konsultimit publik. OShC-të dhe zyrtarët e përshkruan procesin si gjithëpërfshirës, "të qëndrueshëm" dhe me një qasje të përqendruar tek viktimat.[97] Ministria e Drejtësisë theksoi se kjo është një nga strategjitë e para të drejtësisë tranzicionale në rajon.[98]

Strategjia përputhet me Kushtetutën dhe standardet ndërkombëtare, përfshirë kornizat e OKB-së dhe BE-së, duke mbështetur barazinë, mosdiskriminimin dhe parimin e "mos bëj dëm". Synimet përfshijnë "adresimin e krimeve të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut, të drejtës ndërkombëtare humanitare dhe krimeve të tjera sipas të drejtës ndërkombëtare, për periudhën 1989-2000".[99] Objektivi specifik 5 synon të sigurojë drejtësi tranzicionale të ndjeshme nga aspekti gjinor dhe të trajtojë dhunën dhe diskriminimin me bazë gjinore. Masat e parashikuara përfshijnë sigurimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave në përballjen me të kaluarën, informimin e tyre rreth drejtësisë tranzicionale, krijimin e hapësirave të sigurta për të ndarë përvojat e konfliktit, parandalimin dhe reagimin ndaj dhunës që rrjedh nga trauma e luftës, ofrimin e trajnimeve të specializuara për hetimin e dhunës seksuale gjatë luftës, promovimin e pjesëmarrjes së grave në proceset e drejtësisë tranzicionale dhe forcimin e Komisionit për të Mbijetuarit e Dhunës Seksuale, si dhe masa të tjera për të mbështetur të mbijetuarit. Megjithatë, asnjë masë nuk kërkon në mënyrë të qartë rritjen e angazhimit të grave në dialogun Beograd-Prishtinë.

Megjithatë, OShC-të që morën pjesë në proces e përshkruan dokumentin fillestar si të kënaqshëm, por u zhgënjyen nga versioni i miratuar nga Qeveria e Kosovës.[100] Dy elementë nuk ishin në përputhje me praktikat e drejtësisë tranzicionale. Së pari, Strategjia mbulon periudhën nga viti 1989 deri në vitin 2000, ndërkohë që afati fillestar ishte nga viti 1989 deri në pavarësinë e Kosovës në vitin 2008, duke përfshirë ndryshimet kryesore politike, sipas praktikave ndërkombëtare të drejtësisë tranzicionale. Së dyti, dokumenti përfundimtar është i shkruar në një gjuhë "monoetnike", duke përjashtuar përvojat e pakicave etnike gjatë luftës, siç vuri në dukje një përfaqësues i OShC-ve.

Strategjia parashikon krijimin e një Komisioni Presidencial për ballafaqim me të kaluarën, me qëllim që të sigurojë "trajtim të drejtë dhe të barabartë për të gjitha palët e prekura nga lufta". Ky komision duhet të analizojë ngjarjet dhe të përfshijë të gjitha palët e prekura në dokumentimin e përvojave të tyre.[101] Komisioni, i njohur si Komisioni për të Vërtetën ose Komisioni Presidencial për Drejtësi Tranzicionale, synon të adresojë trashëgiminë e së kaluarës dhe të ndihmojë në paqe dhe pajtim. Pritet që ky proces të konkretizohet gjatë mandatit të Presidentes Vjosa Osmani, i cili përfundon në mars të

---

[92] Qeveria e Republikës së Kosovës, ZKM, Strategjia për Drejtësinë Tranzicionale 2024-2034, 2024.
[93] Po aty., f. 8. Në total u mbajtën 22 takime me 334 pjesëmarrës shqiptarë dhe 8 me 131 pjesëmarrës minoritarë (të dhëna të ofruara nga Ministria e Drejtësisë, 2025).
[94] Po aty., f. 14. Nuk është e qartë sa gra dhe burra u konsultuan sipas përkatësisë etnike.
[95] Korrespondenca e RrGK-së me Ministrinë e Drejtësisë, 2025.
[96] Intervistat dhe grupet e fokusit nga RrGk-ja me gra të ndryshme nga OShCG-të nga Gjakova dhe Prizreni, 2025.
[97] RrGK, intervistë me Ministrinë e Drejtësisë, Departamenti për Drejtësinë Tranzicionale dhe OShC-të, 2025.
[98] Po aty.
[99] Qeveria e Republikës së Kosovës, ZKM, Strategjia për Drejtësinë Tranzicionale 2024-2034, 2024, f. 5.
[100] Intervista të RrGK-së me përfaqësues të OShC-së, prill 2025.
[101] Qeveria e Republikës së Kosovës, ZKM, Strategjia për Drejtësinë Tranzicionale 2024-2034, 2024, f. 28.

vitit 2026.[102] Ekspertët e drejtësisë tranzicionale kanë rekomanduar që komisioni të jetë një organ i pavarur, për të ruajtur legjitimitetin tek pakicat etnike, veçanërisht serbët e Kosovës, dhe të ndjekë qasjen nga baza, duke përfshirë aktivisht komunitetet dhe pjesëmarrësit në vendimmarrje (*ang.: bottom-up approach*).[103].

Kjo nuk është iniciativa e parë presidenciale për një komision të së vërtetës; ish-Presidenti Thaçi kishte inicuar krijimin e një Komisioni Presidencial të së Vërtetës dhe Pajtimit në vitin 2018.[104] Kjo çoi në miratimin e një akti normativ në vitin 2020, i cili përcaktoi mandatin dhe përgjegjësitë e Komisionit.[105] Megjithatë, procesi u ndërpre pas dorëheqjes së Thaçit.[106] Disa praktika të mira nga ky proces u përfshinë më vonë në Strategjinë e Drejtësisë Tranzicionale të miratuar rishtazi.[107] Akti e parashikonte Komisionin si një institucion të pavarur me subjektivitet ligjor, të përbërë nga nëntë komisionerë dhe me përbërje "shumëetnike dhe gjinore" që pasqyronte diversitetin e Kosovës. Përfaqësimi gjinor parashikonte që 30% e anëtarëve të ishin të "gjinisë së kundërt", një dispozitë që nuk përputhet me Ligjin për Zgjedhjet dhe që supozon se burrat janë gjinia dominuese. Që nga pezullimi i aktit normativ, ka nisur një iniciativë e re për krijimin e Komisionit Presidencial në përputhje me Strategjinë për Drejtësinë Tranzicionale. Progresi në krijimin e Komisionit dhe në zbatimin e objektivave të tjerë të Strategjisë mbetet i paqartë, pasi nuk është publikuar asnjë raport monitorimi. Departamenti për Drejtësinë Tranzicionale në Ministrinë e Drejtësisë është përgjegjës për koordinimin e zbatimit që nga viti 2020. Edhe pse janë planifikuar takime me shoqërinë civile, ato kanë qenë të parregullta.[108].

4.3.7. Strategjia e Sigurisë së Kosovës 2022-2027

Kjo strategji (2022) planifikon investime në burime njerëzore, financiare dhe infrastrukturore për sistemet e paralajmërimit të hershëm, me qëllim parandalimin dhe menaxhimin e krizave në sektorët e shëndetësisë, energjisë dhe mjedisit.[109] Nuk është e qartë nëse procesi i hartimit përfshiu konsultime të mjaftueshme publike, duke përfshirë ABGj-në, zyrtarët e barazisë gjinore (ZBGj) dhe OShCG-të. Strategjia nuk i referohet sigurisë që merr parasysh çështjet gjinore dhe nuke ka të integruar perspektivën gjinore. Koncepti i saj i sigurisë kombëtare nuk merr parasysh se si gratë dhe burrat e etnive të ndryshme mund të perceptojnë sigurinë në mënyra të ndryshme dhe mund të kenë nevoja të veçanta për sigurinë njerëzore, përfshirë kërcënimet që lidhen me transformimin digjital. Strategjia do të kishte mundur të fokusohej më shumë tek siguria njerëzore: teksa siguria kombëtare përqendrohet kryesisht tek mbrojtja e shtetit dhe kufijve, siguria njerëzore fokusohet tek kërcënimet individuale dhe jo-ushtarake, siç janë siguria sociale, ekonomike dhe mjedisore.[110].

Strategjia përcakton se Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës ka përgjegjësinë të hartojë një raport vjetor mbi zbatimin e saj, duke u bazuar në një "matricë të detajuar" për monitorim.[111] Megjithatë, RrGK nuk ka gjetur ende ndonjë plan veprimi të publikuar. Si pasojë, ndjeshmëria gjinore e rezultateve, treguesve, vlerave bazë, objektivave dhe buxhetit nuk mund të vlerësohet.

4.4. Përfundimi

- Rezolutat e njëpasnjëshme të OKB-së theksojnë rëndësinë e angazhimit të grave në proceset e paqes, përfshirjes së perspektivës gjinore në ndërtimin e paqes dhe adresimit të dhunës seksuale në konflikt, duke marrë parasysh nevojat e të mbijetuarve dhe duke siguruar mekanizma efektivë të

[102] Serbeze Haxhiaj, "Skepticizmi mbështjell nismën e ripërtërirë për të vërtetën dhe pajtimin", BIRN, 2024.
[103] Gezim Visoka cited in Serbeze Haxhiaj, "Skepticizmi mbështjell nismën e ripërtërirë për të vërtetën dhe pajtimin", BIRN, 2024.
[104] Serbeze Haxhiaj, "Skepticizmi mbështjell nismën e ripërtërirë për të vërtetën dhe pajtimin", BIRN, 2024.
[105] Presidenti i Republikës së Kosovës, Projekt Akti Normativ Nr. Xx/2020 për themelimin e Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin, 2020.
[106] Serbeze Haxhiaj, "*A ka të ardhme Komisioni i së Vërtetës dhe Pajtimit në Kosovë?*", BIRN, 2022.
[107] Intervistë e RrGK-së me zyrtarë të Ministrisë së Drejtësisë, 2025.
[108] Po aty.
[109] Republika e Kosovës, Qeveria, ZKM, Strategjia e Sigurisë së Kosovës 2022-2027, 2022.
[110] S. N. MacFarlane dhe Y. F. Khong, *Human security and the UN: a critical history* [Siguria njerëzore dhe OKB-ja: një histori kritike], Indiana University Press: 2006, f. 12.
[111] Qeveria e Republikës së Kosovës, ZKM, Strategjia e Sigurisë së Kosovës 2022-2027, 2022, f. 22.

llogaridhënies. BE-ja inkurajon përputhshmërinë me këto objektiva. Kosova ka shprehur angazhimin e saj ndaj rezolutave të OKB-së dhe proceseve të integrimit në BE, duke përfshirë edhe ndaj OZHQ-ve, por progresi i prekshëm mbetet i pamjaftueshëm. Kushtetuta garanton barazinë gjinore dhe të drejtat e njeriut, por mungojnë dispozitat për GPS.

- Ligji për Statusin dhe të Drejtat e Viktimave të Luftës përfshin dispozita për të mbijetuarit e dhunës seksuale, por afati pesëvjeçar për aplikime dhe kufizimi i fushëveprimit, i cili përjashton viktimat pas vitit 1999 mbeten të diskutueshëm dhe kërkojnë ndryshime.
- Ligji për Forcën e Sigurisë së Kosovës duhet të garantojë pjesëmarrje të barabartë të grave dhe konsultime me OShC(G)-të në zhvillimin e strategjive të sigurisë kombëtare, sipas LBGJ-së.
- Ligjet zgjedhore nuk përputhen me synimet e LBGj-së dhe Agjendës së GPS-së për të rritur pjesëmarrjen e grave.
- Pas Planit të Veprimit të Kosovës për RKSKB 1325 2013-2015, nuk u hartua asnjë plan zëvendësues. PKBGj 2020-2024 përmendte vetëm GPS dhe kishte zbatim të kufizuar. Në vitin 2025, Kosova nuk kishte asnjë PKV.
- Strategjia e Sundimit të Ligjit përmend barazinë gjinore, por nuk përfshin objektiva specifike për rritjen e pjesëmarrjes së grave në sektorët gjyqësorë dhe të zbatimit të ligjit.
- Dokumentet që lidhen me anëtarësimin në BE, si MSA dhe PKIE, nuk adresojnë mjaftueshëm rolet e grave në proceset e paqes dhe dialogun politik.
- Strategjia për Drejtësinë Tranzicionale përfshin drejtësinë tranzicionale të ndjeshme nga aspekti gjinor, por fokusohet më shumë tek rritja e ndërgjegjësimit sesa tek sfidat strukturore që pengojnë pjesëmarrjen e grave. Strategjia nuk adreson mjaftueshëm prioritetet e pakicave etnike. Gjithashtu, kanë munguar mekanizmat adekuat për buxhetimin dhe monitorimin, përfshirë objektiva të qarta dhe të matshme.

5. Analiza e situatës

Ky seksion ofron një analizë të shkurtër gjinore të situatës së përgjithshme në Kosovë, në kontekstin e paqes dhe sigurisë, duke shqyrtuar pjesëmarrjen e grave në arsim, ekonomi, media, politikë dhe vendimmarrje. Në të shqyrtohen edhe rolet gjinore dhe sfidat me të cilat përballen personat LGTBQI+. Një analizë e tillë gjinore është e rëndësishme për një qasje gjithëpërfshirëse ndaj sigurisë. Kjo analizë i përgjigjet nën-pyetjes së hulumtimit: në çfarë mase gratë e ndryshme* kanë fuqi politike, ekonomike dhe/ose ligjore për të kontribuar në avancimin e paqes?

5.1. Arsimi dhe siguria

Në përgjithësi, vajzat dhe djemtë ndjekin arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm në nivele të ngjashme, megjithëse djemtë tejkalojnë pak vajzat në numër (Tabela 1).[112] Në nivelet e arsimit të lartë, më shumë gra janë të regjistruara në programet e baçellor-it, master-it dhe doktoraturës sesa burrat. Më shumë se 95% e studentëve në arsimin parauniversitar janë shqiptarë[113], përqindje më e lartë se 91%, që është vlerësimi i pjesës së tyre në popullsi.[114] Nuk ka të dhëna zyrtare të ndara sipas etnisë dhe gjinisë, por studimet tregojnë se vajzat rome, ashkali dhe egjiptiane përballen me pengesa shtesë në qasjen në arsim.

Tabela 1. Vajzat dhe djemtë që ndjekin arsimin parauniversitar

Niveli i arsimit	Nxënësit	Djemtë	Vajzat
Parashkollor	5,420	52%	48%
Parafillor	18,946	51%	49%
Fillor dhe i ulët i mesëm	212,967	51%	49%
I mesëm i lartë	63,029	50.5%	49.5%

[112] Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), Statistikat 2022/2023, 2023.
[113] Po aty.
[114] Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK), Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, 2024.

Shkollat e Kosovës ofrojnë mësim në dy gjuhë zyrtare: shqipe dhe serbe. Arsimi parauniversitar ndjek Kornizën Kurrikulare të Kosovës (2016), e zhvilluar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). Shkollat mund të ofrojnë arsim në gjuhën serbe duke përdorur kurrikula të miratuara nga Serbia, në varësi të aprovimit nga MASHT. Në komunitetet serbe, shkollat zakonisht përdorin gjuhën serbe.[115] Serbia kontrollon arsimin në gjuhën serbe në Kosovë përmes një sistemi paralel të drejtuar nga Ministria e Arsimit, duke operuar në gjashtë qarqe pa koordinim me institucionet e Kosovës.[116] Ky segregimi i studentëve të grupeve të ndryshme etnike dhe programet e ndryshme mësimore që u mësohen mund të pengojnë ndërveprimet dhe, rrjedhimisht, potencialin për ndërtimin e paqes.

Qasja e kufizuar në arsim mund të ndikojë negativisht në mundësitë e grave dhe burrave të ndryshëm* për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes. Hulumtimet tregojnë se papunësia e të rinjve dhe dhuna politike janë të ndërlidhura ngushtë, veçanërisht tek burrat; të rinjtë e papunë me arsim të lartë kanë më shumë për të humbur nëse përfshihen në konflikt, ndaj janë më pak të prirur për të vepruar dhunshëm. Të rinjtë me arsim të ulët kanë më pak për të humbur, dhe për pasojë janë më të predispozuar ndaj dhunës.[117] Papunësia dhe pabarazitë e kombinuara me nivele të ulëta arsimore mund të rrisin dhunën politike, ndërsa arsimimi i më i lartë tek burrat lidhet me uljen e dhunës politike. Sipas një sondazhi të opinionit publik të vitit 2024, burrat e të gjitha etnive në Kosovë, përveç turqve dhe egjiptianëve, kanë më shumë gjasa sesa gratë të marrin pjesë në protesta për shkak të situatës politike, duke i bërë ata më të prirur për t'u përfshirë në aktivitete që mund të shndërrohen në dhunë.[118] Veçanërisht, burrat në moshën 35–44 vjeç janë më të prirur të raportojnë gatishmërinë për t'u bashkuar protestave të tilla (45%), të ndjekur nga ata në moshën 25–34 vjeç (41%) dhe burrat nën 24 vjeç (37%).

5.2. Punësimi dhe siguria

Në vitin 2023, burrat kishin një shkallë punësimi dukshëm më të lartë (53%) sesa gratë (20%).[119] Tek gratë e moshës 15-24 vjeç, shkalla e punësimit ishte 12%, ndërsa tek burrat e kësaj moshe arrinte 25%. Arsimi i lartë ishte i ndërlidhur me punësimin, me 76% të burrave me arsim të lartë dhe 60% të grave me arsim të lartë të punësuar.[120] "Gratë kishin më shumë gjasa të punonin si punëtore familjare të papaguara në sektorin e shërbimeve dhe shitjes (38% krahasuar me 26% të burrave).[121] Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) nuk publikon të dhëna të Anketës së Forcës Punëtore të ndara sipas gjinisë, etnisë apo vendndodhjes gjeografike. Hulumtimet e tjera tregojnë se pakicat etnike kanë më shumë gjasa të punojnë në ekonomi joformale, veçanërisht serbët e Kosovës.[122] Punësimi joformal, veçanërisht në komunat veriore, kontribuon në cenueshmëri, duke kufizuar qasjen në të drejta si pensionet.[123] Kalimi nga ekonomia joformale në atë formale është thelbësor për paqen dhe kohezionin social.[124] Punësimi mund t'u ofrojë grave burime dhe autonomi, duke mundësuar vendimmarrje më të pavarur dhe angazhim më të madh politik. Megjithatë, përgjegjësitë e pabarabarta për kujdesin dhe shkalla e kufizuar e punësimit, të përkeqësuara nga pengesat ligjore lidhur me punësimin, pronësinë e pasurisë dhe qasjen në

[115] Sabiha Shala, et al., "The non-majority communities' rights in Kosovo: implementation of the right to employment and education" [Të drejtat e komuniteteve jo-shumicë në Kosovë: zbatimi i së drejtës për punësim dhe arsim], *Journal of Liberty and International Affairs*, 9(2), 531-549, 2020, f. 535.
[116] ECMI, "Education in Serbian Language in Kosovo"[Arsimi në gjuhën serbe në Kosovë], 2018.
[117] Therese F. Azeng dhe Thierry U. Yogo, "Youth Unemployment, Education and Political Instability: Evidence from Selected Developing Countries 1991-2009" [Papunesia e të rinjve, arsimi dhe paqëndrueshmëria politike: Të dhëna nga disa vende në zhvillim], 2015, f. 4, 13.
[118] Bazuar në të dhënat e papërpunuara të ndara nga UNDP nga UNDP/USAID, "Public Pulse Brief XXVI", 2024.
[119] ASK, Anketa e Fuqisë Punëtore 2023, 2024, f. 16.
[120] Po aty., f. 17.
[121] Po aty., f. 19.
[122] RrGK, "Nën hije: Analiza gjinore e punës joformale në Kosovë", 2024, f. 15.
[123] Po aty., f. 105.
[124] Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP), "Ekonomia joformale", paragrafi 3.

kredi[125], mund të pengojnë aftësinë e grave për t'u angazhuar në proceset e ndërtimit të paqes.[126] Disa pjesëmarrës vunë re se edhe kur mbështeten iniciativat ekonomike të grave, normat e rrënjosura shoqërore, si koncepti i burrit si kryefamiljar, mund të kufizojnë ndikimin e tyre. Një pjesëmarrëse ndau shembullin e një biznesi të regjistruar zyrtarisht në emër të gruas, por që në praktikë kontrollohej nga burri i saj, duke theksuar nevojën për monitorim të kujdesshëm të iniciativave që synojnë mbështetjen e grave, për të siguruar që fondet të arrijnë objektivat e tyre.

5.3. Pjesëmarrja e grave në vendimmarrjen për sigurinë

Pjesëmarrja e grave është një komponent kyç i Agjendës së GPS-së. Ky seksion shqyrton angazhimin e grave të ndryshme* në vendimmarrje në familje, komunitet, politikë dhe dialogun Beograd-Prishtinë, duke marrë parasysh ndryshimet në pjesëmarrje bazuar në moshë, etni, vendndodhje gjeografike dhe aftësi të kufizuara. Në këtë seksion gjithashtu shqyrtohen çështjet që ndikojnë në pjesëmarrjen e grave.

Pavarësisht zotimit nga LBGj për një përfaqësim t (50%) ë grave dhe burrave,[127]gratë mbeten të nën-përfaqësuara, veçanërisht në rolet vendimmarrëse. Kuotat në ligjet zgjedhore, të cilat kërkojnë të paktën 30% pjesëmarrje të secilës gjini, kanë ndihmuar në rritjen e pjesëmarrjes së grave në nivel komunal dhe kombëtar, por ato nuk sigurojnë përfaqësim të barabartë. Nga 37 gra deputete në vitin 2007, numri u rrit në 44 në vitin 2021. Edhe pse 26 hynë në kuvend për shkak të kuotës në vitin 2007, vetëm nëntë u zgjodhën në vitin 2021, duke sugjeruar se kuota ka kontribuar në zgjedhjen e disa grave, por jo në përfaqësimin e barabartë.

Gjatë mandatit 2021-2025, i cili përfundoi në shkurt 2025, dy nga tre zëvendëskryeministrat ishin gra, përfshirë një boshnjake të Kosovës. Gratë drejtuan pesë nga 15 ministri, duke rritur përfaqësimin nga 19% në 33%.[128] Përfaqësimi i grave në vendimmarrje në të gjithë Qeverinë e Kosovës ndryshonte, por në përgjithësi gratë ishin ende të nën-përfaqësuara, përfshirë edhe në misionet diplomatike, ku ato mbanin 21-25% nga 45-52 pozita.[129] Gratë kanë munguar kryesisht në dialogun Beograd-Prishtinë, veçanërisht në pozita vendimmarrëse.[130] Si rezultat, nevojat e grave të ndryshme* nuk janë adresuar në mënyrë kuptimplote në dialog. Mungesa e një procesi të qartë ka dëmtuar aftësinë e të gjithëve, si grave ashtu edhe burrave, për t'u angazhuar plotësisht.[131] Dështimi për të trajtuar shqetësimet e qytetarëve përmes Dialogut rrezikon mundësinë e rikthimit të konflikteve.

Në zgjedhjet komunale të vitit 2021, vetëm dy gra (të dyja serbe) u zgjodhën në mesin e 38 kryetarëve të komunave (5%).[132] Megjithatë, gratë kanë mbajtur vazhdimisht rreth një të tretën e vendeve në asambletë komunale, kryesisht për shkak të kuotave gjinore. Në vitin 2021, 36% e 1,002 kandidatëve zgjedhorë ishin gra.[133] Brenda drejtorive komunale, gratë mbanin 24% të pozitave zyrtare në 30 komuna.[134] Një grua ashkalike, një egjiptiane dhe një grua me aftësi të kufizuara u zgjodhën në kuvendet komunale, duke shënuar një rritje modeste në përfaqësimin e tyre. Megjithatë, aktivistët e OSHCG-ve nga grupet etnike dhe ato me aftësi të kufizuara shprehën shqetësime se gratë në politikë nuk mbronin domosdoshmërisht interest dhe të drejtat e grave apo barazinë gjinore.[135] Serbët e Kosovës përballen me sfida më të mëdha sa i përket pjesëmarrjes, pasi Lista Serbe (LS), e cila dikur ishte pjesë e

[125] UN Women, "Profili gjinor i Kosovës", 2024.
[126] Katharine M Christopherson Puh, et al., "Tackling Legal Impediments to Women's Economic Empowerment"[Përballja me pengesat ligjore për fuqizimin ekonomik të grave], IMF Working Papers, 2022, paragrafi 15.
[127] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore, neni 6.
[128] UN Women, "Profili gjinor i Kosovës", 2024, f. 61-62.
[129] Po aty., f. 70.
[130] Po aty., f. 73.
[131] Intervistë e RrGK-së.
[132] UN Women, "Profili gjinor i Kosovës", 2024, f. 61-62.
[133] Llogaritje e RrGK-së e nxjerrë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, "rezultatet e kandidatëve të përzgjedhur sipas subjekteve", 2021.
[134] UN Women, " Profili gjinor i Kosovës", 2024, f. 63.
[135] Grupet e fokusit dhe intervistat e RrGK-së 2025.

koalicioneve qeverisëse dhe shprehte prioritetet e komunitetit serb, është izoluar politikisht që nga zgjedhjet e vitit 2025. Disa e lidhin këtë me sulmin në Banjska,[136] në vitin 2024, për të cilin ish-nënkryetari i SL, Millan Radoiçiq, mori përgjegjësinë. Kjo situatë, së bashku me tërheqjen e serbëve nga institucionet e Kosovës, ka kontribuar në nën-përfaqësimin e interesave të komunitetit serb, përfshirë ato të grave.[137]

Një shqetësim i përsëritur mes pjesëmarrësve ishte se partitë politike, kryesisht të udhëhequra nga burra, vazhdojnë të ushtrojnë kontroll mbi deputetët dhe mbi çështjet që ngrihen, prioritizohen dhe adresohen.[138] Një pjesëmarrës tha: "Partitë politike, përfshirë ato që përfaqësojnë komunitetet rome, ashkali dhe egjiptiane, shpesh dështojnë të prioritizojnë në mënyrë të duhur nevojat e grave rome, ashkali dhe egjiptiane. Çështjet e tyre anashkalohen në agjendat më të gjera politike." Një pjesëmarrës tjetër shtoi: "Udhëheqësit burra i konsiderojnë gratë vetëm si një numër për të përmbushur kuotën, duke mos lënë hapësirë për përfaqësimin e tyre real në vendimmarrje Një temë e përbashkët midis grave serbe të Kosovës ishte se kapaciteti i kufizuar i zyrtarëve shqiptarë dhe serbë të Kosovës i lë ato të paafta për të përmbushur nevojat e ndryshme të qytetarëve. Pjesëmarrësit shprehën në mënyrë të përsëritur perceptimin se deputetet gra shpesh nuk arrijnë të avokojnë për nevojat dhe prioritetet e grave.

Për të shërbyer në Qeverinë e Kosovës ose në shërbimin civil, serbët, goranët, romët dhe boshnjakët historikisht janë përballur me pengesa shtesë për shkak të mosnjohjes nga Qeveria e Kosovës të diplomave të shkollave të mesme të mbështetura nga Serbia në Kosovë.[139] Marrëveshja e vitit 2011 midis Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Serbisë për njohjen e kualifikimeve arsimore, e ripërtërirë në vitin 2020.[140] ka ndihmuar, por procesi i shqyrtimit të diplomave mbetet një pengesë për aplikimet për punë qeveritare.[141]

Disa faktorë kontribuojnë në nën-përfaqësimin e grave në vendimmarrje. Pjesëmarrësit theksuan normat shoqërore patriarkale në familje dhe komunitete, të cilat ndikojnë gjithashtu në partitë dhe institucionet kryesisht të dominuara nga burrat. Normat shoqërore ndikojnë te gratë e ndryshme* në mënyra të ndryshme, varësisht nga identiteti gjinor, vendndodhja, etnia, arsimi dhe statusi ekonomik. Për shembull, gratë rome, ashkali dhe egjiptiane përballen me sfida joproporcionale, me një moshë mesatare martesore prej 15-16 vjeç.[142] Qasja e kufizuar në të drejtat dhe shërbimet themelore, si arsimi dhe kujdesi shëndetësor, e kombinuar me normat gjinore të ngulitura, pengon pjesëmarrjen e tyre. Një pjesëmarrës rom vuri në dukje: "Anëtarët burra të familjes kanë tendencë të vendosin për rolet e grave në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptiane." Gratë me aftësi të kufizuara dhe gratë nga vendet rurale përballen me pengesa shtesë, përfshirë mungesën e transportit për të marrë pjesë në takime. Gratë shqiptare që kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës vazhdojnë të përballen me stigmatizim, i cili pengon pjesëmarrjen e barabartë në arsim, punë të paguar dhe, rrjedhimisht, në vendimmarrje. Ndërkohë, disa gra serbe hezitojnë të angazhohen në politikë për shkak të frikës nga kërcënimet.[143] Pjesëmarrësit vlerësuan se pjesëmarrja domethënëse e grave në vendimmarrje, në sektorin e sigurisë dhe në proceset e ndërtimit të paqes, përfshirë dialogun Beograd-Prishtinë, është e kufizuar për shkak të normave patriarkale të ngulitura në komunitete, parti politike dhe institucione publike.

---

[136] Më 24 shtator 2023, një grup serbësh etnikë të armatosur sulmoi një patrullë të Policisë së Kosovës në fshatin Banjskë, duke vrarë një zyrtar dhe plagosur një tjetër. Sulmuesit më pas u barrikaduan brenda një manastiri ortodoks serb. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e cilësoi sulmin si akt terrorist dhe e akuzoi Serbinë për mbështetjen e tij, duke përshkallëzuar më tej tensionet (Fatos Bytyci dhe Daria Sito-sucic, "Serb gunmen battle police in Kosovo monastery siege; four dead" [Persona të armatosur serbë u përleshën me Policinë e Kosovës pranë një manastiri; katër persona humbën jetën], 2023, Reuters).

[137] OraInfo, "Serbian List Out of the Game: How will the interests of Serbs in Kosovo be protected?" [Lista Serbe jashtë loje: Si do të mbrohen interesat e serbëve në Kosovë?], 2025.

[138] Intervistat dhe grupet e fokusit të RrGK-së, 2025.

[139] Valerie Hopkins, "Degrees Collect Dust as Diploma War Persists" [Diplomat mbeten në sirtar, ndërsa vazhdon lufta për njohjen e tyre], Prishtina Insight, 2015.

[140] The Dialogue, "Recognition of Diplomas"[Njohja e Diplomave], 2020.

[141] Intervista të RrGK-së, 2025.

[142] Shih QKSGj dhe RROGRAEK, "Pozita e grave rome, ashkali dhe egjiptiane në Kosovë" , 2018.

[143] Intervista dhe grupe të fokusit të RrGK-së, 2025.

5.4. Pjesëmarrja e grave në sektorin e sigurisë

Në Policinë e Kosovës, gratë vazhdojnë të jenë të nën-përfaqësuara. Në vitin 2024, në mesin e 333 zyrtarëve në veri të Kosovës, shqiptarët përbënin 57%, serbët 20%, boshnjakët 13% dhe të tjerët 10%; gratë përbënin vetëm 13.8%.[144] Gratë serbe hasin në pengesa shtesë për t'iu bashkangjitur Policisë së Kosovës për shkak të orarit jofleksibël të punës, pasigurisë, frikës se komuniteti i tyre mund ta konsiderojë këtë si tradhti, ose kërcënimeve të drejtpërdrejta. [145] Hulumtimet dhe rezolutat e OKB-së tregojnë se rritja e pjesëmarrjes së grave në Policinë e Kosovës mund të ndihmojë në rritjen e besimit në këtë institucion.[146] Në Inspektoratin e Policisë së Kosovës, 72% e stafit janë burra (60). Nga gjithsej 83 punonjës, 94% janë shqiptarë, 4% serbë dhe 2% boshnjakë.[147] Nuk ka të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe etnisë për të gjithë stafin.

Në FSK, gratë mbeten të nën-përfaqësuara, duke përbërë 9% të totalit të trupave.[148] Vetëm 4% e trupave të FSK-së janë nga komunitete jo-shumicë, pavarësisht një kuote përfaqësimi prej 10%. Gratë përfaqësojnë 7% të oficerëve dhe 13% të nënoficerëve dhe ushtarëve.[149] Grada më e lartë që mbajti një grua në FSK është ajo e gjeneral majorit (e dyta më e lartë pas komandantit). Normat shoqërore dhe rolet gjinore vazhdojnë të jenë pengesa kryesore për angazhimin e grave në FSK. Pjesëmarrësit në hulumtim vunë re se presionet shoqërore janë zvogëluar me kalimin e kohës, por përgjegjësitë familjare, si kujdesi për fëmijët, kufizojnë mundësitë për të ndjekur grada më të larta, pasi trajnimi intensiv kërkon të jesh larg shtëpisë për periudha të gjata.[150] Një përfaqësues i Ministrisë së Mbrojtjes shpjegoi: "[N]ëse nuk merr pjesë në këto trajnime, nuk mund të avancohesh. Kjo ka qenë ... një sfidë e konsiderueshme." Gratë që u avancuan shpesh e bënë këtë me mbështetjen e familjeve të tyre, të cilat ndanin përgjegjësitë e kujdesit. Disa gra serbe të Kosovës thanë se paragjykimet nga të tjerët serbë përbënin një sfidë shtesë dhe pengonin pjesëmarrjen e tyre. Një zyrtar vuri në dukje: 'Gratë serbe që shprehin interes për t'iu bashkëngjitur FSK-së mund të përballen me kundërshtime nga komunitetet e tyre, të cilat mund ta shohin angazhimin e tyre si një shkelje të besnikërisë ndaj identitetit të tyre etnik".[151] Zyrtarët theksuan se rritja e numrit të grave në FSK jo vetëm që fuqizon gratë, por forcon gjithashtu ushtrinë. Për këtë arsye, po punohet për rekrutimin e grave dhe komuniteteve pakicë përmes ekipeve mobile, mediave, platformave sociale dhe aktiviteteve në shkolla.[152] Në mars të vitit 2019, Ministria e Mbrojtjes miratoi Politikën për të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë Gjinore, e cila është në përputhje me RKSKB 1325 dhe Strategjinë për integrimin e komuniteteve jo-shumicë (2021-2025). Kjo politikë synon të rrisë përfaqësimin gjinor dhe etnik, të promovojë gratë në role vendimmarrëse dhe të ofrojë trajnime mbi të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore. [153] Parimet kryesore të politikës përfshijnë barazinë gjinore, ndjeshmërinë ndaj nevojave specifike gjinore, diversitetin, respektin, mosdiskriminimin dhe tolerancën zero për dhunën ndaj grave.

5.5. Mediat dhe siguria

Peizazhi mediatik i Kosovës përballet me sfida të vazhdueshme, të cilat kohët e fundit janë përkeqësuar nga një rënie e ndjeshme e lirisë së shtypit.[154] Rregullimi i politizuar, paditë strategjike kundër pjesëmarrjes publike, qasja e kufizuar në informacionin publik dhe kërcënimet ndaj gazetarëve përbëjnë

---

[144] RrGK, kërkesë për të dhëna drejtuar Policisë së Kosovës, 2025.
[145] Intervista të RrGK-së, 2025; Balkan Insight, "Political Tensions Test Unity of Kosovo's Police Force"[Tensionet politike testojnë unitetin e Policisë së Kosovës],, 2025, paragrafi 24.
[146] RrGK, "Një ulëse në tryezë: Kontributi i grave në proceset e ndërtimit të paqes në Kosovë dhe pritjet e tyre nga këto procese", 2021, f. 69.
[147] Të dhëna të marra nga Inspektorati i Policisë së Kosovës përmes një kërkese zyrtare, 2025.
[148] Intervistë e RrGK-së me një përfaqësues të FSK-së, 2025.
[149] Korrespondencë me e-mail e RrGK-së me FSK-në, 2025.
[150] Intervistë e RrGK-së me një zyrtar nga Ministria e Mbrojtjes, 2025.
[151] Po aty.
[152] Korrespondencë me e-mail me RrGK-në, 2025.
[153] Po aty.
[154] Kosova shënoi rënien më të madhe në Ballkan, duke zbritur nga vendi i 75-të në të 99-tin, (Reporterët pa kufij, "2025 World Press Freedom Index" [Indeksi Botëror i Lirisë së Shtypit], 2025).

shqetësime kryesore.[155] Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM) është kritikuar për rritjen e kontrollit të autoriteteve mbi median, duke vazhduar mandatet e anëtarëve të bordit të KPM-së, duke lejuar Kuvendin të shkarkojë bordin dhe duke hequr klauzolën e barazisë gjinore që kërkonte të paktën dy gra në bord.[156] Kjo përbën shkelje të LBGj-së dhe thellon shqetësimet për përfaqësimin e grave dhe grupeve të margjinalizuara. Mediat nuk arrijnë të përfaqësojnë në mënyrë adekuate gratë, fëmijët, pakicat dhe grupet e margjinalizuara, shpesh duke u fokusuar vetëm në tema të kufizuara si dhuna në familje dhe duke trajtuar çështjet LGBTQI+ në mënyrë joprofesionale.[157] Një sondazh i opinionit publik i vitit 2024 tregoi se 85% e të anketuarve besonin se politikanët kanë ndikim mbi mediat.[158] Mediat e pavarura në gjuhën serbe janë në një pozicion veçanërisht të vështirë, ku mbështetja e projekt-programeve të financuara nga donatorët dëmton stabilitetin afatgjatë dhe i detyron të përshtatin përmbajtjen sipas prioriteteve të donatorëve.[159] Mediat private varen kryesisht nga sponsorët dhe reklamat, duke i lënë mediat e komuniteteve jo-shumicë në një pozicion të cenueshëm.[160]

Edhe pse ekipet redaktuese shpesh kanë një përbërje më të balancuar gjinore, pronarët e mediave vazhdojnë të jenë kryesisht burra. [161] Platformat mediatike si QIKA, Grazeta dhe Dylberizmi ofrojnë mbulim mbi të drejtat e grave, çështjet LGBTQI+, dhunën me bazë gjinore dhe femicidin, të cilat shpesh anashkalohen nga mediat kryesore.[162] Edhe pse gazetaret gra përqendrohen te temat e argëtimit, stilit të jetesës, edukimit dhe historive me interes njerëzor, shpesh detyrohen të raportojnë nga zona konflikti dhe me rrezik të lartë.[163] Ndërkohë kolegët burra shpesh drejtojnë emisione televizive live, nga rehatia e studios, gjë që u siguron dukshmëri dhe prestigj, pa u ekspozuar ndaj rreziqeve në terren.[164] Mizogjinia mbetet një problem i dukshëm, sidomos për gratë në pozita udhëheqëse, të cilat shpesh përballen me gjuhë të njëanshme ose seksiste që pengon angazhimin e tyre politik.[165] Hulumtimi i opinionit publik i vitit 2021 tregoi se 38% e qytetarëve besonin se dhuna ndaj grave pengon pjesëmarrjen e tyre politike.[166] Ndërkohë, 33% e burrave dhe 42% e grave mendonin se portretizimet mediatike ndikojnë negativisht në suksesin zgjedhor të grave.[167] Përveç kësaj, 25% e serbëve të Kosovës dhe 36% e shqiptarëve të Kosovës besonin se ngacmimi online dekurajon pjesëmarrjen politike të grave. Kandidatet gra shpesh marrin më pak mbështetje sesa kandidatët burra, me transmetuesit kryesorë që u kushtojnë vetëm 10% të mbulimit të fushatave zgjedhore kandidateve gra, duke përkeqësuar kështu pabarazitë gjinore në përfaqësimin politik.[168] Të gjithë këta faktorë mund të pengojnë pjesëmarrjen dhe përfaqësimin politik të grave, veçanërisht të grave nga komunitetet pakicë.

---

[155] Po aty.

[156] Marusic, S., "RSF Report: Media Freedom Tumbling in Most Balkan Countries" [Raporti i RSF: Liria e mediave po përkeqësohet në shumicën e vendeve të Ballkanit], Balkan Insight, 2025; Media Freedom Rapid Response, "Kosovo's media law enables political capture of media regulatory body" [Ligji për mediat në Kosovë mundëson kapjen politike të organit rregullator të mediave], 2025.

[157] Po aty.

[158] UNDP/USAID, "Public Pulse Brief XXVI", 2024.

[159] Human Rights Watch, "A Difficult Profession: Media Freedom Under Attack in the Western Balkans" [Profesion i vështirë: Liria e mediave nën sulm në Ballkanin Perëndimor], 2015, para. 19-27.

[160] Po aty.

[161] Media Freedom Rapid Response, "Kosovo's media law enables political capture of media regulatory body" [Ligji për mediat në Kosovë mundëson kapjen politike të organit rregullator të mediave], 2025, f. 7.

[162] Po aty., f. 13.

[163] Getoarbë Mulliqi dhe Artiola Babuni, "Pozita dhe siguria e grave gazetare në Kosovë", 2025, Rrjeti i Grave Gazetare të Kosovës.

[164] Po aty.

[165] Po aty; Instituti Demokratik Kombëtar (IDK), "Integriteti i informacionit në Kosovë: Vlerësimi i Ekonomisë Politike të Dezinformimit", 2022. Hulumtimi përfshinte tre sondazhe me intervista ballë për ballë me të anketuar mbi 18 vjeç dhe të rinj 16–29 vjeç. Mostra e rastësishme ishte e stratifikuar sipas rajonit, llojit të vendbanimit, gjinisë dhe etnisë. Sondazhi i vitit 2021 përfshiu 1,700 të anketuar, ai i vitit 2022 kishte 1,200, ndërsa sondazhi i të rinjve në vitin 2021 përfshiu 3,100 pjesëmarrës, duke u fokusuar tek minoritetet.

[166] Po aty.

[167] Po aty., f. 28.

[168] Misioni i Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, "Kosovo Legislative Elections Final Report"[Raporti përfundimtar i zgjedhjeve parlamentare në Kosovë], 2017.

5.6. Ndikimet e roleve gjinore në pjesëmarrjen e grave në proceset e paqes

Brenda familjeve, në vitin 2021, 8% e kosovarëve besonin se gratë nuk kanë të drejtë të zgjidhen në pozita të larta vendimmarrëse politike.[169] Më pak gra sesa burra besonin se gratë kanë të drejta të barabarta ligjore në shumicën e fushave, përveç kujdestarisë së fëmijëve dhe qasjes në kredi.[170] Konkretisht, 15% e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve dhe 9% e serbëve të Kosovës mendonin se gratë nuk mund të mbajnë pozita vendimmarrëse.[171] Për më tepër, 8% e kosovarëve besonin se vajzave dhe grave duhet t'u mësohet të jenë "gra të mira dhe të kujdesen për punët shtëpiake"; dhe nëse gratë përqendrohen në karrierën e tyre, kjo mund të ndikojë negativisht në familje.[172] Gratë shpesh punojnë në punë kujdesi të papaguar dhe në sektorin joformal, duke përbërë 65% të personave të angazhuar në punë joformale.[173] Rolet gjinore, përgjegjësitë e kujdesit dhe puna joformale ndikojnë drejtpërdrejt në mundësinë e grave për t'u angazhuar në vendimmarrje, përfshirë edhe në proceset e ndërtimit të paqes, për shkak të kohës së kufizuar dhe presionit shoqëror.

5.7. Personat LGBTQI+ dhe siguria

Individët LGBTQI+ përballen me sfida të konsiderueshme në angazhimin në vendimmarrje. Sa për ilustrim, në vitin 2024, një deputete dhe anëtare e Komisionit për të Drejtat e Njeriut deklaroi se "marrëdhëniet seksuale midis njerëzve të të njëjtit seks shkaktojnë sëmundje serioze", pa u përballur me pasoja për qëndrimet homofobike, pavarësisht reagimeve të OShC-ve.[174] Një rast tjetër përfshinte Një zyrtar i Ministrisë së Drejtësisë ka deklaruar se personave LGBTI duhet t'u hiqen kokat me shpatë, por u mbajt në paraburgim vetëm për 48 orë.[175] Legjislacioni përdor gjuhë që forcon formulimin heteronormativ të gjinisë, i kufizuar në shprehje si "bashkëshort dhe bashkëshorte" ose "burrë dhe grua".[176] Për më tepër, personat LGBTQI+ përballen me rreziqe për sigurinë e tyre fizike. Për shembull, në rastin "EbuUbejdi" të vitit 2023, një person dyshohet se planifikoi një sulm terrorist kundër personave LGBTQI+ në Prishtinë; në vitin 2024, ai u dënua me burg.[177] Partitë politike shpesh refuzojnë të diskutojnë për të drejtat e LGBTQI+ për të shmangur asociimin me to dhe për të fituar vota.[178] Një parti kandidate në Zgjedhjet e Kosovës 2025, "Koalicioni Familjar", e quajti "dashurinë midis personave LGBTI" "turp", "kundër natyrës njerëzore" dhe "jo në interes të përgjithshëm të shoqërisë". Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa i shqiptoi një gjobë prej 5,000 eurosh.[179] Megjithatë, kur zyrtarët publikë dhe politikanët përdorin gjuhë intolerante, kjo mund të inkurajojë të tjerët të veprojnë me urrejtje pa frikë nga pasojat.[180] Përdorimi i individëve LGBTQI+ si objektiv politik ndikon negativisht në jetën dhe mirëqenien e tyre, dobëson kohezionin shoqëror dhe mund të kontribuojë në dhunë.

5.8. Përfundimi

- Gratë përballen me sfida të shumta politike, ekonomike dhe ligjore që kufizojnë angazhimin e tyre në ndërtimin e paqes. Këto përfshijnë ligjet zgjedhore që nuk sigurojnë pjesëmarrje të barabartë në kuvend dhe qeveri në përputhje me LBGj-së dhe ligj të punës që kontribuon në diskriminimin ndaj grave në punësim, mundësi ekonomike të pabarabarta për shkak të nën-përfaqësimit të grave në

[169] QKSGj, "Perceptimet e opinionit publik mbi barazinë gjinore dhe dhunën kundër grave në Kosovë 2021", 2021, f. 17. Mostra përfshiu 978 intervista duke përfshirë edhe përfaqësime shtesë tëtë minoriteteve etnike.
[170] Po aty., f. 18.
[171] Po aty., f. 21.
[172] Po aty., f. 25.
[173] RrGK, "Nën hije: Analiza gjinore e punës joformale në Kosovë", 2024, f. 99.
[174] Nokaj, D., "Komisioni për të drejtat e njeriut s'duhet ta ushqejë homofobinë", Kosovo 2.0., 2024.
[175] KOHA - Kronikë, "Ndalohet për 48 orë zyrtari që kërcënoi komunitetin LGBT", 2019.
[176] Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 2004/32 Ligji i Familjes i Kosovës, 2006, Part II, c. I, Articles 9 and 14.
[177] Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore (CSGD), "Raporti vjetor 2023: Komuniteti LGBTIQ+ dhe të drejtat e tyre në Kosovë", 2024, f. 12.
[178] CSGD, "LGBTI dhe politika - Përmbledhje", 2022, f. 3.
[179] Qendra për Barazi dhe Liri të Komunitetit LGBT në Kosovë (CEL), "PZAP gjobit Koalicionin për Familje me 5000 euro për nxitje të urrejtjes anti-LGBTI+", 2025.
[180] Po aty., f. 5.

fuqinë punëtore, përfshirë pozita vendimmarrëse, dhe lidership politik kryesisht nga burrat që përjashton gratë.

- Rolet gjinore të socializuara kontribuojnë në nën-përfaqësimin e grave në punësim, mbulim mediatik dhe në politikë, duke minuar angazhimin e tyre në vendimmarrje dhe në proceset e ndërtimit të paqes.
- Roli i socializuar gjinor për djemtë e rinj si mbajtës të familjes mund të shtojë tensionin kur burrat nuk gjejnë punë dhe përballen me frustrime.
- Transformimi i roleve gjinore mund të sfidojë pritshmëritë e socializuara mbi rolet e grave dhe burrave, duke rritur angazhimin e grave dhe duke ulur potencialin e burrave për të ushtruar dhunë.

6. Shkaqet dhe pasojat e konfliktit nga perspektiva gjinore

Ky seksion përmbledh fillimisht perceptimet mbi sigurinë. Më pas, në këtë seksion shqyrtohen shkaqet dhe pasojat e konfliktit për individë të ndryshëm*, si dhe diskutohen faktorët që mund të shkaktojnë dhunë dhe shkaqet gjinore të paqëndrueshmërisë. Gjithashtu, analizohet se si marrëdhëniet e pushtetit midis grave dhe burrave të ndryshëm* mund të ndikojnë në konflikt dhe pasojat e tij. Të dhënat mbështeten në literaturën ekzistuese, rezultatet e sondazheve, grupet e fokusit dhe IIK.

6.1. Perceptimet mbi paqen, sigurinë dhe konfliktin

Të dhënat e sondazheve tregojnë një rritje të perceptimeve negative mbi situatën e sigurisë tek serbët e Kosovës,[181] të cilët ndihen më pak të sigurt se shqiptarët e Kosovës. Në vitin 2023, 21% e shqiptarëve të Kosovës përmendën mungesën e pajtimit me Serbinë si kërcënimin kryesor ndaj paqes dhe sigurisë.[182] Ndërkohë, 30% e serbëve të Kosovës vlerësuan papunësinë dhe 19% marrëdhëniet ndër-etnike si shqetësimet kryesore.[183] Në kontrast, vetëm 4% e shqiptarëve i konsideruan marrëdhëniet ndër-etnike një kërcënim serioz.[184] Në vitin 2024, kosovarët në përgjithësi ndiheshin më të sigurt nga krimi dhe dhuna në rrugë, me 83% që raportuan se ndiheshin shumë ose disi të sigurt (nga 80% në vitin 2023).[185] Pak më shumë burra (83.4%) ndiheshin të sigurt krahasuar me gratë (82.9%). Megjithatë, ekzistojnë dallime etnike: një përqindje më e lartë e shqiptarëve të Kosovës (85%) dhe grupeve të tjera etnike (83%) ndiheshin të sigurt krahasuar me serbët e Kosovës (32%). Që nga nëntori i vitit 2023, perceptimi i sigurisë u rrit me 4.5 pikë përqindjeje tek shqiptarët dhe me 3.2 pikë tek personat e grupeve të tjera etnike, ndërsa përqindja e serbëve që ndiheshin të sigurt ra me 5.7 pikë përqindjeje.[186] Në vitin 2024, CSO Aktiv raportoi një rënie të ndjeshme të perceptimit të sigurisë tek serbët e Kosovës, duke arritur nivelin më të ulët në pesë vitet e fundit.[187] Shumica në veri (67%) dhe disa në jug (34%) e Kosovës e vlerësuan situatën e sigurisë si "shumë të keqe", ndërsa më pak se 3% në veri dhe 5% në jug e konsideruan atë "të mirë".[188] Kosova nuk ka të dhëna të ndara sipas gjinisë mbi mënyrën se si gratë dhe burrat perceptojnë sigurinë.

---

[181] NGO Aktiv, "Unmasking Security Challenges Within the Kosovo Serb Community"[Zbërthimi i sfidave të sigurisë brenda komunitetit serb të Kosovës], 2023.

[182] Shpat Balaj dhe Gramos Sejdiu, "What Are the Kosovo Citizens' Perceptions on Inter-Ethnic Relations? Fostering Inter-Ethnic Relations and Reconciliation Survey Results"[Cilat janë perceptimet e qytetarëve të Kosovës mbi marrëdhëniet ndër-etnike? Rezultatet e sondazhit për promovimin e marrëdhënieve ndër-etnike dhe pajtimin], 2022, QKSS.

[183] Metodologjia përfshinte intervista ballë për ballë me 1,226 të anketuar të zgjedhur rastësisht në nëntë komuna multi-etnike në vitin 2022. Mostra u stratifikua për përfaqësim proporcional sipas shqiptarëve të Kosovës (729) dhe serbëve të Kosovës (497), vendbanimit rural-urban (60% rural, 40% urban) dhe gjinisë (51% mashkull, 49% femër)..

[184] Po aty., f. 5.

[185] UNDP/USAID, "Public Pulse Brief XXVI", 2024, f. 10.

[186] Po aty., f. 10.

[187] NGO Aktiv, "Trend Analysis 2024", 2024. Hulumtimi përfshiu sondazhe në terren nga qershori deri në dhjetor 2024, me një mostër prej 503 të anketuarish, prej të cilëve 49% nga veriu dhe 51% nga komunat me shumicë serbe në jug të lumit Ibër. Mostra përfshinte 49% të burrave dhe 51% të grave.

[188] Po aty., f. 18.

Literatura dhe pjesëmarrësit në hulumtim tregojnë se konflikti nuk mund të kuptohet si një ngjarje historike e vetme, por si një përvojë e vazhdueshme e dhunës dhe pasigurisë. Pjesëmarrësit theksojnë se "përfundimi" i luftës ose konfliktit nuk është një moment i qartë dhe i dakorduar. Përkundrazi, konflikti perceptohet gjerësisht si i vazhdueshëm në Kosovë. Për shqiptarët e Kosovës, pasiguria vazhdon për shkak të mungesës së drejtësisë për kryesit e veprave, përfshirë dhunën seksuale, mungesën e një faljeje nga Qeveria e Serbisë dhe mungesën e një zgjidhjeje politike të qëndrueshme për Kosovën si shtet. Për serbët e Kosovës, konflikti vazhdon për shkak të mbylljes së shërbimeve publike dhe frikës nga ngacmimet seksuale dhe dhuna e drejtuar ndaj grave të reja. Të gjitha etnitë janë të shqetësuar për personat e zhdukur dhe incidentet e dhunshme. Perceptimet dhe përvojat e konfliktit ndikojnë në gatishmërinë dhe aftësinë e individëve për të marrë pjesë në proceset e paqes. Prandaj, kjo analizë trajton jo vetëm trashëgiminë e konfliktit të kaluar, por edhe vazhdimësinë e tij. Studiueset feministe kanë argumentuar prej kohësh se përvojat e grave me pasigurinë shpesh vazhdojnë edhe në mungesë të "luftës".[189] Hulumtime të mëparshme në Kosovë mbështesin këtë, duke treguar se perceptimet mbi paqen dhe sigurinë ndryshojnë sipas gjinisë dhe moshës.[190] Për shembull, teksa gratë e moshuara zakonisht e shohin paqen si mungesë të luftës, gratë e reja e lidhin atë më shpesh me nevoja praktike dhe të përditshme, si ndriçimi adekuat në rrugë, siguria nga ngacmimet seksuale, mundësitë për punësim dhe qasja në shërbime shëndetësore.

6.2. Pasojat e konfliktit

Përveç pasojave të përmendura në seksionin Historiku, konflikti ndërpret shërbimet publike dhe infrastrukturën, duke ndikuar në mënyra të ndryshme tek gratë, burrat dhe gjinitë e tjera. Gratë, veçanërisht ato në zonat rurale, përballen me sfida të konsiderueshme për të pasur qasje në shërbime të domosdoshme si shëndetësia dhe transporti. Gratë me aftësi të kufizuara, të cilat tashmë përballen me qëndrime armiqësore dhe përjashtim shoqëror, hasin pengesa për shkak të infrastrukturës dhe ndërtesave të paqashme. Këto kufizime u mohojnë atyre qasjen në arsim, mundësitë për punësim dhe pavarësinë financiare Për shkak të roleve të ndërtuara gjinore, gratë janë më të rrezikuara se burrat ndaj pabarazive në pronësinë e pasurisë, pavarësinë ekonomike, qasjen në transport dhe pjesëmarrjen në vendimmarrje. Rolet gjinore ndikojnë gjithashtu në mënyrën se si gratë, burrat dhe personat jo-binare përjetojnë konfliktin ose dhunën; gratë shpesh janë cak i dhunës seksuale, ndërsa burrat shpesh preken në mënyrë disproporcionale nga veprimet e policisë dhe ushtrisë, duke përbërë shumicën e viktimave. Literatura ekzistuese në rritje tregon se edhe burrat dhe personat me identitete të tjera gjinore mund të përjetojnë dhunë seksuale.[191] Gratë dhe individët LGBTQI+ preken në mënyrë disproporcionale krahasuar me pjesëmarrjen e tyre në konflikt.[192]

Dhuna me bazë gjinore u përmend si një trashëgimi kryesore e pashqyrtuar e luftës, e përkeqësuar nga trauma, stigma dhe neglizhenca institucionale, veçanërisht për të mbijetuarit e dhunës seksuale. Hulumtimet tregojnë se trauma e lidhur me luftën mund të transmetohet ndër breza, ku fëmijët e të mbijetuarve – sidomos ata të prindërve me çrregullim të stresit post-traumatik (PTSD) – janë më të predispozuar për të përjetuar simptoma PTSD edhe pse kanë lindur pas luftës; gjithashtu, ata shpesh

[189] Jacqui True, "Continuums of Violence and Peace: A Feminist Perspective" [Kontinuiteti i dhunës dhe paqes: Një perspektivë feministe], *Ethics & International Affairs*, 2020; Ulrike Krause, "A continuum of violence? Linking sexual and gender-based violence during conflict, flight, and encampment" [Një kontinuum dhune? Lidhja e dhunës seksuale dhe dhunës me bazë gjinore gjatë konflikteve, ikjes dhe kampeve], *Refugee Survey Quarterly,* 34(4), f. 1–19, 2015.

[190] RrGK, "Një ulëse në tryezë: Kontributi i grave në proceset e ndërtimit të paqes në Kosovë dhe pritjet e tyre nga këto procese", 2021, f. 47.

[191] Henri Myrttinen, "Disarming masculinities" [Çarmatimi i maskulinitetit], Disarmament Forum; Women, Men, Peace, and Security, 2006.

[192] Ray Acheson, "Gender-based violence and the arms trade" [Dhuna me bazë gjinore dhe tregtia e armëve], *Global Responsibility to Protect*, 12(2), 139–155, 2020.

raportojnë nivele më të ulëta të mbështetjes shoqërore sesa prindërit e tyre.[193] Trauma e patrajtuar tek burrat është hipotezuar se mund të kontribuojë në dhunën me bazë gjinore ndaj grave në hapësirat private. Stresi post-traumatik tek ish-luftëtarët që kthehen në shtëpi të pafuqishëm dhe të papunë mund të lidhet me dhunë në marrëdhëniet familjare.[194] Megjithatë, hulumtimet nuk kanë arritur të vërtetojnë një lidhje shkakësore të qartë, dhe literatura feministe e atribuon dhunën më shumë normave gjinore dhe marrëdhënieve të pushtetit sesa vetë konfliktit.[195]

Pas luftës, kërcënimet për sigurinë në hapësira publike dhe private mbetën të pranishme, duke ndikuar në mënyra të ndryshme tek gratë dhe burrat. Intervistat tregojnë se kolapsi i shërbimeve publike rriti pasigurinë për personat me aftësi të kufizuara, sidomos për gratë dhe minoritetet etnike si gratë serbe të Kosovës, romet, ashkalitë dhe egjiptianët, të cilat përballen me sfida të shumta dhe të ndërthurura. Mungesa e transportit, kujdesit adekuat shëndetësor, arsimit, mundësive ekonomike dhe mbështetjes për nevojat bazike të personave me aftësi të kufizuara ka bërë që këta individë të përballen me diskriminim të shumëfishtë, segregim dhe neglizhencë.[196] Ndërprerja e përdorimit të dinarit serb dhe mbyllja e institucioneve serbe në Kosovë ka sjellë pasoja për shumicën e serbëve, veçanërisht për të moshuarit dhe gratë, të cilat përballen me vështirësi shtesë për qasje në shërbimet publike për shkak të burimeve të kufizuara financiare dhe mungesës së transportit. Kjo ka ndikuar edhe tek të rinjtë, pasi studentët e Universitetit të Prishtinës në Mitrovicë të Veriut nuk mund të përfitojnë më hua ose bursa studimi.[197] Mbyllja e institucioneve serbe u bë pa konsultime publike të mjaftueshme për përgatitjen e komuniteteve, duke krijuar perceptimin e një "asimilimi të detyruar" në vend të një integrimi gradual, vullnetar dhe të qëndrueshëm. Frika nga konflikti rrit ndjenjat e pasigurisë dhe zvogëlon pjesëmarrjen në jetën publike, veçanërisht tek gratë serbe të Kosovës të shqetësuara për dhunën seksuale dhe burrat që frikësohen nga burgosja ose dhuna e mundshme.

> "[Në veri të Kosovës] mungojnë shërbimet bazë. Për shembull, nuk ka vend ku një grua serbe mund të sjellë në jetë fëmijën e saj. Ato hasin vështirësi në qasjen ndaj shërbimeve Ka raste kur policia atje përgjigjet qëllimisht në telefon në shqip ose ngacmon vajzat. Kjo ndodh edhe këtu (në jug), por atje situata është shumë më shqetësuese."
>
> – OShCG

Situata e polarizuar politike ka ndikuar në bashkëpunimin ndër-etnik. Një grua e re vuri re: "Retorika e njerëzve që më parë ishin pjesë e bashkëpunimit multi-etnik ka ndryshuar, sa i përket mënyrës se si flasin për komunitetin tjetër. Atyre u është shpëlarë truri."[198] Raportohet se disa OShCG në veri kanë ndaluar bashkëpunimin me ato në jug, të nxitura nga frika se një bashkëpunim i tillë mund të rrezikojë sigurinë e tyre ose të familjeve të tyre.[199]

Sipas të dhënave të sondazhit të vitit 2025, 22% e grave aktiviste për paqen në Kosovë raportuan se kanë përjetuar dhunë online ose kërcënime me dhunë për shkak të angazhimit të tyre. Shpalosja e dekadave të punës për avancimin e paqes ka kontribuar në lodhje dhe djegie të aktivisteve, me disa që raportuan lodhje (22%), përkeqësim të shëndetit mendor (17%) dhe trauma sekondare (15%) si pasoja

[193] Zamira Hyseni Duraku, Genta Jahiu dhe Donjeta Geci, "Intergenerational Trauma and War-Induced PTSD in Kosovo: Insights from the Albanian Ethnic Group" [Trauma që kalon nga brezi në brez dhe PTSD e shkaktuar nga lufta në Kosovë: Përvojat e shqiptarëve], *Frontiers in Psychology*, 14, 2023.
[194] Mimoza Shahini dhe Merita Shala, "Post-Traumatic Stress Disorder in Kosovo Veterans" [Çrregullimi pas-traumatik i stresit te veteranët e Kosovës], 2016.
[195] Andrea García-González, "Feminist perspectives on peacebuilding and reconciliation" [Perspektiva feministe mbi ndërtimin e paqes dhe pajtimin], 2016.
[196] Intervista dhe grupet e fokusit të RrGK-së.
[197] Kosovo Online, "Studentet e Kosovës: Situata mund te jete me e rende, nuk mundemi si t'a mendojmë se çfarë na pret", 2024.
[198] Grupi fokusit i RrGK-së me gra të reja, 2025.
[199] Intervistë e RrGK-së me një përfaqësues të një OShCG-je që punon në fushën e fuqizimit ekonomik, 2025.

negative të punës së tyre.[200] Djegia profesionale e aktivisteve mund të zvogëlojë përpjekjet për ndërtimin e paqes, duke pasur parasysh rolin historik udhëheqës që ato kanë pasur në këtë fushë.

6.3. Shkaqet dhe rreziqet e konfliktit të dhunshëm

Më shumë se dy dekada pas luftës së viteve 1998–1999, Kosova vazhdon të përballet me një situatë të brishtë, të cilën disa pjesëmarrës e përshkruan si një vazhdimësi të konfliktit. Ndër nxitësit e përsëritur të konfliktit u përmendën politika, nacionalizmi, mungesa e drejtësisë, traumat e patrajtuara, komunikimi i dobët dhe dështimi për t'u përballur me të kaluarën.[201]

Në përgjithësi, mekanizmat e drejtësisë tranzicionale kanë pasur një qasje të dobët gjinore. Pavarësisht disa përmirësimeve gjatë viteve 2000, një qasje ndërthurëse ka munguar pothuajse plotësisht, ndërsa përpjekjet për të adresuar shkeljet e të drejtave të njeriut ndaj grave dhe individëve me identitete të tjera gjinore kanë qenë të pamjaftueshme.[202] As sistemi i drejtësisë në Serbi, as ai në Kosovë, nuk kanë ofruar drejtësi të plotë për viktimat e luftës - përfshirë kryesisht burrat civilë viktima të luftës dhe gratë mbijetuarat e dhunës seksuale. Është bërë vetëm pak përparim në drejtësinë tranzicionale,[203] e cila zakonisht përfshin llogaridhënie përmes ndjekjeve penale, proceseve të kërkimit të së vërtetës, masave riparuese dhe veprimeve parandaluese, të njohura si garanci për mos-përsëritje.[204] Këto masa janë zbatuar në mënyrë të pamjaftueshme në Kosovë, veçanërisht nga perspektiva gjinore.[205] Në vitin 2020, ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, u akuzua nga një prokuror special ndërkombëtar në Hagë për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, përfshirë afro 100 vrasje, në lidhje me rolin e tij në UÇK gjatë konfliktit të viteve 1998–1999.[206] Thaçi i ka mohuar akuzat.[207] Në vitin 2023, u iniciuan ose ishin ende në proces hetime për krime lufte ndaj civilëve në 26 raste, që përfshinin 81 pjesëtarë të forcave serbe dhe një anëtar të UÇK-së.[208] Deri në shkurt 2025, ishin ngritur 15 aktakuza ndaj 73 pjesëtarëve të forcave serbe të akuzuar për krime lufte në Kosovë. Ndryshimet ligjore të bëra ndërmjet viteve 2019 dhe 2022 mundësuan zhvillimin e gjykimeve në mungesë, duke kulmuar me miratimin e Kodit të Procedurës Penale të vitit 2022, i cili lejon gjykime të tilla për të gjitha veprat penale, përfshirë krimet e luftës.[209] Megjithatë, është bërë pak për të siguruar drejtësi, pasi shumica e personave të akuzuar për krime lufte, përfshirë dhunën seksuale, jetojnë në Serbi.[210] Meqenëse Serbia nuk e njeh Kosovën, ajo refuzon të ekstradojë personat përgjegjës, duke rritur kështu pandëshkueshmërinë.[211]

Reparacionet kanë përfshirë kërkimfalje publike, përkujtim dhe kompensime. Një shembull është vizita e Presidentit Thaçi tek një familje serbe e Kosovës që kishte humbur anëtarë të saj, gjatë së cilës ai u gjunjëzua dhe kërkoi falje, siç vuri në dukje një përfaqësuese e OShC-së. Qeveria e Serbisë nuk ka dhënë asnjë kërkimfalje publike për krimet e kryera nga vetë ajo,[212] megjithëse disa pjesëmarrës në

---

[200] Instituti i Xhorxhtaun për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, "The Women, Peace and Security Survey" [Sondazhi mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë], 2025.

[201] Drejtësia tranzicionale i referohet "të gjitha proceseve dhe mekanizmave që përdoren nga një shoqëri për t'u përballur me pasojat e abuzimeve të mëdha të së kaluarës, për të siguruar përgjegjshmëri, për të zbatuar drejtësinë dhe për të arritur pajtimin" (KSKB, "The rule of law and transitional justice in conflict and post-conflict societies Report of the Secretary-General" [Shteti i së drejtës dhe drejtësia tranzicionale në shoqëritë në konflikt dhe pas konflikteve: Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm], 2004).

[202] Maria Martin de Almagro dhe Philipp Schulz, "Gender and Transitional Justice" [Gjinia dhe drejtësia tranzicionale], *Oxford Research Encyclopedia of International Studies*, 2022.

[203] Intervista të RrGK-së me OShC-të që punojnë në fushën e drejtësisë tranzicionale në Kosovë, 2025.

[204] Priscilla Hayner, "Transitional Justice in Peace Processes: United Nations policy and challenges in practice"[Drejtësia tranzicionale në proceset e paqes: politikat e Kombeve të Bashkuara dhe sfidat në praktikë], 2023.

[205] Intervistë e RrGK-së me një përfaqësues të OShC-së, 2025.

[206] BBC, "Kosovo president rejects war crimes indictment as 'attempt to rewrite history'"[Presidenti i Kosovës refuzon aktakuzën për krime lufte si 'përpjekje për të rishkruar historinë], 2020.

[207] Po aty.

[208] FDH, "*Raporti për vitin 2023: Fillimi i një faze të re në gjykimin e krimeve të luftës*", 2024.

[209] FDH, "In absentia: Aktakuzat për krime lufte në Kosovë", Newsletter, 2025.

[210] FDH, "Thyerja e heshtjes: Drejtësi për viktimat e luftës?", 2024, f. 350.

[211] Po aty.

[212] Gjykata Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë (GjNPIJ) ka konstatuar se krimet janë kryer nga zyrtarë të Qeverisë së Serbisë (GjNPIJ, "Šainović et al. (IT-05-87)", Kombet e Bashkuara, n.d.). Duhet theksuar se kërkesa synon një kërkimfalje nga

hulumtim e konsideruan një nga hapat më të rëndësishëm në përballjen me të kaluarën. Përfaqësues të OShC-ve theksuan se kërkimfaljet duhet të pasohen nga ngritja e aktakuzave ndaj kriminelëve të luftës.

Memorializimi, edhe pse simbolik, është një element i rëndësishëm për adresimin e trashëgimisë së së kaluarës. Një temë e përsëritur midis pjesëmarrësve ishte se memorialet shpesh janë të maskulinizuara dhe "shumë të militarizuara", duke theksuar heroizmin mashkullor dhe militarizimin, teksa lënë në hije rezistencën paqësore dhe bashkëpunimin ndëretnik. Kjo ka për pasojë forcimin e narrativave nacionaliste, margjinalizimin e vuajtjeve të grave dhe të pakicave dhe rrezikon të përjetësojë konfliktin në vend që të promovojë paqen.[213]

> "Institucionet e Kosovës kanë bërë shumë pak për të edukuar dhe informuar brezat e rinj për të kaluarën. Ka pasur shumë pak qasje të ndjeshme ndaj gjinisë në këtë proces. Ne kemi një agjenci shtetërore për monumentet, që mbikëqyr ndërtimin e tyre në nder të individëve të ndryshëm. Por sikur të mos ishin OJQ-të, nuk do të kishim as memorialin 'Heroinë'. Gati të gjithë monumentet janë të dedikuara luftëtarëve [burra]."
>
> – Përfaqësuese e OShC

Kosova është më e dobët në aspektin e garancive për mos-përsëritje, të cilat lidhen me reformat institucionale. Kjo lidhet me kërkimin e së vërtetës mbi të kaluarën nga të gjitha palët. [214] Ekziston segregim në arsim, i cili thellon ndarjet etnike.[215] Të rinjtë serbë të Kosovës dhe romë zakonisht ndjekin sistemin arsimor serb, duke marrë mbështetje financiare nga Serbia për ta bërë këtë.[216] Kjo ndarje dhe mësimet e ndryshme të historisë rrezikojnë të thellojnë polarizimin, pasi të rinjtë nuk marrin një histori të përbashkët dhe të balancuar përmes arsimit formal. Një përfaqësuese e një OShC-je tregoi një histori rreth reagimit të të rinjve nga veriu i Kosovës kur vizituan ekspozitën "Na ishte një herë që mos qoftë" e dedikuar për 1,133 fëmijët e vrarë gjatë luftës:

> Kur panë ekspozitën, fillimisht mbetën të habitur, pastaj filluan të flisnin. Përshtypjet e tyre janë regjistruar në librin e vizitorëve... Ata e kuptojnë. Problemi është se nuk kanë qasje të mjaftueshme në informacion. Një arsye tjetër është barriera gjuhësore – ata janë të ekspozuar ndaj mediave serbofolëse dhe një narrative të njëanshme. […] Faktet e dokumentuara në gjykata duhet të jenë të qasshme për të gjithë. Vetëm kështu njerëzit mund të përpunojnë informacionin, të reflektojnë dhe të ndërtojnë një narrativë të bazuar në fakte, jo në mite.

Pjesëmarrësit kishin tendencë të bien dakord narrativat e ndryshme të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe të Qeverisë së Republikës së Serbisë thellojnë përçarjet, pengojnë komunikimin dhe bashkëpunimin ndëretnik dhe kontribuojnë në vazhdimësinë e konfliktit. Mungesa e marrëveshjes politike midis udhëheqësve, kryesisht burra, të dy qeverive u identifikua si një shkak rrënjësor i tensioneve. Retorika e thellësisht e polarizuar, shpesh e përdorur nga zyrtarët burra, u përshkrua në mënyrë të përsëritur si një nxitës i konfliktit. Në veri,

> "Nëse politika dhe e gjithë kjo do të hiqeshin, do të kishte paqe. Do të arrihej një kompromis, sepse njerëzit e zakonshëm janë të gatshëm për të bashkëpunuar dhe komunikuar."
>
> – Grua e re serbe nga Kosova

Qeveria e Serbisë dhe nuk synon të fajësojë popullin e Serbisë; disa aktivistë të etnive të ndryshme theksuan se populli serb i Kosovës nuk duhet fajësuar për veprimet e Qeverisë së Serbisë në vitet 1990, por Qeveria duhet të pranojë se çfarë ka ndodhur dhe të kërkojë falje (Intervista të RrGK-së, 2025).

[213] Maria Wendt, "Gendered Frames of Violence in Military Heritagization: The Case of Swedish Cold War History" [Kornizat gjinore të dhunës në trashëgimi ushtarake: Rasti i historisë së Luftës së Ftohtë të Suedisë], 2023, f. 24.

[214] Intervistë e RrGK-së me një përfaqësues të OShC-së, 2025.

[215] Qendra për Avokim dhe Kulturë Demokratike, "Research Analysis: Inter-Ethnic Cooperation of Youth in Kosovo—Challenges, Perspectives and Recommendations for Improvement" [Analizë hulumtuese: bashkëpunimi ndëretnik i të rinjve në kosovë—sfidat, perspektivat dhe rekomandimet për përmirësim], 2024.

[216] Intervistë e RrGK-së me një përfaqësues të OShC-së, 2025.

pjesëmarrësit kishin tendencë të fajësonin Qeverinë e Kosovës për nxitjen e tensioneve, ndërsa disa pjesëmarrës në jug konsideronin se serbët e Kosovës janë nën presion nga Qeveria e Serbisë. Pjesëmarrësit vlerësuan se serbët e Kosovës janë të ngujuar në një ngërç politik mes dy qeverive, të udhëhequra nga burrat, dhe se situata në veri ishte e brishtë kur anëtarët e LS-së ishin aktivë. Dominimi i LS-së në zonat me shumicë serbe është ruajtur përmes presionit dhe frikësimit, duke i udhëzuar votuesit se si të votojnë dhe duke kërcënuar kandidatët që nuk i përkisnin LS-së, duke krijuar një forcë politike autokratike që funksionon nën maskën e stabilizimit.[217] Disa pjesëmarrës në hulumtim vunë re se qytetarët në veri kanë filluar të "marrin frymë më lirshëm" qëkur ndikimi i bandave të lidhura me SL ka rënë. Kjo shoqërohet me një prani të shtuar të policisë, përfshirë njësitë e specializuara me armë të dukshme pranë shkollave dhe ndërtesave rezidenciale. Rritja e pranishmërisë së Policisë së Kosovës në veri është zbatuar për të përmirësuar sigurinë dhe për të zvogëluar kriminalitetin, veçanërisht tensionet ndër-etnike, megjithatë ekziston një diferencë e dukshme midis perspektivave të shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës ndaj këtyre veprimeve të Qeverisë së Kosovës.[218] Edhe pse sigurimi i shtuar në veri ka marrë mbështetje të fortë nga shqiptarët e Kosovës, ai ka kontribuar në ndjenja pasigurie tek serbët e Kosovës, veçanërisht tek gratë dhe fëmijët.[219]

Në veri, pjesëmarrësit raportuan se ngacmimi seksual ndaj grave të reja serbe ka rritur ndjeshëm ndjenjat e frikës dhe pasigurisë. Serbët e Kosovës shqetësohen gjithashtu se fluksi i diasporës gjatë verës mund të thellojë tendencat nacionaliste dhe rritjen e tensioneve, duke theksuar nevojën për masa parandaluese. Ngacmimi seksual prek të gjitha gratë në Kosovë dhe verifikimi i tij është i vështirë,[220] sidomos për shkak të mosbesimit ndaj policisë, i cili është përkeqësuar në veri. Pas dorëheqjes së zyrtarëve serbë të Kosovës, forca policore përbëhet kryesisht nga burra dhe nga shqiptarë të Kosovës.[221] Të dhënat nga një sondazh i opinionit i vitit 2024 tregojnë se ndërsa shumica e shqiptarëve të Kosovës raportojnë se janë të kënaqur (37%) ose shumë të kënaqur (51%) me performancën e Policisë së Kosovës, 34% e serbëve të Kosovës raportojnë se janë të pakënaqur dhe 37% shumë të pakënaqur.[222] Kjo diferencë reflekton probleme më të gjera lidhur me përfaqësimin, besimin dhe legjitimitetin. Disa gra kanë shprehur hezitim për t'u drejtuar tek zyrtarët policorë burra shqiptarë të Kosovës. Të dhënat tregojnë se gratë ndihen më të sigurta kur u drejtohen zyrtareve policore gra, duke nxjerrë në pah nevojën për më shumë zyrtare policore gra.[223] Perceptimet ndryshojnë lidhur me faktin nëse gratë serbe të Kosovës ndihen më të sigurta kur raportojnë te zyrtare policore serbe, për shkak të gjuhës dhe njohjes kulturore të përbashkët, apo kur raportojnë te zyrtare policore shqiptare të Kosovës, të cilat mund të perceptohen si më të besueshme për të ruajtur konfidencialitetin dhe për të zvogëluar frikën nga stigma që mund të lindë brenda komunitetit të tyre. Raportimet për ngacmime seksuale kanë shkaktuar përçarje midis grupeve etnike. Disa shqiptarë dhe akterë ndërkombëtarë besojnë se politikanët serbë keqpërdorin trupat e grave për të nxitur konflikt dhe për të ruajtur pushtetin. Megjithatë, këto raportime kanë krijuar frikë reale për dhunë ndaj grave dhe ndjenja pasigurie tek serbët e Kosovës. Ky kombinim i frikës reale dhe keqpërdorimit politik përmes mediave ka potencialin të thellojë tensionet ndëretnike dhe të përforcojë narrativat patriarkale.

---

[217] Misioni i Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, "Kosovo Legislative Elections Final Report" [Raporti përfundimtar i zgjedhjeve parlamentare në Kosovë], 2017.
[218] Milica Radovanovic, "In the Eye of the Storm: Perspectives on Crisis in North of Kosovo"[Në sy të stuhisë: Perspektiva mbi krizën në veri të Kosovës], NSI dhe CBM, 2024.
[219] Po aty; Intervista të RrGK-së, 2025.
[220] RrGK, "Ngacmimi seksual në Kosovë", 2016.
[221] Mihane Hoxha, "Political Tensions Test Unity of Kosovo's Police Force"[Tensionet politike vënë në provë unitetin e Policisë së Kosovës], Balkan Insight, 2025; Xhorxhina Bami dhe Milica Stojanovic, "Serbs Stage Mass Resignation from Kosovo State Institutions" [Dorëheqjet masive të serbëve nga institucionet shtetërore të Kosovës], 2022, Balkan Insight. Shih edhe seksionin më parë mbi pjesëmarrjen e grave në sektorin e sigurisë.
[222] Të dhëna të papërpunuara të ndara nga UNDP nga UNDP/USAID, "Public Pulse Brief XXVI", 2024.
[223] Jalicca May S. Torres, et al., "Unveiling the Lived Experiences of Police Officers in Dealing with Violence against Women and Children" [Zbërthimi i përvojave të zyrtarëve të policisë në trajtimin e dhunës ndaj grave dhe fëmijëve], *International Journal of Research and Innovation in Social Science*, 8(11), 3501–3517; UNSC, UNSCR 1960, 2010.

Tensionet politike në rritje i atribuohen udhëheqësve politikë. Udhëheqësit burra nuk kanë arritur të gjejnë marrëveshje mbi disa çështje gjatë Dialogut Beograd-Prishtinë, duke përkeqësuar tensionet përmes deklaratave publike, në vend që t'i qetësojnë ato. Për shembull, themelimi i Asociacionit të Komunave Serbe ka qenë një pikë kyçe mosmarrëveshjeje midis Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Serbisë, duke penguar përpjekjet për pajtim.[224] Serbia refuzon të njohë Kosovën, ndërsa Qeveria e Kosovës nuk pranon të negociojë për integritetin territorial, sovranitetin ose funksionet e brendshme me Serbinë.[225] Qëndrimet e palëkundura dhe mungesa e përparimit kanë kontribuar dhe mund të kontribuojnë në veprime unilaterale dhe në rrezik të konflikteve të mundshme. Për shembull, Qeveria e Kosovës ndërpreu përdorimin e dinarit serb dhe mbylli institucionet e administruara nga Serbia, duke shtuar tensionet.[226] Siç u përmend, këto veprime të ndërmarra nga udhëheqës burra kanë pasoja gjinore dhe kontribuojnë në pasiguri: të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe veçanërisht gratë kryefamiljare dhe ato në zona rurale, të cilat kanë më pak qasje në transport dhe pavarësi financiare, përballen me pengesa shtesë për të pasur qasje në shërbimet publike. Kjo thellon izolimin shoqëror dhe rrit cenueshmërinë ekonomike.

Paqëndrueshmëria ekonomike është një tjetër faktor që nxit pasiguri dhe emigrim mes grupeve etnike. Shkaktarët kryesorë të emigrimit të mundshëm të të anketuarve raportohen të jenë vështirësitë ekonomike të familjes, kërkimi i një të ardhmeje më të mirë për familjen dhe papunësia.[227] Përveç rrezikut të përmendur më parë që burrat e rinj të papunë mund të përfshihen në konflikte, pjesëmarrësit vënë në dukje një trend në rritje të serbëve që largohen nga Kosova për të gjetur punë, pas mbylljes së institucioneve serbe, duke reduktuar mundësitë për ndërveprim ndër-etnik. Eksodi i serbëve të Kosovës forcon përjashtimin dhe mund të ushqejë retorikën nacionaliste në Kosovë dhe Serbi. Mbulimi mediatik rrezikon të paraqesë shqiptarët e Kosovës si ata që margjinalizojnë qëllimisht serbët e Kosovës, duke rritur tensionet përtej kufijve.

Seksualiteti i individëve LGBTQI+ është përdorur gjithashtu për qëllime nacionaliste dhe për të nxitur dhunë. Në vitet 1990, fushatat publike përdornin shpifje dhe frikësim për të detyruar aktivistët të braktisnin iniciativat e paqes midis grave serbe dhe shqiptare.[228] Që atëherë aktivistët LGBTQI+ janë përballur me ngacmime dhe kërcënime për dhunë përmes telefonit, rrjeteve sociale dhe në hapësira publike. Një fushatë online vendosi shënjestra armësh mbi fotografitë e aktivistëve, duke nxitur dhunë ndaj tyre. Fushatat e Krenarisë në Serbi janë sulmuar shpesh, dhe aktivistët LGBTQI+ vazhdojnë të përjetojnë ngacmime dhe kërcënime. Të perceptuar si më pak të prirur për të pasur fëmijë, personat LGBTQI+ janë paraqitur si "armiq" të vlerave familjare të socializuara dhe qëllimeve etno-nacionaliste, duke rrjedhur nga ideja se personat LGBTQI+ nuk kontribuojnë në rolet tradicionale riprodhuese ose nuk kryejnë detyrat kombëtare për të rritur natalitetin tek shumica etnike për të ruajtur pushtetin. Për shembull, gjatë debatimeve mbi Kodin Civil të Kosovës, legalizimi i martesave të së njëjtës gjini ishte një pikë kyçe ndarjeje midis deputetëve, dhe disa përdorën gjuhë diskriminuese dhe provokuese, duke përkeqësuar një ambient tashmë armiqësor ndaj personave LGBTQI+.[229] Kjo retorikë nacionaliste mund të nxisë dhunë ndaj personave dhe aktivistëve LGBTQI+, duke kontribuar në pasigurinë e tyre dhe potencialin për konflikt.[230]

> "Personat LGBTI përhapin sëmundje."
>
> – Deputete Labinotë Demi Murtezi, cituar nga CEL, "Homofob, s'ke vend në Kuvend!", 2024

[224] Grupi për Hulumtime të Politikave në Ballkan, "Asociacioni i komunave serbe: Të kuptuari e pikëpamjeve kontradiktore që shqiptarëve dhe serbëve", 2017.
[225] Marko Savković, "How does Kurti see the dialogue?" [Si e sheh Kurti dialogun], 2021, f. 202.
[226] Associated Press, "Kosovo Shuts 6 Serb Bank Branches Over Use of the Dinar Currency in a Move that Could Raise Tensions"[Kosova mbyll 6 degë bankash serbe për përdorimin e monedhës dinar, një veprim që mund të rrisë tensionet], 2024.
[227] Të dhëna të papërpunuara të ndara nga UNDP nga UNDP/USAID, "Public Pulse Brief XXVI", 2024.
[228] Intervista të RrGK-së me përfaqësues të OShCG-ve, 2025.
[229] Intervista të RrGK-së me përfaqësues të OShC-ve, 2025.
[230] CSGD, "LGBTI dhe politika- përmbledhje ", 2022, f. 5.

6.4. Përfundimi

- Vdekja që rezulton nga konflikti ka prekur më shumë burra. Pasoja të tjera të konfliktit kanë prekur në mënyrë disproporcionale gratë, duke përfshirë ndjenjat e pasigurisë, qasjen e dobët në shërbime, djegjen profesionale tek aktivistët, uljen e pjesëmarrjes, mungesën e gatishmërisë për t'u angazhuar në proceset e paqes, si dhe problemet shëndetësore.
- Shkaqet e identifikuara të konfliktit përfshijnë drejtësinë e pamjaftueshme (tranzicionale); sistemet arsimore të ndara me historinë që nuk i kushton vëmendje të kaluarës dhe përforcon normat gjinore; komunikimin e dobët që kontribuon në mosbesim; paqëndrueshmërinë ekonomike; dhe narrativat patriarkale të polarizuara, etno-nacionaliste, të përhapura kryesisht nga udhëheqës politikë burra që kërkojnë të mbajnë pushtetin.

7. Palët e përfshira në konflikt dhe paqe

Ky seksion shqyrton perceptimet e palëve të përfshira në konflikt dhe paqe, interesat e tyre dhe dallimet gjinore.

7.1. Akterët që kontribuojnë në konflikt

"Gratë janë më të prirura të largohen nga konflikti, të thyejnë barrierat dhe të bashkohen për një kauzë, dhe këtë e kemi vërejtur gjatë viteve. Ato duan që fëmijët e tyre të rriten në paqe për brezat që do të vijnë." – OShCG

"Nuk ka gra që dëshirojnë konflikt, pavarësisht nga raca, etnia apo kombësia. Meqenëse gratë e ndiejnë realitetin shumë ndryshe nga burrat, ato mund të bëjnë ndryshime dhe të sjellin paqe në botë. Burrat, nga ana tjetër, shpesh kanë një ndjenjë të fortë krenarie që i bën të ndihen të pushtuar dhe i shtyn drejt konfliktit." – OShCG

Pjesëmarrësit në hulumtim sugjeruan vazhdimisht se gratë kanë tendencë të shmangin konfliktin. Ndërkohë, burrat perceptohen si ata që formësojnë politikën, duke maskuar nacionalizmin me patriotizëm. Këto perceptime pasqyrojnë stereotipe gjinore heteronormative, ku gratë portretizohen si natyrshëm paqësore, të kujdesshme dhe kryesisht të shqetësuara për mirëqenien e fëmijëve të tyre dhe brezave të ardhshëm, ndërsa burrat përshkruhen si agresorë të motivuar nga krenaria, të orientuar drejt konfliktit. Literatura feministe kritikon portretizime të tilla si potencialisht homogjenizuese dhe reduktuese, duke paralajmëruar se ato mund të errësojnë identitetet ndërthurëse dhe të përforcojnë hierarkitë ekzistuese të pushtetit.[231] Përshkrimet e homogjenizuara të grave dhe burrave injorojnë proceset e socializimit përmes të cilave krijohen normat gjinore, rrjedhimisht, mund të ndryshojnë.

Pjesëmarrësit në hulumtim identifikuan vazhdimisht udhëheqës politikë burra në Kosovë dhe Serbi, të ndikuar nga fuqitë ndërkombëtare mes qëllimeve më të gjera gjeopolitike, si palët kryesore në konflikt. Sipas pjesëmarrësve, Qeveria e Kosovës dhe ajo e Serbisë tregojnë mungesë vullneti për zgjidhje paqësore dhe, për pasojë, ushqejnë narrativa konfrontuese për të mbajtur pushtetin. Këto gjetje mbështeten nga një sondazh i opinionit të vitit 2024, në të cilin 45% e të anketuarve identifikuan partitë politike dhe 44% identifikuan ekzekutivin e Kosovës si akterët më përgjegjës për situatën aktuale politike.[232]

> "Konflikti është biznes. Lufta është biznes… Luftën nuk e krijojnë njerëzit; atë e krijojnë fuqitë e mëdha."
>
> – OShCG

[231] Laura J. Shepherd, *Gender, Violence & Security* [Gjinia, dhuna dhe siguria], Londër, Mbretëria e Bashkuar: Zed Books Ltd, 2008.
[232] Të dhëna të papërpunuara të ndara nga UNDP nga UNDP/USAID, "Public Pulse Brief XXVI", 2024.

Ashtu si kudo në botë, si Qeveria e Serbisë ashtu edhe Qeveria e Kosovës udhëhiqen nga burra. Qeveria e Serbisë e ka bërë të qartë se nuk do ta njohë Kosovën, duke theksuar pikëpamjet e saj nëpërmjet medias.[233] Kjo kontribuon në një mjedis të paqartë dhe të paqëndrueshëm. E mbështetur nga Qeveria e Serbisë, LS e udhëhequr nga burra, kryesoi tërheqjen e serbëve të Kosovës nga institucionet e Kosovës në vitin 2022,[234] gjë që ka kontribuar në nën-përfaqësimin e serbëve të Kosovës në qeverisje dhe siguri, duke përfshirë gratë. Qeveria e Serbisë gjithashtu ka kontribuar në konflikt duke mbështetur **grupet paramilitare** të udhëhequra nga LS, duke mobilizuar kundër Policisë së Kosovës dhe KFOR-it, dhe nëpërmjet rritjes së pranisë ushtarake pranë kufirit të Kosovës në vitin 2023.[235] Në vitin 2024, autoritetet e Kosovës sekuestruan armë dhe municione që besohet se i përkisnin grupit të armatosur serb përgjegjës për sulmin në Banjska në vitin 2023.[236] Qeveria e ë Kosovës ka deklaruar se e konsideron Serbinë një kërcënim të madh për sigurinë.[237]

E udhëhequr nga partia politike ***Vetëvendosje*** (VV), Qeveria e Kosovës mbylli institucionet e ndikuara nga Qeveria e Serbisë dhe ka rritur praninë e personelit të sigurisë në veri për të rritur sigurinë. Veprimet e Qeverisë së Kosovës kanë shqetësuar BE-në dhe Shtetet e Bashkuara, të cilat shprehën shqetësim se mund të përshkallëzojnë tensionet dhe të dëmtojnë përpjekjet për pajtim.[238] Mbyllja e shpejtë e institucioneve dhe ndërprerja e përdorimit të dinarit serb, me kohë minimale tranzicioni për popullsinë dhe koordinim të dobët me partnerët ndërkombëtarë, mund të kontribuojnë në tensione dhe konflikt të ri.

BE-ja gjithashtu ka shprehur shqetësim për ndikimin e mundshëm **rus** në Ballkanin Perëndimor, duke penguar integrimin e rajonit në BE dhe NATO.[239] Serbët e Kosovës mund ta mbështesin Rusinë si mbrojtëse të interesave serbe, duke pasur parasysh qëndrimin e saj kundër pavarësisë së Kosovës.[240] Në këtë kontekst, qeveria ruse, e udhëhequr kryesisht nga burrat, mund të paraqesë një sfidë për stabilitetin e Kosovës, përfshirë edhe përmes mediave pro-ruse në Serbi.[241]

Për shqiptarët e Kosovës, stacionet televizive kosovare (86%) dhe mediat sociale janë burimet kryesore të informacionit. [242] Serbët e Kosovës zakonisht mbështeten çdo ditë te stacionet televizive serbe, duke shprehur më shumë besim ndaj këtyre mediave sesa ndaj RTK2 dhe mediave të tjera kosovare.[243] Mediat serbe perceptohen gjerësisht si të njëanshme në favor të presidentit Vuçiq dhe pushtetit të tij.[244] Raportohet se dezinformimi dhe informacioni i gabuar është drejtuar ndaj serbëve të Kosovës.[245] Këto media priren të forcojnë qëndrimet nacionaliste dhe të thellojnë mosbesimin.

---

[233] Radio Evropa e Lirë, "Serbian President Rules Out 'Factual or De Jure' Recognition of Kosovo" [Presidenti serb përjashton njohjen 'faktike ose de jure' të Kosovës], 2023.
[234] Democracy, "Serbs decide to leave Kosovo institutions"[Serbët vendosin të largohen nga institucionet e Kosovës], 2022.
[235] Grupi Ndërkombëtar për Kriza,, "Northern Kosovo: Asserting Sovereignty Amid Divided Loyalties" [Veriu i Kosovës: Pohimi i sovranitetit mes besimeve të ndara], 2024; International Crisis Group, "Behind the Renewed Troubles in Northern Kosovo"[Prapa shqetësimeve të reja në veriun e Kosovës], 2023.
[236] Reuters, "Former Officer Detained as Police Seize Weapons Cache in Northern Kosovo" [Ish-zyrtari në paraburgim teksa policia sekuestron arsenal armësh në veri të Kosovës], 2024.
[237] Euronews Albania, "Kurti: Serbia me "metodat e Putinit" rrezik për Kosovën dhe vetë. serbë", 2024; Reuters, "Pristina Says Evidence Shows Serbia Planned To Seize Northern Kosovo After Attack" Prishtina: Provat tregojnë se Serbia planifikoi të merrte kontrollin e veriut të Kosovës pas sulmit, 2023.
[238] The Seattle Times, "EU reprimands Kosovo's move to close down Serb bank branches over the use of the dinar currency" BE kritikon veprimin e Kosovës për mbylljen e degëve të bankave serbe për shkak të përdorimit të dinarit], 2024.
[239] Parlamenti Evropian, "Russia and the Western Balkans Political Confrontation, Economic Influence and Political Interference"[Rusia dhe Ballkani Perëndimor: Përballja politike, ndikimi ekonomik dhe ndërhyrja politike], 2023; International Republican Institute, "Western Balkans Regional Survey" [Sondazhi rajonal i Ballkanit Perëndimor], 2024.
[240] Daniel Heler, "Exploring Roots of Russophilia among North Kosovo Serbs"[Eksplorimi i rrënjëve të rusofilisë te serbët e veriut të Kosovës], Western Balkan at the Crossroads, 2024.
[241] Pëllumb Kallaba, "Russian Interference in Kosovo: How and Why?"[Ndërhyrja ruse në Kosovë: Si dhe pse?], KCSS, 2017.
[242] NDI, "NDI Kosovo Public Opinion Survey", 2021; QKSS, " Në ç 'mënyrë dezinformim shënjestron dhe dhimbje në lidhjet ndëretnike në Kosovë? ", 2025.
[243] Po aty.
[244] Friedrich Naumann Foundation for Freedom, "Study confirms Serbian media bias in favour of President Vučić"[Studimi konfirmon paragjykimin e mediave serbe në favor të Presidentit Vuçiq], 2022.
[245] IREX, "Vibrant Information Barometer", 2023.

Dezinformimi është i orientuar sipas linjave të polarizimit kombëtar, ku theksohen dikotomi të tilla si "qeveri-opozitë" dhe "Beograd-Prishtinë".[246] Dezinformimi ka ushqyer tensionet midis shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës dhe ka përhapur narrativa kundër integrimit në NATO dhe BE.[247] Serbët e Kosovës priren të besojnë këto narrativë dezinformuese, përfshirë kërcënimet për keqtrajtimin dhe pastrimin etnik nga Policia e Kosovës, veçanërisht gjatë sulmit në Banjska.[248] Ndërkohë që mediat serbe ushqejnë frikën duke sugjeruar se shqiptarët e Kosovës mund të sulmojnë serbët e Kosovës, **mediat kosovare** kanë bërë pretendime për një pushtim ushtarak të afërt nga Serbia.[249] Në këtë mënyrë, mediat kryesore të Kosovës dhe Serbisë kontribuojnë në formimin e narrativeve të ndryshme, shpesh duke reflektuar dallime gjinore, që mund të ushqejnë frikën tek shqiptarët dhe serbët e Kosovës, të përhapin retorikë politike etno-nacionaliste,[250] dhe potencialisht të kontribuojnë në konflikt.

7.2. Akterët që kontribuojnë në paqe

"Mendoj se ajo që është vërtet e jashtëzakonshme në Kosovë është puna e shoqërisë civile dhe veçanërisht e organizatave të grave." – Zyrtar ndërkombëtar

Sa i përket akterëve që kontribuojnë për paqen, pjesëmarrësit në hulumtim theksuan rolin e **OShC-ve**, veçanërisht të **OShCG**-ve. OShC(G)-të ndërmarrin nisma që i bëjnë bashkë njerëzit e ndryshëm*, duke punuar në nivel lokal dhe "në terren". Aktivitetet e tyre përfshijnë përpjekje të drejtpërdrejta për ndërtimin e paqes, si iniciativa dialogu dhe pajtimi i komunitetit, si dhe kontribute indirekte përmes arsimit, trajnimeve dhe ngjarjeve kulturore. Pjesëmarrësit ndanë shembuj të aktiviteteve si festivale multietnike (feministe), koncerte dhe ekspozita arti Pjesëmarrësit ndanë shembuj të aktiviteteve si festivalet shumëetnike (feministe), koncertet dhe ekspozitat artistike, që i bënin bashkë njerëz të ndryshëm* dhe ndihmonin në ndërtimin e marrëdhënieve. Edhe pse nuk përshkruheshin gjithmonë në mënyrë eksplicite si aktivitete të ndërtimit të paqes, këto iniciativa u panë si hapësira të rëndësishme për të nxitur mirëkuptimin, besimin dhe kohezionin shoqëror midis individëve nga komunitete etnike të ndryshme. **OShCG**-të u njohën veçanërisht për ndikimin e tyre në ndërtimin e paqes.[251] Megjithatë, gratë paqebërëse përballen me pasoja negative si rezultat i përpjekjeve të tyre, duke përfshirë kohën e pakompensuar, lodhjen, përkeqësimin e shëndetit mendor, traumat sekondare, dhunën në internet dhe kërcënimet për dhunë.[252] Puna e tyre gjithashtu rrezikohet nga ndërprerje globale të fondeve për të drejtat e grave dhe barazinë gjinore. Raportohet se ngrirja e ndihmës nga SHBA-ja ka shkaktuar ulje ose ndërprerje të shërbimeve vitale për grupet e cenueshme, shkurtim të stafit, lodhje të aktivistëve dhe mbyllje të organizatave.[253]

OShC(G)-të që punojnë me **persona me aftësi të kufizuara** dhe **aktivistë LGBTQI+** kanë luajtur një rol të rëndësishëm në ndërtimin e paqes duke promovuar përfshirjen, barazinë dhe mbrojtjen ligjore për grupet e margjinalizuara. Pjesëmarrësit vunë në dukje rolin e tyre në avokimin për ligje kundër krimeve të urrejtjes, sigurimin e mbrojtjes kushtetuese dhe zbatimin e tyre. OShC-të për LGBTQI+ kanë krijuar hapësirë për dialog midis personave të etnive të ndryshme, duke sfiduar paragjykimet dhe duke nxitur mirëkuptimin. **Gazetaret gra**, veçanërisht përmes Rrjetit të sapo-themeluar të Grave Gazetare të Kosovës, u njohën për kontributin e tyre në promovimin e paqes dhe qëndrueshmërisë, duke formësuar

---

[246] CRTA, "Report: Mapping disinformation in the Serbian media"[Raporti: Identifikimi i dezinformatave në mediat serbe], 2023.
[247] Kreshnik Gashi, et al., "The Story of Our Lies" [Historia e gënjeshtrave tona], BIRN, 2023.
[248] KCSS, "How Does Disinformation Target and Affect Interethnic Relations in Kosovo?" [Si synon dhe ndikon dezinformimi në marrëdhëniet ndër-etnike në Kosovë], 2025.
[249] Ekonomia Online, "Spahiu: Kosova ndodhet në një rrezik lufte nga Serbia ", 2022: Klan Kosova, "Kastrati: Kosova është në rrezik të vazhdueshëm nga Serbia ", 2024.
[250] QKSS, "How Does the Securitization of Kosovo-Serbia Relations Impact the Escalation of Tensions and the Role of Media in Shaping Narratives?", 2023.
[251] Shih gjithashtu, RrGK, *Fakte dhe fabule për Rezolutën 1325*, 2022.
[252] Instituti i Xhorxhtaun për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, "The Women, Peace and Security Survey", Research Report, Washington, DC, 2025. Uashington, DC, 2025. Kjo është bazuar në të dhëna preliminare nga një mostrë prej 41 grave aktiviste për paqen të përzgjedhura vetë në Kosovë. Edhe pse madhësia e mostrës është e vogël dhe jo e rastësishme, ajo ilustron në mënyrë cilësore çështje që prekin shumë gra paqeruajtëse në Kosovë.
[253] Kjo gjithashtu u ilustrua përmes një sondazhi të shpejtë të OShGC-ve në Kosovë dhe Ballkanin Perëndimor, të realizuar nga RrGK and Reactor Research in Action, 2025.

narrativat mediatike, rritur dukshmërinë e çështjeve të barazisë gjinore dhe promovuar diskurs publik gjithëpërfshirës. **Organizatat ndërkombëtare** u përmendën gjithashtu, edhe pse iniciativat e tyre ndonjëherë u përshkruan si jo mjaftueshëm të orientuara nga qasja *bottom up*. Disa pjesëmarrës vënë re se projektet ndërkombëtare shpesh kishin vështirësi të angazhonin në mënyrë domethënëse njerëz të ndryshëm* në nivel lokal, si gjatë planifikimit, ashtu edhe gjatë zbatimit. Ata theksuan rëndësinë e krijimit të hapësirave të sigurta për pjesëmarrje, duke siguruar konsultime kuptimplote dhe duke përshtatur ndërhyrjet sipas kontekstit lokal; projekte të dizajnuara për Prishtinën mund të mos jenë të përshtatshme për zonat rurale ose komunat më të vogla. Disa pjesëmarrës vunë re se projektet e etiketuara qartë si "projekte paqeje" mund të dekurajojnë angazhimin; iniciativat e fokusuar në shqetësime lokale shpesh janë më efektive. Ata rekomanduan shmangien e temave politike në nismat e paqes, duke sugjeruar që diskutimi të përqendrohet në bashkëpunim dhe krijim të përbashkët: "Nuk duhet të flasim vetëm për të vrarët, të zhdukurit, të përdhunuarit... Le të flasim për prodhim të përbashkët, për një mënyrë të përbashkët bashkëpunimi."

Megjithatë, institucionet shpesh perceptohen si kontribuese në konflikt, por disa zyrtarë u përmendën si të përkushtuar ndaj ndërtimit të paqes, përfshirë ish-Presidenten Jahjaga, e cila nisi disa procese për zbatimin e Agjendës GPS; Presidenten Vjosa Osmani me Forumin e saj vjetor GPS; ish-Ministren e Drejtësisë Albulena Haxhiu, e cila punoi për adresimin e dhunës me bazë gjinore; dhe ish-Zëvendësministren e Drejtësisë dhe koordinatoren kundër dhunës në familje Nita Shala. Disa figura publike mashkullore u njohën gjithashtu për mbështetjen e përfshirjes së grave në institucione, përfshirë Behar Selimin në Policinë e Kosovës,[254] Besim M. Kajtazin në sistemin ligjor dhe si trajner GPS, ish-gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese Bekim Sejdiu, dhe Ministrin e Mbrojtjes Ejup Maqedonci. Pjesëmarrësit vunë re se Njësia për Barazi Gjinore e FSK-së ka promovuar barazinë gjinore, një mjedis pune gjithëpërfshirës dhe mundësi të barabarta për avancim. Ish-Presidenti Thaçi tentoi të krijonte Komisionin e së Vërtetës për Drejtësinë Tranzicionale; megjithatë, ai u kritikua për mundësinë e politizimit, dhe procesi u ndal pas aktakuzës së tij nga Dhomat e Specializuara dhe dorëheqjes së tijn.[255]

Qeveria e Kosovës, në krye me kryeministrin Kurti, ka deklaruar se e konsideron të rëndësishme për drejtësinë tranzicionale kujtimin dhe përballjen me të kaluarën.[256] Qeveria e Kurtit organizoi konsultime me grupe të ndryshme etnike.[257] Perspektivat e grave u përfshinë gjithnjë e më shumë pas kritikave që seancat e hershme ishin të dominuara nga burrat. Çështjet që preknin gratë zakonisht ndryshonin nga ato që ngrinin burrat. Disa serbë të Kosovës nuk morën pjesë në diskutime për shkak të frikës nga reagimet negative dhe/ose keqpërdorimi politik. Ata që morën pjesë kërkuan konfidencialitet, duke kërkuar që takimet të mos bëheshin publike. Incidentet e mëparshme ku pjesëmarrësit u fotografuan në ambiente të ngjashme kishin shkaktuar pasoja për ta. Një zyrtar i Qeverisë së Kosovës tha se, edhe pse konfidencialiteti ishte i nevojshëm për mbrojtjen e pjesëmarrësve, ai e vështirësonte promovimin dhe krijimin e mbështetjes më të gjerë publike për përpjekjet e dialogut. Ndërkohë, disa aktivistë serbë të Kosovës ndjenë se Qeveria e Kosovës keqpërdori takimet për arsye politike. Ata dhanë shembullin e takimeve me OShC-të serbe që u organizuan nga Qeveria nën pretekst të rremë të diskutimit të granteve. Disa aktivistë serbë perceptuan këto takime si veprime politike për të sinjalizuar angazhimin me serbët, në vend të një përpjekjeje të sinqertë për të nxitur dialog të vërtetë ose për të adresuar shqetësimet e tyre. Disa aktivistë serbë më vonë refuzuan të merrnin pjesë në takime derisa ato të regjistroheshin zyrtarisht dhe të ndërmerreshin hapa konkretë për adresimin e shqetësimeve të tyre.

Sa i përket medias, gazetarët shqiptarë dhe serbë të Kosovës vënë në dukje se historitë pozitive që promovojnë paqen, integrimin dhe bashkëjetesën janë të pakta. Zakonisht ato publikohen vetëm në

[254] RrGK, *Fakte dhe fabule për Rezolutën 1325* 2022, f. 90.
[255] Drejtësia Tranzicionale në Ballkan, "Aktakuza ndaj Thaçit e vë në pikëpyetje të ardhmen e Komisionit të së Vërtetës", 2020.
[256] Associated Press, "Kosova do të ngrejë një institut për dokumentimin e krimeve nga serbët gjatë luftës 1998–1999 ", 2023; Perparim Isufi, "Kosova përkujton masakrat e fshatrave ndërsa Kurti kërkon më shumë hetime për krimet e luftës", 2024.
[257] Ky paragraf bazohet në intervista të RrGK-së me OShC dhe zyrtarë, 2025.

mediat në gjuhën angleze, si Balkan Insight,[258] Kosovo 2.0, Prishtina Insight dhe Kossev, të financuara nga donatorë ndërkombëtarë. Këto zëra alternativë për paqen janë të rrezikuar për shkak të reduktimeve të paparashikuara të fondeve nga SHBA-ja.[259]

7.3. Palët e tjera të interesuara

Palët e tjera të interesuara të prekura nga konflikti përfshijnë popullsinë e përgjithshme. Pajtimi i pamjaftueshëm midis Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Serbisë ka rritur ankthin tek shqiptarët dhe serbët e Kosovës, [260] si dhe tek personat e etnive të tjera. Mungesa e një situate politike të qëndrueshme kontribuon në ndjenja pasigurie tek gratë dhe burrat e ndryshëm*. Në të njëjtën kohë, gratë dhe burrat mund të nxisin si paqen, ashtu edhe konfliktin.

Teksa të gjithë **serbët e Kosovës** zakonisht kundërshtojnë shtetësinë e Kosovës, kjo është më e dukshme në veri. Presioni shoqëror dhe frika nga refuzimi nga bashkëkombësit mund të çojnë disa serbë drejt përfshirjes në konflikt. Disa shprehin shqetësimin se Qeveria e Kosovës dhe shqiptarët e Kosovës nuk e njohin ekzistencën e personave të zhdukur serb dhe viktimave civile të luftës, duke i dhënë përparësi shqetësimeve të shqiptarëve mbi ato të serbëve. Diskutimi publik i pamjaftueshëm dhe adresimi i pakët i shqetësimeve të serbëve të Kosovës mund të pengojë përpjekjet për integrim dhe për të lërë hapësirë për konflikt të mundshëm.

Sigurimi i shtuar në komunat veriore me shumicë serbe nga Kryeministri Kurti gëzon mbështetje të konsiderueshme nga **shqiptarët e Kosovës**.[261] Të rinjtë shqiptarë janë më të prirur të mbështesin ndjekjen penale të krimeve të luftës dhe adresimin e mizorive të së kaluarës, ndërsa të rinjtë serbë kanë më pak gjasa të mbështesin këto veprime, duke besuar se ato kontribuojnë më pak në pajtim.[262] Një sondazh tregon se 92% e shqiptarëve të anketuar besonin se Serbia duhet të kërkojë falje për krimet e luftës në Kosovë, dhe 79% mendonin se gjykatat e Kosovës duhet të ndjekin penalisht krimet pa marrë parasysh shtetin ose prejardhjen etnike.[263]

Të gjitha **grupet etnike** janë të prekura nga konflikti midis Kosovës dhe Serbisë.[264] **Boshnjakët, goranët** dhe **romët** kanë marrë ndihmë sociale, paga dhe pensione nga Serbia; kështu, ata u prekën nga vendimi i Qeverisë së Kosovës për të mbyllur zyrat postare dhe bankat serbe dhe për të ndërprerë transaksionet në dinarë.[265] Boshnjakët dhe romët që jetojnë në veri të Kosovës ndihen të pasigurt, të ngujuar mes çështjeve politike të Serbisë dhe Kosovës.[266] Të rinjtë romë shpesh mësojnë si shqip ashtu edhe serbisht, por mund të ndiejnë presion shoqëror për të "zgjedhur anë". [267] **Turqit e Kosovës** zakonisht jetojnë larg zonave të konfliktit, janë relativisht të paprekur dhe kanë tendencë të mbështesin qëndrimet e shqiptarëve të Kosovës. Edhe pse gjeografikisht larg vijave të mundshme të konfliktit,

---

[258] Balkan Insight, " Në Kosovë, puna i sjell bashkë disa serbë e shqiptarë", 2024.
[259] BIRN, "Central European Media, NGOs Face Uncertain Future After US Funding Freeze", Balkan Insight, 2025.
[260] Shpat Balaj dhe Gramos Sejdiu, "What Are the Kosovo Citizens' Perceptions on Inter-Ethnic Relations? Fostering Inter-Ethnic Relations and Reconciliation Survey Results"[Cilat janë perceptimet e qytetarëve të Kosovës mbi marrëdhëniet ndër-etnike? Rezultatet e sondazhit për promovimin e marrëdhënieve ndër-etnike dhe pajtimin], QKSS, 2022.
[261] Milica Radovanovic, "In the Eye of the Storm: Perspectives on Crisis in North of Kosovo", NSI dhe CBM, 2024. Sondazh i realizuar nga UBO Consulting (29 shkurt–7 mars 2024) me 460 të anketuar mbi 18 vjeç nga veriu dhe jugu i Mitrovicës (230 secili), duke përdorur intervista të asistuara nga kompjuteri përmes telefonit (CATI) dhe intervista të asistuara personalisht nga kompjuteri (CAPI). Mostra ishte e balancuar gjinore (49% burra, 51% gra), kryesisht urbane (65%), dhe përbërja etnike ishte: 57% shqiptarë, 38% serbë, 2% romë, 1% boshnjakë, 1% ashkali, 1% egjiptianë dhe 0.2% turq.
[262] Bekim Baliqi, "Youth attitudes towards war and war crimes in Kosovo" [Qëndrimet e të rinjve ndaj luftës dhe krimeve të luftës në Kosovë], YIHR KS, 2024.
[263] Po aty.
[264] Marius-Ionut Calu, "Non-Dominant Groups in Kosovo: A Marginalised View on (De)Securitisation of Minorities After Conflict", *Journal on Ethnopolitics and Minority Issues in Europe*, 20(1), 2021.
[265] Intervista të RrGK-së.
[266] Intervista të RrGK-së and focus groups.
[267] Po aty.

goranët kanë marrë ndihmë sociale, kujdes shëndetësor, arsim, pensione dhe shërbime sociale nga Qeveria e Serbisë.[268] dhe prandaj u prekën nga mbyllja e institucioneve serbe nga Qeveria e Kosovës.

Udhëheqësit fetarë, zakonisht burra, të feve të ndryshme mund të kontribuojnë si në paqe ashtu edhe në konflikt.[269] Teoritë e disa studiuesve si Huntington argumentojnë se dallimet kulturore dhe fetare janë burime kryesore të konflikteve globale, por kritikët dhe akademikë si Galtung, Stewart, Fearon dhe Laitin theksojnë se feja rrallëherë është shkaku themelor.[270] Konflikti shpesh lind kur identitetet fetare ose kulturore ndërthuren me pabarazitë politike dhe ekonomike. Feja mund të shërbejë si mjet për konflikt kur është e ngulitur në padrejtësi strukturore më të gjera, por gjithashtu mund të jetë një forcë për paqe nëse përdoret për të promovuar përfshirje, pajtim dhe kohezion shoqëror.

Të rinjtë u përmendën nga pjesëmarrësit në hulumtim si një grup i të cilit qëndrimet janë ende në formim. Edhe pse ata mund të trashëgojnë armiqësi nga gjeneratat e mëparshme dhe, për pasojë, të kontribuojnë potencialisht në konflikt, ata gjithashtu mund të ndikohen drejt qëndrimeve më përfshirëse. Prandaj, pjesëmarrësit zakonisht i identifikuan të rinjtë si një grup prioritar për përpjekjet e ndërtimit të paqes.

7.4. Përfundimi

- Burrat, veçanërisht udhëheqësit politikë burra në Kosovë dhe Serbi, kanë kontribuar në konflikt.
- Gratë, burrat dhe OShC(G)-të e ndryshme* kanë kontribuar në paqen në Kosovë, megjithë kërcënimet e vazhdueshme.
- Homogjenizimi i grave si paqësore prej natyrës ose i burrave si agresivë mund të anashkalojë shumësinë e roleve të luajtura nga gratë dhe burrat e ndryshëm* në Kosovë, të përforcojë normat ekzistuese gjinore në vend që t'i sfidojë dhe të kufizojë rolet e tyre në avancimin e paqes.

8. Ndjeshmëria gjinore e përpjekjeve për ndërtimin e paqes

Ky seksion i përgjigjet pyetjes: sa gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme ndaj aspektit gjinor kanë qenë aktivitetet e kaluara dhe të tashme të parandalimit, ndërtimit të paqes dhe stabilizimit? Ai bazohet në intervista dhe analizë të përmbajtjes, duke përfshirë një rishikim të 27 projekteve të ndërtimit të paqes dhe pajtimit, të përzgjedhura me mostër të qëllimshme. Projektet u përqendruan në transformimin e konfliktit, dialogun ndëretnik, drejtësinë tranzicionale, ndërtimin e paqes për të rinjtë dhe mbështetjen e të mbijetuarve të dhunës seksuale të lidhur me konfliktin.

Përafërsisht 60% e projekteve të vlerësuara rezultuan neutrale nga perspektiva gjinore, pa përfshirjen sistematike të analizave gjinore, ndarjen e treguesve ose veprimeve për adresimin e pabarazive gjinore. Konsideratat ndërthurëse, veçanërisht për gratë e pakicave, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara dhe individët LGBTQI+, ishin pothuajse të papërfshira. Vetëm disa projekte i njihnin dhe synonin t'i adresonin qartë këto pabarazi. Analiza tregon se kur gjinia merrej parasysh - përmes analizave gjinore, aktiviteteve të synuara dhe treguesve të ndarë sipas gjinisë – dhe pabarazia gjinore trajtohej si një shqetësim strukturor dhe ndërthurës që nga fillimi, në vend që të ishte një çështje dytësore ose "shtesë", ndërtimi i paqes rezultonte më gjithëpërfshirës, në pronësi lokale dhe potencialisht më i qëndrueshëm.

Edhe pse një vlerësim gjithëpërfshirës i iniciativave për ndërtimin e paqes tejkalonte fushëveprimin e kësaj analize, intervistat sugjerojnë se efektiviteti i projekteve ka ndryshuar. Disa pjesëmarrës vlerësuan se suksesi i iniciativave shpesh varet nga angazhimi personal dhe qasja e individëve që i udhëheqin ato. Disa projekte kontribuan në paqe, ndërsa të tjera u kritikuan që nuk kanë arritur tek një grup mjaft të gjerë të synuar. Për shembull, kampet e paqes shpesh organizohen në gjuhën angleze, duke përjashtuar pjesëmarrësit nga zonat rurale ose familjet me të ardhura më të ulëta. Një pjesëmarrës

[268] Departamenti i Shtetit të Shteteve të Bashkuara, "Kosovo Country Report on Human Rights" [Raporti për Kosovën për të drejtat e njeriut], 2022.
[269] Intervista të RrGK-së.
[270] The British Academy, "The Role of Religion in Conflict and Peacebuilding"[Roli i fesë në konflikt dhe ndërtimin e paqes], 2015, f. 24-25.

vuri në dukje: "Këtu ka fëmijë ... të cilët janë tashmë më të hapur për t'u takuar me njëri-tjetrin. Nuk po përfshihen shqiptarë që nuk kanë takuar kurrë një serb, ose anasjelltas." Disa pjesëmarrës theksuan se aktivitetet shpesh tërheqin të njëjtët pjesëmarrës, duke e kufizuar përfshirjen e një audience më të larmishme. Duke marrë parasysh kapacitetet e ndryshme të OShC-ve, ky dhe hulumtimi i mëparshëm sugjerojnë se një "ekosistem" me mundësi të ndryshme financimi mund të mbështesë angazhimin e OShC-ve të ndryshme* dhe përfshirjen e përfituesve të tyre.[271] Pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e dëgjimit të zërave nga komunitetet lokale dhe të sigurimit që individët dhe OShC-të më të vogla të konsultohen drejtpërdrejt gjatë planifikimit dhe zbatimit. Ndërkohë, ndikimi mund të jetë i kufizuar nga dinamikat strukturore dhe politike. Koordinimi midis organeve dhe institucioneve qeveritare u përmend si një sfidë. Situata më e gjerë politike, mosmarrëveshjet midis Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Serbisë, dhuna ose kërcënimi me të, presioni social dhe mbulimi mediatik nganjëherë i dekurajonin pjesëmarrësit nga angazhimi në aktivitetet e planifikuara ndëretnike, veçanërisht serbët e Kosovës.

> "Pajtimi nuk mund të blihet. Ai vjen kur duam dhe si duam ne."
>
> – Aktiviste

8.1. Përfundimi

- Mes një mori nismash drejt ndërtimit të paqes, pak nisma kanë qenë të përgjegjshme nga aspekti gjinor dhe gjithëpërfshirëse.
- Mësimet e nxjerra nga nismat e kaluara ilustrojnë rëndësinë e marrjes në konsideratë të rreziqeve kontekstuale për planifikimin e programeve, si shtrirja e kufizuar, përkthimi dhe qasja fizike, të cilat mund të përjashtojnë pa dashje gratë me aftësi të kufizuara, ato nga zonat rurale ose ato në kushte ekonomike të vështira. Përfshirja e pamjaftueshme e komuniteteve lokale dhe të pakicave, veçanërisht grave, në hartim dhe zbatim mund të minojë rëndësinë, të përforcojë pabarazitë ekzistuese dhe të kufizojë rezultatet. Mungesa e qasjeve të përgjegjshme nga aspekti gjinor dhe mosarritja për të angazhuar gra dhe burra të ndryshëm* mund të përjetësojnë përçarjet sociale dhe të parandalojnë arritjen e paqes gjithëpërfshirëse.

9. Rekomandimet

Ky hulumtim synoi të identifikojë rekomandime për politika dhe programe më efektive, gjithëpërfshirëse, të përgjegjshme nga aspekti gjinor, të ndjeshme ndaj konfliktit dhe të qëndrueshme, që kontribuojnë në avancimin e paqes dhe sigurisë. Ekipi i hulumtimit përdori një proces gjithëpërfshirës, duke kërkuar nga pjesëmarrësit që të japin rekomandimet e tyre. Rekomandimet burojnë nga këto sugjerime dhe nga gjetjet e analizës gjinore. Ato janë të organizuara sipas akterit përgjegjës për zbatimin e tyre.

9.1. ZKM

- Të organizohen të paktën diskutime tremujore midis ZKM-së dhe grave dhe OShCG-ve të ndryshme* për çështje të propozuara nga ato, duke siguruar që këto konsultime të kenë një ndikim të rëndësishëm në proceset e politikave dhe negociatave, përfshirë dialogun Beograd-Prishtinë, dialogun politik midis Kosovës dhe BE-së, si dhe konsultimet lidhur me takimet e Komitetit dhe Nënkomitetit të MSA-së. Të vazhdohet ndarja paraprake e agjendës së këtyre takimeve me gratë dhe OShCG-ve të ndryshme*, si dhe ekspertët përkatës; të sigurohet që kontributi i tyre për forcimin e ndjeshmërisë gjinore të merret parasysh dhe të reflektohet në diskutime.
- Të përmirësohet fokusi ndaj barazisë gjinore në fushat e paqes, sigurisë dhe marrëdhënieve të mira fqinjësore si pjesë e procesit të anëtarësimit në BE. Të vazhdohet angazhimi me OShCG -të dhe të eksplorohen mundësi për zgjerimin e këtij bashkëpunimi, duke adresuar rekomandimet e tyre lidhur me llogaridhënien, qasjen në drejtësi dhe sundimin e ligjit.

[271] Fondacioni Kvinna till Kvinna, "Ku janë paratë për të drejtat e grave?", 2020.

- Të sigurohet që versionet e ardhshme të PKIE dhe *Planit të rritjes të BE-së: Agjendës së Reformave të Kosovës* dhe planet e tyre të veprimit të përmbajnë angazhime të qarta për Agjendën GPS dhe përfshirjen e grave në proceset e paqes, përfshirë dialogun politik dhe marrëdhëniet me Serbinë.
- Të ndryshohen ligjet zgjedhore në përputhje me LBGj-në, duke siguruar pjesëmarrjen 50% të grave dhe burrave në të gjitha institucionet dhe duke kontribuar në përfaqësimin e tyre të barabartë në proceset e paqes dhe institucionet e sigurisë.[272]
- Të këshillohet Këshilli i Sigurisë së Kosovës që të sigurojë se plani i veprimit dhe matrica e monitorimit për Strategjinë aktuale të Sigurisë 2022-2027 e ka të integruar perspektivën gjinore nl objektivat, treguesit, bazat, synimet, masat dhe buxhetin në përputhje me LBGj-në. Në vlerësimin dhe përgatitjen e Strategjisë së ardhshme të Sigurisë, të inkurajohet fuqishëm Këshilli që të përfshijë perspektivën gjinore, bazuar në analizën e ndikimit gjinor që merr parasysh nevojat e ndryshme të grave dhe burrave, në përputhje me Agjendën GPS, duke adresuar edhe kërcënimet që lindin nga transformimi digjital.
- Të përditësohen platformat digjitale, duke siguruar që ato po ofrojnë burime që janë lehtë të qasshme, miqësore për përdoruesin, konfidenciale, ndjeshme nga aspekti gjinor dhe shumëgjuhësore për qeverisje, shërbime publike, konsultime shëndetësore, mbështetje ligjore, drejtësi dhe mundësi punësimi. Kjo mund t'u mundësojë grave dhe burrave të ndryshëm*, përfshirë ata në zona të largëta dhe me aftësi të kufizuara, të kenë qasje në shërbime pa pasur nevojë të vizitojnë fizikisht institucionet. Gjithashtu, kjo do të mund të përmirësonte integrimin social dhe ekonomik të grave dhe burrave nga pakicat, duke i fuqizuar ata përmes informimit mbi të drejtat e tyre (p.sh., lidhur me dhunën me bazë gjinore, kujdestarinë mbi fëmijët ose të drejtat mbi pronën).
- Të merren masa për të përmirësuar qasjen në përfitime dhe shërbime sociale që më parë ofroheshin nga Serbia (p.sh., pensionet, shtesat për fëmijë dhe studentë, kujdesi shëndetësor dhe ilaçet) për komunitetet serbe të Kosovës dhe komunitetet jo-shumicë, duke adresuar kërcënimet ndaj sigurisë njerëzore dhe sfidat specifike me të cilat përballen gratë, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara.
- Të përmirësohet disponueshmëria dhe përballueshmëria e shërbimeve të kujdesit për fëmijët,[273] të moshuarit, të sëmurit dhe personat me aftësi të kufizuara, duke u mundësuar grave më shumë kohë për të angazhuar në proceset politike në të gjitha nivelet, përfshirë proceset e paqes.
- Të sigurohet që të gjitha institucionet të mbledhin dhe përdorin të dhëna të ndara sipas gjinisë, moshës, etnisë, vendndodhjes (rurale/urbane, komunë) dhe aftësive të kufizuara, dhe t'i dorëzojnë rregullisht ASK-së për publikim dhe transparencë publike, në përputhje me kërkesat e LBGj-së.

9.1.1. ABGj

- Të shqyrtohet mundësia e miratimit të një PKV të veçantë. Përndryshe, të hartohet shtylla e re e GPS në kuadër të PKBGj-së, në përputhje me praktikat më të mira globale për planet e veprimit WPS, duke siguruar një proces hartimi të drejtë, të strukturuar dhe gjithëpërfshirës. Ky proces duhet të përfshijë:
  - Adresimin e rezolutave simotra të RKSKB 1325
  - Mbulimin e fushave të Agjendës GPS që ende nuk janë zbatuar në Kosovë
  - Përcaktimin e hapave të qartë për angazhimin e grave në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve, në përputhje me RKSKB 2467
  - Përfshirjen e rehabilitimit dhe ndihmës humanitare të ndjeshme gjinore
